LIGJ
Nr. 102/2014

KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË[1]

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME, ORGANIZIMI DHE KOMPETENCAT E ADMINISTRATËS DOGANORE

KREU I
FUSHA E ZBATIMIT, MISIONI DHE PËRKUFIZIME

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, në vijim Kodi, vendos rregullat dhe procedurat e përgjithshme të zbatueshme për mallrat që hyjnë në/ose që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, si dhe statusin, kompetencat e organizimin e personelit të administratës doganore.

Kodi zbatohet në mënyrë uniforme në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë pa cenuar marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 2
Misioni i autoriteteve doganore

1. Autoritetet doganore kanë si përgjegjësi kryesore mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në tregti dhe në sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar. Autoritetet doganore duhet të marrin masat, me anë të të cilave synohet, në veçanti:

a) mbrojtja e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit;

b) garantimi i sigurisë e i mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe i banorëve të saj, si dhe mbrojtjes së mjedisit e, kur është e nevojshme, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera;

c) mbajtja e balancës së duhur ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë së ligjshme.

2. Autoritetet doganore, në bashkëpunim me organizmat e tjerë publikë, kanë si objektiv kryesor garantimin e interesave fiskalë, të sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, duke qenë të pajisur me mjetet që i lejojnë të reagojnë në rast krizash dhe t'u përgjigjen kërkesave të reja në fushën e politikës me interes të përgjithshëm.

3. Doganat shqiptare, për realizimin e këtij qëllimi, përcaktojnë parimet strategjikë si më poshtë:

a) Parimi i mbrojtjes së shoqërisë dhe interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë përmes:

i) sigurimit të mbledhjes korrekte dhe të efektshme të detyrimeve e të taksave;

ii) aplikimit të masave efektive për ndalimin e lëvizjes së mallrave të paligjshme, të falsifikuara e pirate, të kufizuara e të ndaluara;

iii) zhvillimit të mëtejshëm të një analize risku të efektshme për të kontribuar në luftën kundër terrorizmit e kriminalitetit dhe, në veçanti, për tregtinë e drogave, mallrave të falsifikuara e pirate;

iv) parandalimit, zbulimit, hetimit dhe procedimit për mashtrimet dhe shkeljet e legjislacionit doganor;

v) përdorimit të asistencës administrative dypalëshe për të siguruar mirëfunksionimin e legjislacionit doganor.

b) Parimi i mbështetjes së konkurrueshmërinë së kompanive shqiptare përmes:

i) modernizimit të ambientit dhe të metodave të punës së doganës (në veçanti me përafrimin e sistemeve ose me anë të forcimit dhe harmonizimit të metodave të punës);

ii) aplikimit të një mjedisi doganor pa letër (dogana elektronike);

iii) qasjes proaktive drejt standardeve, përmes miratimit të standardeve ndërkombëtare, siç janë ato të zhvilluara nga Organizata Botërore e Doganave dhe Bashkimi Europian.

c) Parimi i lehtësimit të mëtejshëm të tregtisë së ligjshme përmes:

i) ndërtimit dhe përmirësimit të sistemeve të kontrollit, të cilat reduktojnë ndërhyrjet në trafikun e mallrave, si dhe barrierat administrative në minimumin e nevojshëm, me qëllim që të arrihen objektivat e tjerë të politikës së përgjithshme, siç janë kërkesat në fushën e sigurisë;

ii) krijimit të lehtësive për operatorët ekonomikë të ligjshëm, me qëllim reduktimin e kostove.

ç) Parimi i kontrollit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit të përdorur për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave përmes:

[1] *Rregullorja e Parlamentit Europian dhe Këshillit (BE) nr. 952/2013, datë 9 tetor 2013, "Mbi përcaktimin e Kodit Doganor të Bashkimit Europian", numri CELEX: 32013R0952, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 269, datë 10.10.2013, faqe 1-101.*

i) përmirësimit dhe forcimit të efektshmërisë së kontrolleve në vendndodhjet optimale të tyre (në kufi ose brenda territorit) në zinxhirin e furnizimit;

ii) zbatimit korrekt dhe të qëndrueshëm të legjislacionit, lidhur me kontrollin dhe lëvizjen e mallrave;

iii) bërjes më të efektshme dhe sistematike të përdorimit të përbashkët të informacioneve për risqet;

iv) marrjes në konsideratë të mundësive për të ndarë informacionin me partnerët kryesorë tregtarë, me qëllim menaxhimin dhe kontrollin e gjithë zinxhirit të furnizimit.

d) Parimi i bashkëpunimit, duke mbajtur, zhvilluar dhe shtuar marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve doganore dhe agjencive të tjera qeveritare dhe ndërmjet autoriteteve doganore dhe komunitetit të biznesit përmes:

i) thellimit të bashkëpunimit ekzistues;

ii) koordinimit të aksioneve në mbrojtje të interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë;

iii) marrjes së rolit drejtues në zhvillimin e mekanizmave për bashkërendimin e punës me agjencitë e tjera që veprojnë në kufi (një sportel);

iv) përmirësimit të mekanizmave të konsultimit dhe bashkëpunimit me biznesin;

v) përforcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar ose asistencës së ndërsjellë në fushën e doganave nëpërmjet marrëveshjeve me vendet e tjera dhe shtrirjes së pjesëmarrjes në forumet ndërkombëtare përgjegjëse për ligjet dhe vendimet ndërkombëtare, të tilla si embargo, marrëveshjet për ambientin, marrëveshjet për mbrojtjen e pronësisë intelektuale etj.

Neni 3
Territori doganor

Territori doganor përfshin territorin tokësor, ujërat territoriale, ujërat e brendshme dhe hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Zona dhe vija doganore

1. Zona doganore përfshin atë pjesë të territorit doganor ku veprojnë autoritetet doganore, si dhe të gjitha zonat ku këto autoritete ushtrojnë kontroll ose mbikëqyrje doganore.

2. Zonat doganore vendosen në pikat e kontrollit të kalimit të kufirit, si dhe në pika të tjera të territorit doganor.

3. Krijimi, shtrirja territoriale dhe klasifikimi i zonave doganore të përhershme ose të përkohshme përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave, sipas kërkesës së motivuar të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, bazuar në rritjen e numrit të operatorëve ekonomikë që operojnë në atë territor dhe pamundësisë së zonës doganore ekzistuese për kryerjen e procedurave doganore.

4. Vija doganore është bregdeti, brigjet e liqeneve e të lumenjve kufitarë dhe kufijtë tokësorë me shtetet e tjera.

5. Mallrat duhet të kalojnë vijën doganore të kufirit tokësor, ujor dhe në aeroporte vetëm në pikat e kalimit të kufirit shtetëror ku ka zona doganore.

Neni 5
Shtrirja e zonës doganore

1. Zona doganore e mbikëqyrjes tokësore përbëhet nga territori që përfshin hapësirën nga vija doganore e kufirit tokësor deri në 10 km në brendësi. Përgjatë bregdetit kjo zonë mbikëqyrjeje shkon deri në 5 km nga bregu në brendësi.

2. Zona doganore e mbikëqyrjes ujore përbëhet nga rripi i ujit që shtrihet prej vijës doganore deri në kufirin e jashtëm të ujërave territoriale dhe të ujërave të brendshme.

Neni 6
Përkufizime

Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Autoritete doganore" është administrata doganore e Republikës së Shqipërisë, përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit doganor, dhe çdo autoritet tjetër i ngarkuar me ligj për të zbatuar dispozita të veçanta të legjislacionit doganor.

2. "Legjislacion doganor" është kuadri ligjor, i përbërë nga:

a) konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

b) Kodi Doganor;

c) legjislacioni për tarifën doganore dhe nomenklaturën e kombinuar të mallrave, në Republikës së Shqipërisë;

ç) aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

3. "Kontrolle doganore" janë veprime të veçanta, të kryera nga autoritetet doganore për të garantuar zbatimin e saktë të legjislacionit doganor dhe çdo legjislacioni tjetër që ka të bëjë me hyrjen, daljen, transitin, lëvizjen, magazinimin dhe përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use) të mallrave që lëvizin ndërmjet territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe territoreve të tjera dhe prezenca e lëvizja brenda territorit doganor të mallrave joshqiptare dhe mallrave që i nënshtrohen procedurës së përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use).

4. "Person" është një person fizik, një person juridik, si dhe çdo person tjetër/individ me zotësi të plotë për të vepruar, të njohur si subjekte nga legjislacioni në fuqi.

5. "Operator ekonomik" është personi, i cili, gjatë aktivitetit të tij tregtar, përfshihet në veprime të mbuluara nga legjislacioni doganor.

6. “Përfaqësues doganor” është çdo person i caktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga një person tjetër, për të kryer veprimet dhe formalitetet e kërkuara nga legjislacioni doganor në marrëdhëniet e tij me autoritetet doganore.

7. “Risk” është mundësia dhe ndikimi i një ngjarjeje që mund të ndodhë në lidhje me hyrjen, daljen, transitin, lëvizjen, përpunimin ose përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use) të mallrave, që lëvizin ndërmjet territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve apo territoreve jashtë këtij territori dhe të prezencës së mallrave joshqiptare brenda territorit doganor, të cilat mund të sjellin një nga rezultatet e mëposhtme:

a) pengimin e zbatimit të saktë të masave kombëtare;

b) kompromet imin e interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë;

c) paraqitjen e një kërcënimi për mbrojtjen dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë dhe banorëve të saj, për qeniet njerëzore, për florën dhe faunën, për mjedisin ose për konsumatorët.

8. “Formalitete doganore” janë të gjitha veprimet që duhet të kryhen nga personat dhe nga autoritetet doganore, me qëllim zbatimin e legjislacionit doganor.

9. “Deklaratë përmbledhëse e hyrjes” është akti, me anë të të cilit një person informon autoritetet doganore, sipas mënyrës dhe formës së parashikuar, brenda një afati kohor të caktuar, që mallrat do të hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

10. “Deklaratë përmbledhëse e daljes” është akti, me anë të të cilit një person informon autoritetet doganore, sipas mënyrës dhe formës së parashikuar, brenda një afati kohor të caktuar, që mallrat do të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

11. “Deklaratë e magazinimit të përkohshëm” është akti, me anë të të cilit një person shpreh, sipas mënyrës dhe formës së parashikuar, që mallrat janë në magazinim të përkohshëm.

12. “Deklaratë doganore” është akti, me anë të të cilit një person shpreh, në formën dhe mënyrën e parashikuar, vullnetin për të vendosur mallrat nën një regjim doganor të caktuar, ku të tregohet, nëse është rasti, regjimi specifik për t’u zbatuar.

13. “Deklaratë rieksporti” është akti, me anë të të cilit një person shpreh, në formën dhe mënyrën e parashikuar, vullnetin për të nxjerrë mallrat joshqiptare, me përjashtim të atyre nën një regjim zone të lirë ose magazinimi të përkohshëm, jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

14. “Njoftim rieksporti” është akti, me anë të të cilit një person shpreh, në formën dhe mënyrën e parashikuar, vullnetin për të nxjerrë mallrat joshqiptare, që janë nën një regjim zone të lirë ose magazinimi të përkohshëm, jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

15. “Deklarues” është personi që depoziton një deklaratë doganore, deklaratë për magazinim të përkohshëm, një deklaratë përmbledhëse në hyrje, një deklaratë përmbledhëse të daljes, një deklaratë rieksporti ose një njoftim rieksporti në emër të saj/të tij ose personit, në emër të të cilit është bërë një deklarim ose njoftim i tillë.

16. “Regjim doganor” është një nga regjimet e mëposhtme, nën të cilat mallrat vendosen në përputhje me këtë Kod:

a) çlirimi për qarkullim të lirë;

b) regjime të posaçme;

c) eksporti.

17. “Magazinim i përkohshëm” është situata e mallrave joshqiptare të magazinuara përkohësisht nën mbikëqyrjen doganore në periudhën ndërmjet paraqitjes së tyre në doganë dhe vendosjes së tyre në një regjim doganor ose rieksporti.

18. “Borxh doganor” është detyrimi i një personi për të paguar shumën e detyrimit të importit ose shumën e detyrimit të eksportit, të cilat zbatohen për mallra të caktuara, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

19. “Debitor” është çdo person që ka një borxh doganor për të paguar.

20. “Detyrim importi” është detyrimi doganor që duhet paguar në importimin e mallrave.

21. “Detyrim eksporti” është detyrimi doganor që duhet paguar në eksportimin e mallrave.

22. “Status doganor” është statusi i mallrave si mallra shqiptare ose joshqiptare.

23. “Mallra shqiptare” janë mallrat e një prej kategorive të mëposhtme:

a) mallrat tërësisht të përftuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që nuk kanë në përbërje mallra të importuara nga vende ose territore të tjera;

b) mallrat që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga vende ose territore jashtë këtij territori dhe të çliruara për qarkullim të lirë;

c) mallrat e përftuara ose të prodhuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë vetëm nga mallrat që përmenden në shkronjën “b” ose nga mallrat që përmenden në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike.

24. “Mallra joshqiptare” janë të gjitha mallrat e tjera që nuk përmenden në pikën 23, ose ato që kanë humbur statusin e tyre doganor si mallra shqiptare.

25. “Menaxhim i riskut” është identifikimi sistematik i riskut, përfshirë edhe kontrollet e rastësishme dhe zbatimi i të gjitha masave të nevojshme për kufizimin e ekspozimit ndaj riskut.

26. “Çlirim i mallrave” është akti, me anë të të cilit autoritetet doganore i bëjnë mallrat të disponueshme për qëllimet e parashikuara nga regjimet doganore, në të cilat janë vendosur.

27. “Mbikëqyrje doganore” është veprimi i ndërmarrë në përgjithësi nga autoritetet doganore për të siguruar respektimin e legjislacionit doganor dhe, kur është e nevojshme, të dispozitave të tjera të zbatueshme mbi mallrat që i nënshtrohen këtij veprimi.

28. “Rimbursim” është kthimi i një shume detyrimi importi ose eksporti që është paguar.

29. “Falje” është heqja dorë nga detyrimi për të paguar një shumë detyrimi importi apo eksporti që nuk është paguar.

30. “Produkte të përpunuara” janë mallrat e vendosura në një regjim përpunimi dhe që u janë nënshtruar operacioneve përpunuese.

31. “Person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë” është:

a) në rastin e një personi (individ), çdo person që ka vendqëndrimin, (vendbanimin) në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) në rastin e një personi fizik ose juridik, i njohur si i tillë nga legjislacioni në fuqi, çdo person që ka selinë, zyrën qendrore, degën apo vendodhjen e përhershme të biznesit, të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

32. “Vendndodhje e përhershme biznesi” është zyra qendrore ose dega e biznesit, ku janë gjithmonë burimet e nevojshme njerëzore dhe ato teknike, nëpërmjet të cilave kryhen pjesërisht ose tërësisht operacionet e një personi që ka marrëdhënie me doganën.

33. “Paraqitje e mallrave në doganë” është njoftimi i autoriteteve doganore për mbërritjen e mallrave në zyrën doganore ose në çdo vend tjetër, të përcaktuar ose të miratuar prej autoriteteve doganore, dhe bërja e disponueshme e këtyre mallrave për kontrolle doganore.

34. “Mbajtës i mallrave” është personi, i cili është pronari i mallrave ose personi, i cili ka të drejta të ngjashme disponimi mbi këto mallra ose që ka zotërim fizik mbi to.

35. “Mbajtës i regjimit” është:

a) personi që depoziton deklaratën doganore ose personi, për llogari të të cilit depozitohet një deklaratë doganore; ose

b) personi, të cilit i janë transferuar të drejtat dhe detyrimet lidhur me një regjim doganor.

36. “Masa të politikës tregtare” janë masat jotarifore të miratuara, si pjesë e politikave tregtare, që rregullojnë tregtinë ndërkombëtare të mallrave.

37. “Operacion përpunimi” është një nga operacionet e mëposhtme:

a) punimi i mallrave, përfshirë montimin ose bashkimin apo përshtatjen e tyre me mallra të tjera;

b) përpunimi i mallrave;

c) shkatërrimi i mallrave;

ç) riparimi i mallrave, përfshirë ndreqjen dhe rregullimin e tyre;

d) përdorimi i mallrave, të cilat nuk gjenden në produktet e përpunuara, por që lejojnë ose lehtësojnë prodhimin e këtyre produkteve edhe sikur ato të jenë përdorur tërësisht ose pjesërisht në proces (aksesorët e prodhimit).

38. “Koeficient i shfrytëzimit” është sasia ose përqindja e produkteve të përpunuara që përftohen nga përpunimi i një sasie të caktuar mallrash, të vendosura nën një regjim përpunimi.

39. “Zyrë doganore” është çdo zyrë, në të cilën mund të kryhen të gjitha ose një pjesë e formaliteteve që parashikon legjislacioni doganor.

40. “Vendim” është çdo akt zyrtar i lëshuar nga autoritetet doganore, në zbatim të legjislacionit doganor, që rregullon një çështje të veçantë dhe ka efekte dhe/ose pasoja ligjore mbi personin ose personat përkatës.

41. “Transportues” është:

a) në kuptim të hyrjes, personi i cili sjell mallrat ose që merr përgjegjësinë për transportin e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Sidoqoftë:

i) në rastin e transportit të kombinuar, “transportues” është personi që operon mjetet e transportit, të cilat, mbasi kanë hyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, lëvizin vetë si një mjet aktiv transporti;

ii) në rastin e transportit ajror apo detar me një mjet të përbashkët transporti apo të një marrëveshjeje kontraktuale, “transportues” është personi, i cili lidh një kontratë dhe lëshon një dokument transporti detar ose ajror (bill of lading ose air waybill) për transportin konkret të mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) në kuptim të daljes, personi, i cili nxjerr mallrat ose që merr përgjegjësinë për transportin e mallrave jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Sidoqoftë:

i) në rastin e transportit të kombinuar, kur mjeti aktiv i transportit që lë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë është vetëm duke transportuar një mjet tjetër transporti, i cili, mbas mbërritjes së mjetit aktiv të transportit në destinacion, do të lëvizë vetë si një mjet aktiv transporti, “transportues” është personi që do të operojë mjetin e transportit që do të lëvizë vetë sapo mjeti i transportit, që lë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ka arritur në destinacionin e tij;

ii) në rastin e transportit ajror apo detar me një mjet të përbashkët transporti apo të një marrëveshjeje kontraktuale, “transportues” është personi, i cili lidh një kontratë dhe lëshon një dokument transporti detar ose ajror (bill of lading ose air waybill) për transportin konkret të mallrave që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

42. “Komision blerjeje” është një tarifë e paguar nga një importues te një agjent për ta përfaqësuar atë në porositjen e mallrave që vlerësohen.

43. “Garancia globale” është garancia që mbulon shumën e detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon borxhit doganor, në lidhje me dy ose më shumë operacione, deklarata dhe regjime doganore.

KREU II
ORGANIZIMI I ADMINISTRATËS DOGANORE DHE I VEPRIMTARISË DOGANORE, KOMPETENCAT, BASHKËPUNIMI, PUNËSIMI DHE MARRËDHËNIET E PUNËS SË PERSONELIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE

SEKSIONI 1
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS DOGANORE QENDRORE DHE VENDORE

Neni 7
Organizimi dhe funksionimi i administratës doganore

1. Administrata doganore përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët doganore. Ajo është nën varësinë e Ministrisë së Financave.

2. Degët doganore janë nën varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Ato përbëhen nga një ose disa zyra doganore.

3. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e administratës doganore përcaktohen në këtë Kod, në ligje specifike dhe me vendim të Këshillit të Ministrave, të dala në zbatim të tyre.

4. Personeli doganor i strukturave hetimore, luftës kundër kontrabandës dhe trafikut të paligjshëm dhe i strukturave të tjera doganore, që përcaktohen me ligj specifik, kanë atributet e Policisë Gjyqësore. Të drejtat dhe detyrat e personelit në kryerjen e funksioneve të Policisë Gjyqësore janë të përcaktuara nga legjislacioni specifik për këtë qëllim.

Neni 8
Struktura e administratës doganore

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave dhe në bashkërendim me Departamentin e Administratës Publike, miraton me vendim, strukturën organizative dhe organikën e personelit të administratës doganore, në mënyrë që të garantojë mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë dhe një organizim të përshtatshëm për dinamizmin dhe veçantinë e veprimtarisë doganore.

Neni 9
Orari i funksionimit

1. Në parim orari i funksionimit të zyrave doganore është 24 orë. Megjithatë, për raste të tjera ky orar vendoset ndryshe, në mënyrë që të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm, duke marrë në konsideratë llojin e trafikut/transportit të mallrave, si dhe regjimet doganore, në të cilat ato do të vendosen, me qëllim që të mos pengohet dhe të mos vështirësohet trafiku ndërkombëtar i mallrave.

2. Kur është e mundur, për zyrat doganore që operojnë në kufi, orari i funksionimit vendoset në bashkëpunim me administratat doganore homologe.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për përcaktimin e orarit të funksionimit të zyrave të administratës doganore, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni.

SEKSIONI 2
KOMPETENCAT E AUTORITETEVE DOGANORE DHE BASHKËPUNIMI

Neni 10
Kompetencat e autoriteteve doganore

Autoritetet doganore kanë kompetencat si më poshtë:

1. Ngarkimi, shkarkimi, imbarkimi, zbarkimi dhe transbordimi i mallrave dhe mjeteve përgjatë vijës doganore kufitare dhe në aeroporte kryhen me lejen e autoriteteve doganore dhe në përputhje me mënyrat e përcaktuara prej tyre.

2. Autoritetet doganore janë përgjegjëse për:

a) kryerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuara në këtë Kod, në ligje të tjera specifike dhe në akte nënligjore për mallrat në hyrje, në dalje dhe brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) verifikimin dhe vjeljen e detyrimeve që duhen paguar, si dhe të sanksioneve përkatëse;

c) parandalimin, zbulimin, hetimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë kontrabandë, shkeljeve, trafikut të paligjshëm të mallrave të ndaluara ose të kufizuara, cenimit të të drejtave të pronësisë intelektuale etj.;

ç) konstatimin, verifikimin dhe sanksionimin e shkeljeve të parashikuara në këtë Kod, në aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe në ligje të tjera ku administrata doganore është e ngarkuar për zbatim;

d) negocimin, përgatitjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare në fushën e doganave, sipas autorizimit;

dh) mbi bazën e një kërkese me shkrim, dërgimin apo dhënien e të dhënave statistikore për ministritë e linjës dhe për organet e tjera publike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

e) mbikëqyrjen në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave që i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve doganore.

3. Autoritetet doganore, si autoriteti kompetent, mbikëqyrin dhe ushtrojnë kontrolle mbi të gjitha mallrat, mbi mjetet e transportit, bagazhet dhe udhëtarët që kalojnë vijën doganore në zonat doganore e përgjatë vijës kufitare, tokësore e ujore, në ujërat e brendshme dhe në hapësirën ajrore, që janë nën mbikëqyrjen e

autoriteteve doganore. Autoritetet doganore kanë të drejtën edhe të kontrollit trupor të individëve për mallrat që mbajnë ose fshehin në trupin e tyre.

4. Në pikat e kalimit të kufirit tokësor, ujor e në aeroporte, si dhe në dalje nga zyrat e brendshme doganore organizohet kontrolli i mallrave dhe i mjeteve të transportit, që dalin nga zonat doganore, për të verifikuar nëse lloji dhe sasia e mallrave të transportuara janë në përputhje me dokumentet shoqëruese.

Nëse nuk rezultojnë mospërputhje, nëpunësit e doganës që kryejnë këtë shërbim vendosin mbi dokumentet doganore vulën dhe/ose shënimet përkatëse në sistemin elektronik të doganës. Në rast të kundërt, ata përpilojnë procesverbalin përkatës, të cilin ia kalojnë kryetarit të degës doganore për të kryer formalitetet e mëtejshme.

5. Kur është e nevojshme, kontrolli i parashikuar në pikën 4 kryhet nga autoritetet doganore edhe përgjatë rrugëve të lëvizjes së mjeteve të transportit. Në këtë rast, nëpunësit e doganës, që janë ngarkuar për të ndaluar mjetet e transportit, përdorin tabelën e ndalim-qarkullimit, me të cilën janë pajisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe i tregojnë drejtuesit të mjetit kartën e tyre identifikuese. Në rast se nga kontrolli i bërë rezultojnë parregullsi, punonjësit e doganës e shoqërojnë mjetin e transportit pranë zyrës doganore më të afërt, ku përpilojnë procesverbalin përkatës, i cili i dorëzohet kryetarit të degës doganore për të kryer formalitetet e mëtejshme.

6. Autoritetet doganore mund të kryejnë të gjitha kontrollet e nevojshme pranë mjediseve të deklaruesit apo mbajtësit të një autorizimi ose regjimi apo të çdo personi tjetër, që është përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në çlirimin e mallrave, sipas akteve nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Autoritetet doganore mund të kryejnë gjithashtu kontrollin e deklarimit të parave, valutës, letrave me vlerë dhe gurëve të çmuar që hyjnë e dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

7. Përfaqësuesit e autoriteteve doganore mund të sekuestrojnë dokumente, skedarë kompjuterikë ose regjistrat përkatës, si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, tregtar apo fiskal, të ndodhur në ambientet e operatorëve ekonomikë, në rastet e dyshimeve të arsyeshme për kryerjen e ndonjë prej shkeljeve të parashikuara nga ky Kod.

Procedurat specifike dhe të detajuara që duhen ndjekur nga autoritetet doganore në rastet e sekuestrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij Kodi.

8. Në rastet kur autoritetet e tjera që veprojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë kanë dyshime ose vihen në dijeni për shkelje të normave të këtij Kodi, të akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe të ligjeve të tjera, zbatimi i të cilave është detyrë e autoriteteve doganore, ato njoftojnë menjëherë degën doganore që mbulon territorin në fjalë. Kjo e fundit kryen të gjitha verifikimet e formalitetet e rastit, përfshirë këtu edhe njoftimin e organeve gjyqësore, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod.

9. Kur ka dyshime të bazuara për trafik të paligjshëm ose për krime të tjera në fushën e doganave, të parashikuara në Kodin Penal, autoritetet përkatëse të procedimit penal mund të ndalojnë mjetet e transportit që u nënshtrohen formaliteteve doganore dhe që janë të plumbosura prej autoriteteve doganore. Në këto raste, mjetet e transportit shoqërohen në zyrën doganore më të afërt që është territorialisht kompetente, ku hiqet plumbçja. Autoritetet përkatëse të procedimit penal, në bashkëpunim të plotë me autoritetet doganore, kryejnë të gjitha kontrollet që konsiderohen të nevojshme. Këto autoritete, në përfundim të kontrollit përgatisin një raport me shkrim i firmosur nga të dyja palët, i cili, nëse është rasti, i dërgohet prokurorisë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal. Çdo kontroll dhe akt i mbajtur jashtë zyrës doganore është i pavlefshëm.

10. Autoritetet doganore, për të siguruar zbatimin me korrektësi të dispozitave ligjore mund të vendosin plumbçe ose stampa në mjetet e transportit, mallrat, magazinat dhe ambientet e operatorit ekonomik, aparate ose mekanizma, si dhe në vende të tjera, me qëllim mbrojtjen e interesave fiskalë, të sigurisë dhe të mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

11. Autoritetet doganore mbledhin informacion dhe bëjnë hetime për zbatimin korrekt të dispozitave të këtij Kodi. Për këtë qëllim ato mund:

a) të ftojnë, duke dhënë arsyen, çdo person, që merr pjesë në aktivitete të lidhura me procedurat e import-eksportit, që të paraqitet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij për të dhënë informacione, sqarime apo dokumentacion që lidhet me mallrat e importuara ose të eksportuara;

b) t'u kërkojnë shoqërive tregtare, institucioneve të kreditimit, administratës postare ose çdo organizmi publik e privat, ku gjenden informacione të vlefshme për hetimin, që në përputhje me legjislacionin në fuqi të japin informacion ose kopje të dokumentacionit në lidhje me marrëdhënien me klientin;

c) të kërkojnë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kopje ose ekstrakte të akteve dhe dokumenteve që gjykohen të nevojshme për hetimet ose kontrollet, të depozituara në organizma dhe ente publike e private, si dhe në zyrat noteriale;

ç) me pëlqimin e pronarit ose me vendim të lëshuar nga gjykata ose prokurori, të kryejnë kontroll në të gjitha ambientet, të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 6, përfshirë ato private, në çdo orë, në rast të

dyshimeve të bazuara për kryerjen e një vepre penale në fushën e doganave;

d) me pëlqimin e pronarit ose me vendim të lëshuar nga gjykata ose prokurori të kryejnë kontroll në çdo kohë në vendet ku dyshohet se mbahen mallra kontrabandë;

dh) në përputhje me legjislacionin në fuqi, autorizohen të kenë akses në bazat e të dhënave të administratave të tjera, përkatësisht:

i) në bazën e të dhënave të personave që hyjnë dhe dalin në/dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë;

ii) në bazën e të dhënave të deklarimit të kapitaleve dhe llogarive bankare, për efekt hetimi;

iii) në bazën e të dhënave të precedentëve policorë;

iv) në bazën e të dhënave të automjeteve të vjedhura.

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat e dhënies së informacionit dhe aksesit në bazat e të dhënave, referuar në shkronjat "b" dhe "dh", të kësaj pike.

12. Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre autoritetet doganore mund t'u kërkojnë individëve dokumentin personal të identifikimit.

13. Punonjësit doganorë janë në mbrojtje të veçantë nga ligji. Kujtdo personi i ndalohet:

a) t'i fyejë apo t'i keqtrajtojë ata në ushtrimin e funksioneve të tyre;

b) t'u kundërvihet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 11
Kompetencat për kryerjen e formaliteteve doganore

1. Përveç rasteve të forcave madhore, plotësisht të dokumentuara dhe me përjashtim të regjimit të transitit dhe rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, formalitetet doganore bëhen në degën doganore kompetente për territorin ku është vendosur operatori ekonomik.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, duke bërë përjashtim nga rregulli i shprehur në pikën 1, kur rrethanat kërkojnë kryerje kontrollesh të veçanta, mund të vendosë që formalitetet doganore për disa kategori mallrash të përqendrohen në një degë doganore, të ndryshme nga dega doganore kompetente për territorin ku është vendosur operatori ekonomik.

3. Për nevoja të tregtisë dhe me aplikim të personit të interesuar, kryetarët e degëve doganore mund të lejojnë që disa nga kontrollet doganore të kryhen në mjediset e deklaruesve ose në vende të tjera të propozuara prej tyre, të cilat konsiderohen të përshtatshme nga autoritetet doganore për kryerjen e të gjitha kontrolleve të nevojshme.

4. Operatorit ekonomik i ngarkohen shpenzimet e këtij shërbimi, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave duke llogaritur kohën e harxhuar për kryerjen e kontrollit, si dhe largësinë e këtyre mjediseve nga zyra doganore.

SEKSIONI 3
STATUSI, ORGANIKA, PUNËSIMI DHE MARRËDHËNIET E PUNËS TË PERSONELIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE

Neni 12
Parime të përgjithshme

Administrata doganore shqiptare udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, qëndrueshmërisë në detyrë dhe vazhdimësisë në karrierë, integritetit, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e ligjit.

Neni 13
Statusi, kategorizimi, të drejtat dhe detyrimet e personelit të administratës doganore

1. Punonjësit e administratës doganore, me përjashtim të punonjësve administrativë, janë nëpunës civil dhe klasifikohen/kategorizohen sipas ligjit "Për nëpunësin civil".

2. Punonjësit e administratës doganore gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në ligjin "Për nëpunësin civil", me përjashtim të së drejtës së grevës.

3. Përjashtimisht përcaktimeve të ligjit "Për nëpunësin civil", për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, pranimi në detyrë, emërimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, transferimi i përkohshëm, elementë specifikë të procedurës së dhënies së masave disiplinore të personelit të administratës doganore pjesë e shërbimit civil, bëhet sipas parimeve dhe procedurave specifike të këtij Kodi dhe akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij për këtë qëllim.

4. Përcaktimi i punonjësve administrativë jepet në ligjin "Për nëpunësin civil".

Neni 14
Paga

Me propozimin e Ministrit të Financave dhe të ministrit përgjegjës për Departamentin e Administratës Publike, Këshilli i Ministrave miraton nivelin e pagës për çdo kategori të personelit doganor dhe për punonjësit administrativë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 15
Marrëdhëniet e punës, pranimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, transferimi i përkohshëm, pezullimi dhe largimi nga detyra i personelit të administratës doganore

1. Drejtori i Përgjithshëm emërohet, lirohet, apo shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

2. Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm të Doganave emërohen sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara nga ligji "Për nëpunësin civil" dhe nga aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Pranimi në shërbimin doganor bëhet sipas procedurës dhe kushtëzimeve të mëposhtme:

a) Personeli i administratës doganore, pjesë e shërbimit civil, me përjashtim të personelit të kategorisë së lartë drejtuese dhe personelit administrativ, rekrutohet në administratën doganore e pranohet në shërbimin civil nëpërmjet një konkurrimi, bazuar në parimet e meritokracisë dhe barazisë, sipas përcaktimeve të mëposhtme.

b) Kërkesat e përgjithshme për pranim në administratën doganore aplikohen sipas përcaktimit të ligjit "Për nëpunësin civil".

c) Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, dhe zhvillohet në këto dy faza:

i) verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit;

ii) vlerësimi i kandidatëve.

ç) Verifikimi paraprak kryhet nga njësia e burimeve njerëzore, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i përhershëm i pranimit, i krijuar sipas akteve nënligjore të këtij Kodi.

d) Kandidatët fitues, që marrin mbi 70 për qind të pikëve totale të vlerësimit, renditen nga komiteti i përhershëm i pranimit, sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm.

dh) Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për krijimin, përbërjen dhe veprimtarinë e komitetit të përhershëm të pranimit, si dhe rregullat e hollësishme për procedurën e pranimit dhe vlerësimin e kandidatëve.

4. Emërimi i kandidatëve fitues, të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, bëhet si më poshtë:

a) Kandidatët fitues, duke filluar nga ai me më shumë pikë, kanë të drejtën të emërohen në çdo pozicion të kategorisë/klasës, për të cilin është zhvilluar konkurrimi, si dhe në çdo pozicion tjetër të lirë të të njëjtës kategori/klasë, që krijohet i lirë gjatë kohës së vlefshmërisë së listës.

b) Departamenti i Administratës Publike (DAP) bën emërimin sipas procedurës më lart.

c) Lista e kandidatëve fitues, të paemëruar ende, sipas shkronjës "b", të kësaj pike, është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare nga shpallja e fituesve. Kjo listë administrohet edhe nga DAP-i. Nëse gjatë këtij afati zhvillohet një procedurë tjetër konkurrimi për të njëjtin grup, kandidatët fitues të listave, që nuk janë emëruar ende, rirenditen sipas rezultatit përfundimtar.

ç) Këshilli i Ministrave miraton procedurat e hollësishme, sipas kësaj pike të këtij neni.

5. Lëvizja paralele bëhet sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, atë të ulët apo të mesme drejtuese bëhet së pari nga punonjësit doganorë, të së njëjtës kategori/klasë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele si më poshtë.

b) Mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, sipas pikës 5, të këtij neni, punonjësit doganorë (nëpunës civilë) të së njëjtës kategori, që plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë.

c) Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision i brendshëm, i krijuar për këtë qëllim, nëpërmjet një procedure të bazuar në parimet e parashikuara në nenin 12 të këtij Kodi. Një përfaqësues i DAP-it është anëtar i komisionit të brendshëm.

ç) Në përfundim të vlerësimit, komisioni mund të vendosë:

i) përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm për t'u emëruar në vendin e lirë;

ii) përfundimin e procedurës pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk plotëson kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

d) Në rastet e përfundimit të procedurës pa asnjë të përzgjedhur, sipas përcaktimeve të shkronjave "a"-"ç", të kësaj pike, plotësimi i vendeve të lira bëhet përmes procedurës së ngritjes në detyrë të personelit doganor.

dh) Këshilli i Ministrave miraton:

i) kushtet që duhet të plotësojnë nëpunësit për lëvizjen paralele dhe procedurat e hollësishme të lëvizjes paralele;

ii) rregullat për krijimin dhe përbërjen e komisionit, të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 5, të këtij neni.

6. Ngritja në detyrë e personelit doganor bëhet si më poshtë:

a) Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet procedurës së konkurrimit, organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me DAP-in, për një ose disa pozicione të lira, bazuar në parimin e përmendur në nenin 12, të këtij Kodi.

b) Nëse vendi i lirë i kategorisë së ulët apo të mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas pikës 5, të këtij neni, ai plotësohet nëpërmjet ngritjes në detyrë.

c) Mund të aplikojnë për ngritje në detyrë, fillimisht vetëm nëpunësit civilë brenda administratës doganore, të një kategorie paraardhëse, nëse plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë. Në rast se vendi i lirë nuk plotësohet dot nga punonjësit brenda administratës doganore, si më lart, rihapet procedura për lëvizjen paralele e më pas për ngritjen në detyrë nga nëpunës civilë jashtë administratës doganore.

ç) Nëse vendi i lirë nuk plotësohet as me procedurën më lart, atëherë kalon si vend i lirë, për t'u plotësuar me pranime të reja me konkurrim. Deri në plotësimin përfundimtar të vendit të lirë, nëse është e nevojshme, mund të zbatohet procedura e transferimit të përkohshëm në interes të institucionit.

d) Këshilli i Ministrave miraton kushtet që duhet të plotësojnë nëpunësit për ngritjen në detyrë dhe procedurat e hollësishme të ngritjes në detyrë.

7. Transferimi i përkohshëm bëhet si më poshtë:

a) Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:

i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;

ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;

iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.

b) Transferimi mund të bëhet, në një nga departamentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në degët doganore apo pranë strukturave të tjera ku atashohen, sipas ligjit, punonjës doganorë.

c) Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte i transferuar.

ç) Në raste të justifikuara, për shkak të veçorive të veprimtarisë doganore, punonjësi doganor mund të transferohet përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të një kategorie më të lartë, për një periudhë deri në 6 muaj. Gjatë kësaj periudhe punonjësi përfiton të drejtat, pagën dhe privilegjet e tjera të pozicionit të ri të punës.

d) Gjatë periudhës së transferimit, nëse është e zbatueshme, nëpunësi përfiton shtesën për kushtet e punës të pozicionit, në të cilin është transferuar.

dh) Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për transferimin e përkohshëm, sipas kësaj pike.

8. Periudha e provës, transferimi i përhershëm, transferimi në rastin e ristrukturimit të institucionit, transferimi për arsye të paaftësisë shëndetësore dhe shmangies së konfliktit të interesave, pezullimi i marrëdhënies së punës dhe efektet e pezullimit rregullohen sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil.

9. Elementet specifike të procedurës së dhënies së masave disiplinore për punonjësit doganor, procedura e shqyrtimit dhe dhënies së masës, përbërja e komisionit disiplinor rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Për çdo element tjetër të marrëdhënies juridike të punës të punonjësve të administratës doganore me status të nëpunësit civil, më lart përshkruar, që nuk gjen rregullim specifik nga ky Kod apo aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji i nëpunësit civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

11. Punonjësit administrativë punësohen sipas procedurave konkurruese me kontratë pune nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, sipas dispozitave të Kodit të Punës dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

12. Në varësi të organizimit të administratës doganore, detyrat dhe funksionet e secilës prej strukturave të administratës doganore, si dhe kategorive respektive të punonjësve doganorë përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 16

Etika dhe pajisja me armë

1. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave përcakton kategoritë e personelit doganor që mbajnë uniformën e shërbimit dhe kategoritë e personelit doganor që mund të pajisen me armë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim. Në rastet kur, për nevoja të shërbimit, është e nevojshme të veprohet pa uniformë, personeli doganor duhet të paraqesë dokumentin e identifikimit, të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

2. Pajisja me armë dhe përdorimi i tyre nga punonjësit e doganës bëhen në përputhje me dispozitat e ligjit për armët dhe të ligjit për përdorimin e armëve të zjarrit.

3. Personeli doganor duhet të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në shërbim, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

4. Personeli doganor është i detyruar të ruajë sekretin profesional dhe konfidencialitetin për të gjitha veprimtaritë që lidhen me ushtrimin e detyrës.

5. Autoritetet doganore, në ushtrimin e funksioneve e të detyrave të tyre, udhëhiqen nga parimi i zbatimit të njëjtë dhe uniform të ligjit.

6. Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, miraton Kodin e Etikës për nëpunësit doganorë dhe rregulloren e mbajtjes së uniformës.

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PERSONAVE SIPAS LEGJISLACIONIT DOGANOR

SEKSIONI 1

KOMUNIKIMI I INFORMACIONEVE

Neni 17

Mjetet për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit dhe kërkesat e përbashkëta për të dhënat

1. Të gjitha shkëmbimet e informacioneve, si deklaratat, aplikimet ose vendimet ndërmjet autoriteteve doganore dhe ndërmjet operatorëve ekonomikë e autoriteteve doganore dhe ruajtja e këtyre informacioneve,

siç kërkohet në zbatim të legjislacionit doganor, bëhen duke përdorur teknika informatike të përpunimit të të dhënave.

2. Për qëllime të shkëmbimit dhe ruajtjes së informacionit, në zbatim të pikës 1, hartohen kërkesat e përbashkëta për të dhënat.

3. Përveç teknikës informatike të përpunimit të të dhënave, të parashikuara në pikën 1, mund të përdoren mënyra të tjera të shkëmbimit dhe ruajtjes së informacionit si më poshtë:

a) në mënyrë të përhershme, në raste të justifikuara nga lloji i lëvizjes së mallrave ose kur përdorimi i teknikave informatike të përpunimit të të dhënave nuk janë të përshtatshme për formalitetet doganore në fjalë;

b) në mënyrë të përkohshme, në rast të defekteve të përkohshme të sistemeve informatike të autoriteteve doganore ose të operatorëve ekonomikë.

Neni 18
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kërkesat e përbashkëta për të dhëna, sipas pikës 2, të nenit 17, duke marrë në konsiderate nevojat për të përmbushur formalitetet doganore të përcaktuara në legjislacionin doganor si dhe natyrën e qëllimin e shkëmbimit e të ruajtjes së informacionit, sipas pikës 1, të nenit 17;

b) rastet specifike të përdorimit të mënyrave të tjera të shkëmbimit dhe ruajtjes së informacionit, të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave që mund të përdoren në përputhje me shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 17;

c) lloji i informacionit dhe të dhënat që duhet të përmbajnë regjistrimet e përmendura në pikën 4, të nenit 138, dhe në pikën 1, të nenit 194;

ç) kur është e nevojshme, formati dhe kodi i kërkesave të përbashkëta për të dhënat e përmendura në pikën 2, të nenit 17;

d) rregullat e procedurës për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat mund të bëhen me mënyra të tjera nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave, të përmendura në pikën 3, të nenit 17.

Neni 19
Regjistrimi

1. Operatorët ekonomikë, të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë regjistrohen nga autoritetet doganore.

2. Detyrimi i përcaktuar në pikën 1 mund të shtrihet, në raste të veçanta, edhe për operatorë ekonomikë që nuk janë të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Personave të ndryshëm nga operatorët ekonomikë nuk u kërkohet të regjistrohen pranë autoriteteve doganore, përveçse kur parashikohet ndryshe.

4. Rregullat dhe procedurat e regjistrimit të operatorëve ekonomikë, të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, si dhe rregullat për çregjistrimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20
Komunikimi i informacioneve dhe mbrojtja e të dhënave

1. Çdo informacion i marrë nga autoritetet doganore gjatë kryerjes së detyrave të tyre, i cili është i një natyre konfidenciale ose që është marrë në mënyrë konfidenciale, mbulohet nga kushti i sekretit profesional. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2, të nenit 48, ky informacion nuk jepet nga autoritetet kompetente doganore, pa lejen e shprehur të personit ose autoritetit që e ka dhënë atë.

Megjithatë ky informacion mund të jepet pa leje, kur autoritetet doganore janë të detyruara ose të autorizuara ta bëjnë këtë në përputhje me dispozitat në fuqi, veçanërisht me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave ose kur ka lidhje me procedimet gjyqësore.

2. Informacioni konfidencial, i përmendur në pikën 1, mund t'u komunikohet autoriteteve doganore dhe autoriteteve të tjera kompetente të vendeve apo territoreve jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, për qëllime të bashkëpunimit doganor me ato vende apo territore, bazuar në një marrëveshje ndërkombëtare ose në legjislacionin kombëtar në fushën e tregtisë.

3. Çdo dhënie ose komunikim i informacionit, të përmendur në pikat 1 dhe 2, duhet të sigurojë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave, në përputhje të plotë me dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 21
Shkëmbimi i informacionit shtesë ndërmjet autoriteteve doganore dhe operatorëve ekonomikë

1. Autoritetet doganore dhe operatorët ekonomikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të shkëmbejnë çdo informacion, i cili nuk kërkohet në mënyrë specifike nga legjislacioni doganor, veçanërisht për qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë në identifikimin e riskut dhe masat kundërvepruese ndaj tij. Ky shkëmbim bëhet sipas një marrëveshjeje me shkrim dhe mund të përfshijë aksesin e autoriteteve doganore në sistemet kompjuterike të operatorëve ekonomikë.

2. Çdo informacion i dhënë nga njëra palë tek tjetra, gjatë bashkëpunimit të përmendur në pikën 1, është konfidencial, përveçse kur të dyja palët bien dakord ndryshe.

Neni 22
Dhënia e informacionit nga autoritetet doganore

1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e autoriteteve doganore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, për sa kohë nuk është përcaktuar ndryshe në këtë Kod.

2. Çdo person mund të kërkojë informacion lidhur me rregullat dhe zbatimin e procedurave doganore nga autoritetet doganore. Një kërkesë e tillë mund të refuzohet nëse nuk ka lidhje me një aktivitet që ka të bëjë me tregtinë ndërkombëtare të mallrave dhe që do të kryhet realisht.

3. Autoritetet doganore mbajnë kontakte të rregullta me operatorët ekonomikë dhe autoritetet e tjera, të përfshira në tregtinë ndërkombëtare të mallrave. Ato promovojnë transparencën, duke bërë lirisht të disponueshëm pa pagesë dhe përmes internetit, legjislacionin doganor, aktet nënligjore dhe formularët e aplikimit.

Neni 23
Dhënia e informacionit autoriteteve doganore

1. Çdo person, i përfshirë direkt apo indirekt në përmbushjen e formaliteteve doganore ose në kontrollet doganore, duhet, me kërkesë të autoriteteve doganore dhe brenda afateve kohore të caktuara, t'u japë këtyre autoriteteve të gjitha dokumentet dhe informacionin e kërkuar në një formë të përshtatshme dhe të gjithë asistencën e nevojshme për përmbushjen e këtyre formaliteteve ose kontrolleve.

2. Depozitimi i një deklarate doganore, i një deklarate të magazinimit të përkohshëm, i një deklarate përmbledhëse të hyrjes, deklarate përmbledhëse të daljes, deklarate rieksporti ose njoftimi rieksporti nga një person drejt autoriteteve doganore ose dorëzimi i një aplikimi për një autorizim apo çdo vendim tjetër e bën këtë person përgjegjës për:

a) saktësinë dhe tërësinë e informacionit të dhënë në deklaratë, në njoftim ose aplikim;

b) autenticitetin, vërtetësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti që shoqëron deklaratën, njoftimin ose aplikimin;

c) kur është e zbatueshme, përputhjen me të gjitha detyrimet që kanë lidhje me vendosjen e mallrave në fjalë nën një regjim doganor apo me kryerjen e operacioneve të autorizuara.

Pika 1 zbatohet gjithashtu edhe për marrjen e çdo informacioni në çfarëdo forme tjetër që është kërkuar nga/ose dhënë tek autoritetet doganore.

Në rastet kur deklarata ose njoftimi është depozituar, aplikimi është paraqitur ose informacioni është siguruar nga një përfaqësues doganor i personit në fjalë, siç përcaktohet në nenin 24, përfaqësuesi doganor gjithashtu është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 1.

SEKSIONI 2
PËRFAQËSIMI NË DOGANË

Neni 24
Përfaqësuesi doganor

1. Çdo person mund të caktojë një përfaqësues doganor.

Një përfaqësim i tillë mund të jetë ose direkt, në rastin kur përfaqësuesi doganor vepron në emër e për llogari të një personi tjetër, ose i tërthortë, kur përfaqësuesi doganor vepron në emër të tij, por për llogari të një personi tjetër.

2. Një përfaqësues doganor duhet të jetë i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen kushtet nën të cilat një përfaqësues doganor mund të ofrojë shërbime në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25
E drejta e përfaqësimit

1. Kur bëhen veprime me autoritetet doganore, një përfaqësues doganor duhet të deklarojë që ai po vepron për llogari të personit që përfaqëson dhe të specifikojë nëse përfaqësimi është i drejtpërdrejtë apo i tërthortë.

Një person, i cili nuk deklaron që po vepron si një përfaqësues doganor ose kur deklaron që po vepron si një përfaqësues doganor, pa aktin ligjor të përfaqësimit për të vepruar si i tillë, konsiderohet sikur po vepron në emër dhe për llogari të tij.

2. Autoritetet doganore mund t'i kërkojnë çdo personi, i cili deklaron që po vepron si një përfaqësues doganor, prova që atij i është lëshuar akti ligjor i përfaqësimit nga i përfaqësuari.

3. Në raste të veçanta autoritetet doganore mund të mos kërkojnë paraqitjen e këtyre provave.

4. Autoritetet doganore nuk do t'i kërkojnë një personi që vepron si përfaqësues doganor e që kryen rregullisht veprime ose formalitete për të siguruar për çdo rast prova të së drejtës së përfaqësimit, duke prezumuar që ky person është në gjendje të sigurojë të tilla prova me kërkesë të autoriteteve doganore.

Neni 26
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet kur nga autoritetet doganore nuk kërkohet akti ligjor i përfaqësimit, i referuar në pikën 2, të nenit 25;

b) rregullat procedurale për zbatimin e pikës 3, të nenit 25.

SEKSIONI 3
VENDIMET E FAVORSHME NË LIDHJE ME ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT DOGANOR

Neni 27
Vendimet e favorshme që merren mbi baza aplikimi

1. Kur një person aplikon për marrjen e një vendimi në favor të tij, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, ky person duhet të vërë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar nga autoritetet doganore kompetente, në mënyrë që ato të jenë në gjendje për të marrë këtë vendim.

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin doganor, një vendim i tillë gjithashtu mund të kërkohet nga/dhe të merret në lidhje me disa persona.

Përveçse kur parashikohet ndryshe, autoritet doganor kompetent është ai i vendit ku aplikuesi mban kontabilitetin kryesor për qëllime doganore dhe ku ai kryen të paktën një pjesë të aktivitetit që përfshihet në vendim.

2. Autoritetet doganore, maksimumi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit për një vendim të favorshëm, verifikojnë nëse janë përmbushur kushtet për pranimin e këtij aplikimi.

Kur autoritetet doganore arrijnë në përfundimin se aplikimi përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që mundëson marrjen e një vendimi prej tyre, ato ia komunikojnë aplikuesit pranimin e aplikimit brenda afatit të sipërpërmendur.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, një vendim, siç përmendet në pikën 1, merret dhe i njoftohet pa vonesë aplikuesit, maksimumi brenda 120 ditëve nga data e pranimit të aplikimit.

Kur autoritetet doganore nuk janë në gjendje të përmbushin afatin kohor për marrjen e vendimit, ato duhet ta informojnë aplikuesin për këtë fakt para mbarimit të këtij afati, duke deklaruar arsyet dhe duke përcaktuar afatin tjetër kohor, të cilin ato e konsiderojnë të nevojshëm për të marrë një vendim. Përveçse kur është përcaktuar ndryshe, afati shtesë i përcaktuar nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë.

Pa rënë ndesh me paragrafin e dytë të kësaj pike, autoritetet doganore mund ta zgjatin afatin kohor për marrjen e një vendimi, siç përcaktohet në legjislacionin doganor, kur aplikuesi kërkon një zgjatje të afatit, me qëllim që të kryejë rregullimet e duhura për të siguruar plotësimin e kushteve e të kritereve. Këto përmirësime dhe afati i mëtejshëm, i nevojshëm për plotësimin e kushteve dhe kritereve, u komunikohet autoriteteve doganore, të cilat do të marrin vendim për zgjatjen e afatit.

4. Përveçse kur përcaktohet ndryshe në vendim ose në legjislacionin doganor, vendimi i favorshëm hyn në fuqi në datën, në të cilën aplikuesi e merr vendimin ose konsiderohet sikur ta ketë marrë atë. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2, të nenit 46, vendimet e miratuara zbatohen nga autoritetet doganore që nga kjo datë.

5. Përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin doganor, vendimi është i vlefshëm pa afat kohor.

6. Para se të refuzojnë marrjen e një vendimi të favorshëm për aplikuesin, autoritetet doganore i komunikojnë atij arsyet, mbi të cilat ato do të mbështetin vendimin e tyre, duke i dhënë edhe mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tij brenda një afati të caktuar, që nga data kur është bërë komunikimi ose që konsiderohet si i bërë. Pas mbarimit të këtij afati kohor, aplikuesi njoftohet për vendimin.

Paragrafi i mësipërm nuk aplikohet në rastet e mëposhtme:

a) kur ka lidhje me një vendim të referuar në pikën 1, të nenit 36;

b) në rast të refuzimit të përfitimit nga një kuotë tarifore, kur është arritur volumi specifik i kuotës tarifore, përcaktuar në paragrafin e parë, të pikës 4, të nenit 56;

c) kur natyra ose niveli i një kërcënimi për sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë e të qytetarëve të saj, shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve e kërkon këtë;

ç) kur vendimi synon të sigurojë zbatimin e një vendimi tjetër, për të cilin është zbatuar paragrafi i parë, i kësaj pike;

d) kur cenon hetime të filluara për qëllime të luftës kundër mashtrimit;

dh) në raste të tjera të veçanta.

7. Kur refuzohet marrja e një vendimi të favorshëm për aplikuesin duhet të jepen arsyet mbi të cilat është bazuar, si dhe të vihet në dukje edhe e drejta për ankim, e parashikuar në nenin 45.

Neni 28
Mbikëqyrja e vendimeve të favorshme të marra në bazë të aplikimeve

1. Personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga ky vendim.

2. Pasi vendimi është marrë, personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, informon autoritetet doganore pa vonesë për çdo faktor të krijuar, i cili mund të ndikojë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e vendimit.

3. Pa cenuar dispozitat e përcaktuara në fusha të tjera, që specifikojnë rastet, në të cilat vendimet janë të pavlefshme ose anulohen, autoritetet doganore, të cilat kanë marrë një vendim të favorshëm, mund në çdo kohë ta anulojnë, ta ndryshojnë ose ta revokojnë atë kur ai nuk është në përputhje me legjislacionin doganor.

4. Në raste të veçanta autoritetet doganore mund:

a) të rivlerësojnë një vendim të favorshëm;

b) të pezullojnë vendimin, nëse nuk është rasti për ta anuluar, revokuar ose ndryshuar atë.

5. Autoritetet doganore mbikëqyrin kushtet dhe kriteret që duhen përmbushur nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi i favorshëm. Ato gjithashtu mbikëqyrin përputhshmërinë me detyrimet që rrjedhin prej vendimit. Kur personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, është regjistruar (themeluar aktiviteti) prej një periudhe për më pak se 3 vjet, autoritetet doganore duhet ta mbikëqyrin nga afër atë gjatë gjithë vitit të parë pas marrjes së vendimit.

Neni 29
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) përjashtimet e paragrafit të tretë, të pikës 1, të nenit 27;

b) kushtet për pranimin e aplikimit, referuar pikës 2, të nenit 27;

c) afatet kohore për të marrë një vendim të caktuar, duke përfshirë zgjatjet e mundshme të këtij afati, në përputhje me pikën 3, të nenit 27;

ç) rastet e referuara në pikën 4, të nenit 27, kur vendimi është i zbatueshëm nga një datë, që është e ndryshme nga data, në të cilën aplikuesi ka marrë ose konsiderohet se ka marrë vendimin;

d) rastet e referuara në pikën 5, të nenit 27, kur vlefshmëria e një vendimi është e kufizuar në kohë;

dh) afati i përmendur në paragrafin e parë, të pikës 6, të nenit 27;

e) rastet e veçanta të përmendura në shkronjën "dh", të paragrafit të dytë, të pikës 6, të nenit 27, kur aplikuesit nuk i është dhënë mundësia të shprehë pikëpamjen e tij;

ë) rastet dhe rregullat për rivlerësimin dhe pezullimin e vendimeve, në përputhje me pikën 4, të nenit 28;

f) rregullat dhe procedurat për dorëzimin dhe pranimin e aplikimit për një vendim, sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 27;

g) rregullat dhe procedurat për marrjen e vendimit, sipas nenit 27;

gj) rregullat dhe procedurat për mbikëqyrjen e vendimit, në përputhje me pikën 5, të nenit 28.

Neni 30
Shtrirja e vlefshmërisë së vendimeve të favorshme

Vendimet e favorshme, lidhur me zbatimin e legjislacionit doganor, janë të vlefshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur efekti i tyre është i kufizuar për një ose disa zyra doganore.

Neni 31
Anulimi i vendimeve të favorshme

1. Autoritetet doganore anulojnë një vendim në favor të personit, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në qoftë se plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) vendimi është marrë bazuar në informacion të pasaktë ose të paplotë;

b) personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, ishte në dijeni ose objektivisht duhej të ishte në dijeni që informacioni i dhënë ishte i pasaktë ose i paplotë.

2. Personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, duhet të njoftohet për anulimin e tij.

3. Anulimi i shtrin efektet që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit fillestar, përveçse kur, në përputhje me legjislacionin doganor, në vendim specifikohet ndryshe.

Neni 32
Revokimi dhe ndryshimi i vendimeve të favorshme

1. Përveç rasteve të përcaktuara në nenin 31, një vendim në favor të aplikuesit revokohet ose ndryshohet:

a) edhe kur një apo më shumë nga kushtet, në bazë të të cilave është marrë një vendim, nuk ishin përmbushur ose nuk përmbushen më; ose

b) me aplikim nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe, një vendim i marrë në favor të disa personave mund t'i revokohet vetëm personit, i cili nuk plotëson një detyrim të ngarkuar, sipas atij vendimi.

3. Personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, duhet të njoftohet për revokimin ose ndryshimin e tij, si dhe të drejtën e ankimit.

4. Pika 4, e nenit 27, zbatohet edhe në rastet e revokimit ose ndryshimit të vendimit.

Megjithatë, në raste të veçanta, kur e kërkojnë interesat legjitimë të personit, ndaj të cilit është dhënë vendimi, autoritetet doganore mund ta shtyjnë datën e shtrirjes së efekteve të revokimit ose ndryshimit deri në një vit. Kjo datë duhet të përcaktohet në vendimin e revokimit apo të ndryshimit.

Neni 33
Vendimet e marra pa një aplikim

Në rastet e parashikuara në pikat 4, 5, 6 dhe 7, të nenit 27, pika 3, e nenit 28, dhe nenet 30, 31 dhe 32, autoritetet doganore mund të marrin vendim edhe në mungesë të një aplikimi nga personi i interesuar.

Neni 34
Kufizime për vendimet që kanë të bëjnë me mallrat e vendosura nën një regjim doganor ose në magazinim të përkohshëm

Me përjashtim të rastit kur personi i interesuar e kërkon, revokimi, ndryshimi apo pezullimi i një vendimi të favorshëm nuk i shtrin efektet mbi mallrat, të cilat, në momentin kur revokimi, ndryshimi apo pezullimi hyjnë në fuqi, kanë qenë dhe janë të vendosura në një regjim doganor ose në magazinim doganor dhe që kanë lidhje me vendimin e revokimit, ndryshimit apo pezullimit.

Neni 35
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 32, kur një vendim i favorshëm, i marrë për disa persona, mund t'u revokohet gjithashtu edhe personave të tjerë, të ndryshëm nga personi, i cili nuk ka plotësuar një detyrim të ngarkuar, sipas atij vendimi;

b) rastet përjashtimore kur autoritetet doganore shtyjnë datën, në të cilën revokimi ose ndryshimi hyn në fuqi, në përputhje me paragrafin e dytë, të pikës 4, të nenit 32;

c) rregullat procedurale për anulimin, revokimin ose ndryshimin e vendimeve të favorshme.

Neni 36
Vendime për informacionin detyrues

1. Autoritetet doganore, në bazë të aplikimeve, marrin vendime për informacionin detyrues tarifor ("vendime IDT") ose vendime për informacionin detyrues të origjinës ("vendime IDO").

Një aplikim i tillë nuk pranohet në njërën prej rrethanave të mëposhtme:

a) kur aplikimi bëhet ose është bërë pranë autoriteteve doganore nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, ose në interes të tij, për sa u përket të njëjtave mallra dhe për "vendimet IDO", sipas të njëjtave rrethana, që përcaktojnë marrjen e origjinës;

b) kur aplikimi nuk është i lidhur me ndonjë përdorim të parashikuar në "vendimin IDT" apo "vendimin IDO" ose me ndonjë përdorim të parashikuar të një regjimi doganor.

2. "Vendimet IDT ose IDO" janë detyruese vetëm për sa i përket klasifikimit tarifor ose përcaktimit të origjinës së mallrave për:

a) autoritetet doganore kundrejt personit, ndaj të cilit është dhënë vendimi, vetëm për sa u përket mallrave, për të cilat formalitetet doganore janë përfunduar, pas datës së hyrjes në fuqi të vendimit;

b) personin, ndaj të cilit është dhënë vendimi, kundrejt autoriteteve doganore, nga data kur ka marrë ose konsiderohet të ketë marrë njoftimin e vendimit.

3. "Vendimet IDT ose IDO" janë të vlefshme për një afat prej tre vjetësh nga data në të cilën vendimi hyn në fuqi.

4. Për zbatimin e një "vendimi IDT ose IDO", në kontekstin e një regjimi doganor të veçantë, personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, duhet të jetë i aftë të provojë që:

a) në rastin e një "vendimi IDT", mallrat e deklaruara korrespondojnë në çdo aspekt me ato të përshkruara në vendim;

b) në rastin e një "vendimi IDO", mallrat në fjalë dhe rrethanat që përcaktojnë marrjen e origjinës korrespondojnë në çdo aspekt me mallrat dhe rrethanat e përshkruara në vendim.

Neni 37
Administrimi i vendimeve të lidhura me informacionin detyrues

1. Një "vendim IDT" humb vlefshmërinë përpara përfundimit të periudhës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 36, kur ai nuk është më në përputhje me ligjin, si rezultat i njërës prej përcaktimeve të mëposhtme:

a) ndryshimit të nomenklaturave, të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 56;

b) ndryshimit të masave, të përcaktuara në pikën 3, të nenit 57, me efekt që nga data e zbatimit të këtyre ndryshimeve apo masave.

2. Një "vendim IDO" humb vlefshmërinë përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 3, të nenit 36, në një nga rastet e mëposhtme:

a) kur një ligj i miratuar ose një marrëveshje e nënshkruar ka hyrë në fuqi dhe ky vendim nuk është më në përputhje me ligjin, me efekt që nga data e zbatimit të ligjit apo marrëveshjes;

b) kur nuk është më në përputhje me marrëveshjen për rregullat e origjinës, të vendosura nga Organizata Botërore e Tregtisë, ose me shënimet shpjeguese apo me një opinion për origjinën, të miratuar për interpretimin e kësaj marrëveshjeje, me efekt nga data e njoftimit të autoriteteve doganore nga sekretariati i OBT-së në Shqipëri.

3. Humbja e vlefshmërisë së një "vendimi IDT ose IDO" nuk ka efekt prapaveprues.

4. Duke anashkaluar pikën 3, të nenit 28, dhe nenin 31, "vendimet IDT ose IDO" anulohen kur ato janë bazuar në informacion të pasaktë ose të paplotë, të dhënë nga aplikuesi.

5. "Vendimet IDT ose IDO" revokohen në përputhje me pikën 3, të nenit 28, dhe me nenin 32.

Megjithatë këto vendime nuk revokohen me aplikim nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi.

6. "Vendimet IDT ose IDO" nuk mund të ndryshohen.

7. Autoritetet doganore revokojnë "vendimet IDT":

a) kur ato nuk janë më në përputhje me interpretimin e ndonjërës prej nomenklaturave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 56;

b) në raste të tjera specifike.

8. "Vendimet IDO" revokohen:

a) kur nuk janë më në përputhje me legjislacionin që rregullon fushën specifike, për shkak të ndryshimit të këtij legjislacioni;

b) në raste të tjera specifike.

9. Kur zbatohet shkronja "b", e pikës 1, ose pikat 2, 7 ose 8, të këtij neni, një "vendim IDT ose IDO" mund të vazhdojë të përdoret në zbatim të kontratave detyruese, të bazuara në atë vendim dhe që janë nënshkruar përpara humbjes së vlefshmërisë apo revokimit të vendimit. Shtyrja e përdorimit të një "vendimi IDO" nuk zbatohet kur vendimi është marrë për mallra që eksportohen.

Shtyrja e përdorimit, e përcaktuar sipas paragrafit të mësipërm, nuk duhet të jetë më e gjatë se 6 muaj nga data në të cilën një "vendim IDT ose IDO" humb vlefshmërinë ose revokohet.

Me qëllim përfitimin nga shtyrja e përdorimit të një "vendimi IDT ose IDO", personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, depoziton një aplikim pranë autoriteteve doganore që e kanë marrë atë vendim, brenda 30 ditëve nga data që ai ka humbur vlefshmërinë ose është revokuar.

Neni 38

Vendime për informacione detyruese e që kanë lidhje me faktorë të tjerë

Në raste specifike, autoritetet doganore, në bazë të aplikimit, marrin vendime për informacione detyruese e që kanë lidhje me faktorë të tjerë, të përcaktuar në titullin II të këtij Kodi, në bazë të të cilave janë aplikuar detyrimet e importit ose të eksportit dhe masa të tjera të karakterit tregtar.

Neni 39

Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet specifike, të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 7, të nenit 37, dhe shkronjës "b", të pikës 8, të nenit 37, kur "vendimet IDT dhe IDO" revokohen;

b) rastet e përcaktuara në nenin 38, kur vendimet për informacione detyruese janë marrë duke pasur lidhje me faktorë të tjerë, në bazë të të cilëve janë aplikuar detyrimet e importit ose të eksportit dhe masa të tjera të karakterit tregtar;

c) rregullat procedurale për përdorimin e një "vendimi IDT ose IDO", pasi ai humb vlefshmërinë apo revokohet, në përputhje me pikën 9, të nenit 37;

ç) rregullat procedurale për përdorimin e vendimeve të përcaktuara në nenin 38, dhe të vendosura në përputhje me shkronjën "b", të këtij neni, pasi ato humbasin vlefshmërinë.

SEKSIONI 4

OPERATORI EKONOMIK I AUTORIZUAR

Neni 40

Aplikimi dhe autorizimi

1. Një operator ekonomik, i cili është i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe përmbush kriteret e vendosura në nenin 41, mund të aplikojë për statusin e operatorit ekonomik të autorizuar.

Nëse vlerësohet e nevojshme, autoritetet doganore mund të konsultohen me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit sa i takon verifikimit të plotësimit të kritereve të përcaktuara në nenin 41. Vendimi për dhënien e statusit të operatorit ekonomik të autorizuar është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme.

2. Statusi i operatorit ekonomik të autorizuar ka të bëjë me llojet e autorizimeve të mëposhtme:

a) atë të një operatori ekonomik të autorizuar për "thjeshtësime doganore", i cili i mundëson mbajtësit të tij përfitime për disa thjeshtësime, në përputhje me legjislacionin doganor; ose

b) atë të një operatori ekonomik të autorizuar për "sigurinë dhe mbrojtjen", i cili i mundëson mbajtësit të tij lehtësi që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen.

3. Të dyja llojet e autorizimeve, të përcaktuara në pikën 2, mund të mbahen njëkohësisht.

4. Autoritetet doganore, në bazë të njohjes të statusit të operatorit ekonomik të autorizuar për thjeshtësi doganore dhe me kusht që të jenë plotësuar kërkesat që lidhen me një lloj specifik të thjeshtësimit, autorizojnë operatorin për të përfituar nga ky thjeshtësim. Autoritetet doganore nuk rishqyrtojnë ato kritere, të cilat janë shqyrtuar një herë kur është dhënë statusi i operatorit ekonomik të autorizuar.

5. Operatori ekonomik i autorizuar, i përcaktuar në pikën 2, gëzon trajtim më të favorshëm se operatorët e tjerë ekonomikë përsa u përket kontrolleve doganore, në përputhje me llojin e autorizimit të dhënë, duke përfshirë më pak kontrolle fizike dhe dokumentare.

Neni 41

Dhënia e statusit

Aplikuesi, për t'iu dhënë statusi i operatorit ekonomik të autorizuar, duhet të plotësojë këto kritere:

a) të mos ketë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të legjislacionit doganor dhe tatimor;

b) të mos jetë i proceduar penalisht për vepra penale që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikuesit;

c) të demonstrojë një nivel të lartë kontrolli të veprimeve të tij dhe të lëvizjes së mallrave me anë të një sistemi që menaxhon regjistrimet tregtare dhe, kur është

me vend, edhe regjistrimet e transportit, i cili lejon kryerjen e kontrolleve të duhura doganore;

ç) të ketë aftësi paguese që do të kërkohen për të provuar nëse aplikuesi ka gjendje të mirë financiare, e cila i lejon atij të përmbushë angazhimet që rrjedhin e lidhen me karakteristikat e llojit të aktivitetit në fjalë;

d) për sa i takon autorizimit të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 40, të ketë standardet praktike të kompetencave ose kualifikimeve profesionale që lidhen direkt me aktivitetin e kryer;

dh) për sa i takon autorizimit, të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 40, të ketë standardet e duhura të sigurisë dhe mbrojtjes, të cilat konsiderohen të plotësuara kur aplikuesi tregon se ai siguron masat e duhura për zbatimin e sigurisë dhe mbrojtjes së zinxhirit tregtar ndërkombëtar, përfshirë fushat e integritetit fizik dhe kontrollit të aksesit, proceset logjistike dhe trajtimet për lloje të veçanta mallrash, personel dhe identifikimin e partnerëve të tij të biznesit.

Neni 42
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) thjeshtësitë e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 40;

b) lehtësitë e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 40;

c) trajtimet më të favorshme, të përcaktuara në pikën 5, të nenit 40;

ç) modalitetet për aplikimin e kritereve, të përcaktuara në nenin 41.

SEKSIONI 5
SANKSIONET

Neni 43
Zbatimi i sanksioneve

Autoritetet doganore në Republikën e Shqipërisë vendosin sanksionet për shkeljet lidhur me vendimet e favorshme, në përputhje me legjislacionin doganor. Sanksione të tilla duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese. Sanksionet zbatohen pavarësisht nga aplikimi i mundshëm i revokimit, anulimit apo ndryshimit të një vendimi.

SEKSIONI 6
ANKIMET

Neni 44
Vendimet e marra nga një autoritet gjyqësor

Nenet 45 dhe 46 nuk zbatohen për ankime të depozituara për qëllime të anulimit, revokimit ose ndryshimit të një vendimi, që ka lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor dhe që është marrë nga një autoritet gjyqësor ose nga organet doganore kur veprojnë si autoritete gjyqësore.

Neni 45
E drejta e ankimit

1. Çdo person ka të drejtë të ankimojë vendimet e marra nga autoritetet doganore për refuzimin e një aplikimi apo vendimin për anulimin ose revokimin e një vendimi të favorshëm, i cili ka të bëjë me të drejtpërdrejt dhe individualisht.

Çdo person mund të ushtrojë të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në rastet kur ka aplikuar pranë autoriteteve doganore për një vendim të favorshëm dhe nuk është respektuar afati i përcaktuar në pikën 3, të nenit 27.

2. E drejta e ankimit mund të ushtrohet:

a) duke paraqitur ankim përpara autoriteteve doganore ose një strukture specifike, të krijuar për këtë qëllim;

b) pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit të ankimit administrativ, duke iu drejtuar me padi gjykatës kompetente, sipas dispozitave në fuqi.

3. Personi i interesuar mund të ankohet, sipas paragrafit të parë të pikës 1, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vendos brenda 30 ditëve për pranimin ose jo të ankimit.

4. Personi i interesuar mund të ankohet sipas paragrafit të dytë, të pikës 1, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, brenda 15 ditëve nga data e mbarimit të këtij afati. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vendos brenda 30 ditëve për pranimin ose jo të ankimit.

5. Në rast se anulimi apo revokimi i një vendimi të favorshëm shoqërohet edhe me sanksione, të përcaktuara në titullin IX të këtij Kodi, procedura e ankimit kryhet në përputhje me nenet 281 dhe 282.

Neni 46
Pezullimi i zbatimit

1. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit të ankimuar.

2. Megjithatë, autoritetet doganore pezullojnë zbatimin e një vendimi të ankimuar, tërësisht ose pjesërisht, kur ato kanë arsye të besojnë që vendimi i ankimuar është i papajtueshëm me legjislacionin doganor ose sjell një dëm të pariparueshëm për personin e interesuar.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2, kur vendimi i ankimuar shkakton detyrime importi ose eksporti për t'u paguar, pezullimi i këtij vendimi duhet të kushtëzohet me dhënien/depozitimin e një garancie, përveçse kur, duke u mbështetur në një vlerësim të dokumenteve, vërtetohet se kjo garanci mund t'i

shkaktojë debitorit vështirësi serioze ekonomike ose sociale.

SEKSIONI 7
KONTROLLI I MALLRAVE

Neni 47
Menaxhimi i riskut dhe kontrollet doganore

1. Autoritetet doganore mund të kryejnë të gjitha kontrollet doganore që i vlerësojnë të nevojshme.

Kontrollet doganore mund të konsistojnë në veçanti në verifikimin e mallrave, marrjen e mostrave, verifikimin e informacionit të dhënë në një deklaratë ose njoftim nëse është i vërtetë dhe i plotë, si dhe ekzistencën e tij, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e dokumenteve, shqyrtimin e llogarive të operatorëve ekonomikë dhe regjistrime të tjera, inspektimin e mjeteve të transportit, inspektimin e bagazheve e të mallrave të tjera që sjellin ose mbajnë personat dhe kryerjen e hetimeve zyrtare ose veprime të tjera të ngjashme.

2. Kontrollet doganore, përveç kontrolleve të rastësishme, mbështeten kryesisht në analizën e riskut, duke përdorur teknika elektronike të përpunimit të të dhënave, me qëllim identifikimin e vlerësimin e riskut dhe zhvillimin e masave kundërvepruese të nevojshme, në bazë të kritereve të hartuara në nivel kombëtar dhe, aty ku janë të disponueshme, në nivel ndërkombëtar.

3. Kontrollet doganore kryhen brenda një kornize të përbashkët të menaxhimit të riskut, duke u bazuar në shkëmbimin e informacionit për risqet dhe rezultatet e analizave të riskut ndërmjet administratave doganore homologe, duke vendosur kritere dhe standarde risku të përbashkëta, duke marrë masa kontrolli e duke përcaktuar fusha prioritare kontrolli.

Kontrollet e mbështetura në këto informacione dhe kritere do të kryhen pa cenuar kontrollet e tjera të kryera në përputhje me pikën 1 ose me dispozitat e tjera në fuqi.

4. Autoritetet doganore përdorin menaxhimin e riskut për të diferencuar nivelet e riskut, që lidhen me mallrat që janë objekt i kontrollit ose i mbikëqyrjes doganore dhe për të vendosur kryerjen ose jo të kontrolleve specifike mbi këto mallra. Në rastin e një vendimi për kontroll përcaktohet edhe vendi ku kryhet kontrolli.

Menaxhimi i riskut përfshin veprime të tilla, si mbledhja e të dhënave dhe informacioneve, analizimi dhe vlerësimi i riskut, evidentimi dhe ndërmarrja e veprimeve, monitorimi i vazhdueshëm dhe rishikimi i këtij procesi dhe i rezultateve të tij, bazuar në burime dhe strategji kombëtare dhe ndërkombëtare.

5. Autoritetet doganore shkëmbejnë informacione për risqet dhe rezultatet e analizave të riskut kur:

a) këto autoritete vlerësojnë se risqet janë të larta dhe kërkojnë kontroll doganor dhe kur rezultatet e kontrollit tregojnë se ngjarja, e cila ishte vlerësuar me risk, ka ndodhur; ose

b) rezultatet e kontrollit tregojnë që ngjarja, e cila ishte vlerësuar me risk, nuk ka ndodhur, por autoritetet doganore vlerësojnë se risku mund të jetë i lartë për një administratë tjetër doganore.

6. Për përcaktimin e kritereve dhe standardeve të përbashkëta në fushën e riskut, si dhe të masave e fushave të kontrolleve prioritare, të parashikuara në pikën 3, mbahen parasysh të gjitha elementet si më poshtë:

a) proporcionaliteti i riskut;

b) urgjenca e nevojës së zbatimit të kontrolleve;

c) ndikimi i mundshëm mbi shkëmbimet tregtare dhe mbi burimet e nevojshme për këto kontrolle.

7. Kriteret dhe standardet e përbashkëta, të përcaktuara në pikën 3, përfshijnë të gjitha elementet e mëposhtme:

a) një përshkrim të risqeve;

b) faktorët ose indikatorët e riskut që duhet të përdoren për të përzgjedhur mallrat ose operatorët ekonomikë për kontroll doganor;

c) llojin e kontrolleve doganore që duhet të ndërmerren nga autoritetet doganore;

ç) kohëzgjatjen e kryerjes së kontrolleve doganore, të përcaktuara në shkronjën "c".

8. Fushat e kontrolleve prioritare mbulojnë regjime doganore të caktuara, lloje mallrash, itinerare lëvizjesh, mënyra transporti ose operatorë ekonomikë, të cilët, gjatë një periudhe të caktuar, janë objekt i analizës së riskut dhe i kontrolleve doganore të niveleve më të larta, pa rënë ndesh me kontrollet e zakonshme që kryhen nga autoritetet doganore.

Neni 48
Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve

1. Kur për të njëjtat mallra, përveç kontrolleve doganore, kryhen kontrolle edhe nga autoritete të tjera kompetente, autoritetet doganore, në bashkëpunim të ngushtë me këto të fundit, kur është e mundur, përpiqen t'i kryejnë këto kontrolle në të njëjtin vend e kohë me kontrollin doganor (one-stop-shop). Autoritetet doganore kanë rolin koordinues në këto kontrolle.

2. Me qëllim minimizimin e riskut dhe luftën kundër mashtrimit, në kuadër të kontrolleve të përmendura në këtë seksion, autoritetet doganore dhe institucionet e tjera përgjegjëse, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi mund të shkëmbejnë ndërmjet tyre të dhënat e marra që lidhen me:

a) hyrjen, daljen, transitin, lëvizjen, magazinimin, përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use) të mallrave, përfshirë trafikun postar, që lëvizin ndërmjet territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve ose territoreve që ndodhen jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) praninë dhe qarkullimin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave joshqiptare dhe të mallrave të vendosura në regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use);

c) rezultatet e kontrolleve të kryera.

3. Me qëllim që të sigurohet zbatimi korrekt i legjislacionit doganor, autoritetet doganore bashkëpunojnë me organizma publikë ose privatë, shqiptarë ose të huaj. Mënyrat dhe format e bashkëpunimit e të shkëmbimit të informacionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij Kodi, në akte të tjera ligjore dhe nënligjore apo në marrëveshje bashkëpunimi.

4. Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre.

Neni 49
Kontrolli pas çlirimit të mallrave

Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave, mund të verifikojnë saktësinë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes, deklaratën e rieksportit ose në njoftimin rieksportit, si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti shoqërues.

Gjithashtu, ato mund të verifikojnë kontabilitetin e deklaruesit dhe regjistrime të tjera që lidhen me veprimet që janë kryer mbi mallrat në fjalë ose për veprimet tregtare paraprake ose veprimet në vijim që përfshijnë këto mallra. Autoritetet doganore gjithashtu mund të verifikojnë këto mallra dhe/ose të marrin mostra, nëse ekziston akoma një mundësi e tillë.

Kontrolle të tilla mund të kryhen në ambientet e mbajtësit të mallrave ose përfaqësuesit të tij, të çdo personi tjetër të përfshirë direkt apo indirekt në veprimet e sipërpërmendura, në kuadër të aktivitetit të tij të biznesit, ose të çdo personi tjetër që i zotëron këto dokumente dhe të dhëna për qëllime të aktivitetit të biznesit.

Neni 50
Transporti ajror dhe detar brenda Republikës së Shqipërisë

1. Kontrollet ose formalitetet doganore zbatohen për bagazhet e dorës dhe bagazhet e hambarit të personave që kryejnë një udhëtim ajror ose detar brenda Republikës së Shqipërisë, vetëm kur legjislacioni doganor i parashikon këto kontrolle ose formalitete.

2. Pika 1 zbatohet pa cenuar asnjë prej rasteve të mëposhtme:

a) kontrollet e sigurisë dhe mbrojtjes;

b) kontrollet lidhur me ndalimet ose kufizimet.

Neni 51
Aktet nënligjore

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave nxjerr aktet që përcaktojnë:

1. Masat që sigurojnë zbatimin uniform të kontrolleve doganore, përfshirë shkëmbimin e informacionit mbi riskun dhe mbi rezultatet e analizave të riskut, kriteret dhe standardet e përbashkëta të riskut, masat e kontrollit dhe fushat prioritare të kontrollit, të përcaktuara në pikën 3, të nenit 47;

2. Portet dhe aeroportet, të përcaktuara në nenin 50, ku zbatohen kontrollet dhe formalitetet doganore për:

a) bagazhet e dorës dhe bagazhet e hambarit të personave që:

i) udhëtojnë me një avion, i cili vjen nga një aeroport jashtë Republikës së Shqipërisë dhe që, pas një ndalese në një aeroport shqiptar, vazhdon fluturimin drejt një aeroporti tjetër shqiptar;

ii) udhëtojnë me një avion, i cili ndalon në një aeroport shqiptar përpara se të vazhdojë fluturimin drejt një aeroporti joshqiptar;

iii) përdorin një shërbim detar që ofrohet nga i njëjti mjet lundrimi dhe përfshin ndalesat e njëpasnjëshme që nisen nga, vazhdojnë ose përfundojnë në një port joshqiptar;

iv) janë në bordin e një mjeti për turizëm ose mjeti fluturimi biznesi;

b) bagazhet e dorës dhe bagazhet e hambarit që:

i) mbërrijnë në një aeroport shqiptar në bordin e një avioni që vjen nga një aeroport joshqiptar dhe transferohen në aeroportin shqiptar në një avion tjetër që vazhdon një fluturim kombëtar;

ii) ngarkohen në një avion në një aeroport shqiptar, duke vazhduar me një fluturim kombëtar, për t'u transferuar në një avion tjetër në një aeroport tjetër shqiptar me destinacion një aeroport joshqiptar.

SEKSIONI 8
RUAJTJA E DOKUMENTEVE DHE INFORMACIONEVE TË TJERA, PAGESAT DHE KOSTOT

Neni 52
Ruajtja e dokumenteve dhe e informacioneve të tjera

1. Për qëllime të kontrolleve doganore, personi i interesuar duhet të ruajë dokumentet dhe informacionin e përmendur në pikën 1, të nenit 23, për të paktën tre vjet, në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Në rastin e mallrave të çliruara për qarkullim të lirë në rrethana të tjera nga ato të përmendura në paragrafin

e tretë, të kësaj pike, ose mallrave të deklaruara për eksport, ky afat fillon nga data 31 dhjetor e vitit, në të cilin janë pranuar deklarimet doganore për çlirim për qarkullim të lirë ose për eksport.

Në rastin e mallrave të çliruara për qarkullim të lirë, të përjashtuara nga detyrimet apo me detyrime të reduktuara për arsye të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) të tyre, ky afat fillon nga data 31 dhjetor e vitit, në të cilin mallrat pushojnë së qeni nën mbikëqyrjen doganore.

Në rastin e mallrave të vendosura nën një regjim tjetër doganor ose të mallrave të vendosura në magazinim të përkohshëm, ky afat fillon nga data 31 dhjetor e vitit, në të cilin regjimi doganor në fjalë ka përfunduar ose magazinimi i përkohshëm ka mbaruar.

2. Pa cenuar pikën 4, të nenit 97, kur nga një kontroll doganor, në lidhje me një borxh doganor, rezulton se hedhja përkatëse në kontabilitet/llogari duhet të korrigjohet dhe personi në fjalë është njoftuar për këtë, dokumentet dhe informacioni ruhen për tre vjet përtej afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni.

Kur është depozituar një ankim ose kur ka filluar një proces gjyqësor, dokumentet dhe informacioni duhet të ruhen brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, ose derisa procedura e ankimit apo procesi gjyqësor të përfundojë, cilido që të jetë i fundit.

Neni 53
Pagesat dhe kostot

1. Autoritetet doganore nuk aplikojnë pagesa për kryerjen e kontrolleve doganore ose për procedura të tjera, që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit doganor, gjatë orarit zyrtar të punës së zyrave doganore të tyre.

2. Autoritetet doganore mund të aplikojnë pagesa ose të vjelin shpenzimet për kryerjen e shërbimeve të veçanta si më poshtë:

a) kur nga operatori ekonomik kërkohet prania e personelit doganor jashtë orarit zyrtar të punës ose në ambiente të tjera nga ato doganore;

b) në analizat ose raportet e ekspertëve për mallra dhe tarifa postare që paguhen për kthimin e këtyre mallrave tek aplikuesi, veçanërisht për vendimet e marra në përputhje me nenin 36 ose me dhënien e informacionit, në përputhje me pikën 1, të nenit 22;

c) për kontrollin ose marrjen e mostrave të mallrave për qëllime verifikimi ose për shkatërrimin e mallrave, kur përfshihen shpenzime jo të zakonshme, të tjera nga ato që kryhen nga personeli doganor;

ç) për masat e jashtëzakonshme të kontrollit, kur ato janë të nevojshme për shkak të natyrës së mallrave ose për shkak të një rreziku potencial.

3. Normat e pagesave, për zbatimin e pikës 2, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

KREU IV
KURSI I KËMBIMIT VALUTOR DHE AFATET KOHORE

Neni 54
Kursi i këmbimit valutor

1. Autoritetet doganore publikojnë dhe/ose vënë në dispozicion në internet kursin e këmbimit valutor të zbatueshëm, kur konvertimi i monedhës është i domosdoshëm për një nga arsyet e mëposhtme:

a) për shkak se elementet e përdorura për të përcaktuar vlerën doganore të mallrave janë shprehur në një monedhë tjetër, të ndryshme nga ajo e Republikës së Shqipërisë;

b) për shkak se vlera e monedhës kombëtare kërkohet në euro, me qëllim përcaktimin e klasifikimit tarifor të mallrave dhe shumës së detyrimit të importit e të eksportit, përfshirë pragjet e vlerës në Tarifën Doganore të Republikës së Shqipërisë.

2. Kursi i këmbimit valutor, për qëllim të zbatimit të pikës 1, të këtij neni, publikohet një herë në muaj, me përjashtim të përcaktimeve të pikës 5.

3. Kursi i këmbimit është i vlefshëm duke filluar nga data 6 e çdo muaji deri në datën 5 të muajit pasardhës.

4. Kursi i këmbimit që do të përdoret është kursi i këmbimit i shpallur nga Banka e Shqipërisë në ditën e fundit të punës së muajit paraardhës të periudhës së përmendur në pikën 3.

5. Kur kursi ditor i këmbimit, i shpallur nga Banka e Shqipërisë, është 5 për qind më i madh ose më i vogël se ai i vendosur në përputhje me pikën 4, për t'u përdorur në përputhje me pikën 3, ky i fundit zëvendësohet nga kursi ditor dhe hyn në fuqi në ditën e dytë pas shpalljes dhe përdoret si kurs këmbimi në zbatim të këtij neni për të gjithë periudhën e mbetur.

6. Kur këmbimi valutor është i nevojshëm për arsye të tjera nga ato të përmendura në pikën 1, kursi i këmbimit, që do të aplikohet brenda kuadrit të legjislacionit doganor, caktohet të paktën një herë në vit.

Neni 55
Periudhat, datat dhe afatet kohore

Përveçse kur parashikohet ndryshe, kur një periudhë kohore, datë ose afat kohor është përcaktuar në legjislacionin doganor, kjo periudhë kohore nuk mund të zgjatet apo të shkurtohet dhe data ose afati kohor nuk mund të shtyhet ose të afrohet në kohë.

TITULLI II
FAKTORËT MBI BAZËN E TË CILËVE ZBATOHEN DETYRIMET E IMPORTIT OSE EKSPORTIT DHE MASAT E TJERA NË KUADËR TË TREGTISË SË MALLRAVE

KREU I
TARIFA DOGANORE DHE KLASIFIKIMI TARIFOR I MALLRAVE

Neni 56
Tarifa Doganore dhe mbikëqyrja

1. Detyrimet e importit dhe eksportit bazohen në Tarifën Doganore të Republikës së Shqipërisë.

Masat e tjera, të parashikuara nga dispozitat që rregullojnë fusha të veçanta, që kanë të bëjnë me tregtinë e mallrave, zbatohen, kur është e përshtatshme, në përputhje me klasifikimin tarifor të këtyre mallrave.

2. Tarifa Doganore e Republikës së Shqipërisë përfshin:

a) Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, bazuar në Sistemin e Harmonizuar;

b) çdo nomenklaturë tjetër, të bazuar tërësisht apo pjesërisht në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave ose çdo nënndarje të mëtejshme të saj që përcaktohet nga dispozita të tjera që rregullojnë fushat e veçanta, me synim zbatimin e masave tarifore që kanë të bëjnë me tregtinë e mallrave;

c) nivelet e detyrimeve doganore ose autonome normale që zbatohen për mallrat e përfshira në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave;

ç) masat tarifore preferenciale, të përcaktuara në marrëveshjet që Republika e Shqipërisë ka lidhur me një vend ose territor të caktuar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose grup-vendeve apo territoreve;

d) masat tarifore preferenciale, të miratuara në mënyrë të njëanshme nga Republika e Shqipërisë për sa u përket disa vendeve ose territoreve jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose disa grup-vendeve apo territoreve;

dh) masat autonome që parashikojnë një reduktim ose përjashtim nga detyrimet doganore për mallra të caktuara;

e) trajtimin tarifor favorizues të specifikuar për mallra të caktuara, për shkak të natyrës apo përdorimit të tyre të veçantë përfundimtar (end-use), në kuadër të masave të përmendura nga shkronja "c" deri në "dh" ose "ë";

ë) masa të tjera tarifore, të parashikuara nga legjislacioni bujqësor apo tregtar ose çdo legjislacion tjetër i Republikës së Shqipërisë.

3. Kur mallrat në fjalë plotësojnë kushtet e përcaktuara në masat e përmendura nga shkronja "ç" deri në "e", të pikës 2, me aplikim të deklaruesit, masat e përmendura në këto dispozita zbatohen në vend të atyre të parashikuara në shkronjën "c", të kësaj pike. Një aplikim i tillë mund të bëhet edhe më pas, me kusht që të plotësohen afatet kohore dhe kushtet e përcaktuara në masat përkatëse ose në Kodin Doganor.

4. Kur zbatimi i masave të përmendura nga shkronja "ç" deri në "e", të pikës 2, ose përjashtimi nga masat e përmendura në shkronjën "ë" kufizohet në një sasi të caktuar importesh apo eksportesh, zbatimi i masës apo përjashtimi nga masa, në rastin e kuotave tarifore, humbin vlefshmërinë sapo arrihet kufiri i sasisë së përcaktuar të importeve apo eksporteve.

Në rastin e tavaneve tarifore, zbatimi i masave pushon së ekzistuari me anë të një akti ligjor.

5. Çlirimi për qarkullim të lirë ose eksporti i mallrave, mbi të cilat zbatohen masat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të jenë objekt i mbikëqyrjes doganore.

Neni 57
Klasifikimi tarifor i mallrave

1. Me qëllim zbatimin e Tarifës Doganore të Republikës së Shqipërisë, klasifikimi tarifor i mallrave konsiston në përcaktimin e njërit prej nënkrerëve apo nënndarjeve të mëtejshme të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, sipas të cilave këto mallra klasifikohen.

2. Me qëllim zbatimin e masave jotarifore, klasifikimi tarifor i mallrave konsiston në përcaktimin e njërit prej nënkrerëve apo nënndarjeve të mëtejshme të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave ose të çdo nomenklature tjetër, e cila është e përcaktuar nga dispozita të tjera dhe që është e bazuar tërësisht ose pjesërisht në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave ose që parashikon nënndarje të mëtejshme të saj, sipas të cilave klasifikohen mallrat.

3. Nënkreu ose nënndarja e mëtejshme, e përcaktuar në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përdoret për qëllim të zbatimit të masave të lidhura me këtë nënkre.

Neni 58
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) masat për menaxhimin uniform të kuotave tarifore dhe të tavaneve tarifore, të përcaktuara në pikën 4, të nenit 56;

b) masat për menaxhimin e mbikëqyrjes së çlirimit për qarkullim të lirë ose eksportin e mallrave, të përcaktuara në pikën 5, të nenit 56;

c) masat e përmendura në pikën 3, të nenit 57.

KREU II
ORIGJINA E MALLRAVE

SEKSIONI 1
ORIGJINA JOPREFERENCIALE

Neni 59
Fusha e zbatimit

Nenet 60 dhe 61 vendosin rregullat për përcaktimin e origjinës jopreferenciale të mallrave për qëllime të zbatimit të:

a) Tarifës Doganore të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të masave të përmendura në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 2, të nenit 56;

b) masave të tjera nga masat tarifore, të vendosura nga dispozitat që rregullojnë fusha specifike në lidhje me tregtinë e mallrave;

c) masave të tjera që lidhen me origjinën e mallrave.

Neni 60
Përftimi i origjinës

1. Mallrat tërësisht të përftuara në një vend ose territor të vetëm konsiderohen të kenë origjinën e atij vendi ose territori.

2. Mallrat, prodhimi i të cilave përfshin më shumë se një vend ose territor, konsiderohen origjinuese në vendin ose territorin ku kanë pësuar ndryshimin ose përpunimin e tyre të fundit, thelbësor e të justifikuar ekonomikisht, në një ndërmarrje të pajisur për këtë qëllim e që rezulton në prodhimin e një produkti të ri ose që përfaqëson një fazë të rëndësishme të prodhimit.

Neni 61
Prova e origjinës

1. Në rastet kur legjislacioni doganor parashikon se në deklaratat doganore duhet të tregohet origjina e mallrave, autoritetet doganore mund t'i kërkojnë deklaruesit të provojë origjinën e tyre.

2. Në rastet kur legjislacioni doganor, ose kuadri ligjor që rregullon fusha të veçanta, parashikon lëshimin e një prove origjine për mallrat autoritetet doganore, në rast të dyshimeve të arsyeshme, mund të kërkojnë çdo provë shtesë të nevojshme, në mënyrë që të garantojnë se deklarimi i origjinës përputhet me rregullat e përcaktuara në legjislacionin përkatës.

3. Kur e kërkojnë nevojat e tregtisë, një dokument që vërteton origjinën mund të lëshohet në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me rregullat e origjinës në fuqi në vendin apo territorin e destinacionit ose me çdo metodë tjetër që identifikon vendin ku mallrat janë përftuar tërësisht origjinuese ose kanë pësuar transformimin e fundit thelbësor.

Neni 62
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rregullat, sipas të cilave mallrat, përcaktimi i origjinës jopreferenciale të të cilave kërkohet me qëllim zbatimin e masave të përcaktuara në nenin 59, konsiderohet se janë tërësisht të përftuara në një vend ose territor apo që kanë pësuar ndryshimin a përpunimin e tyre të fundit thelbësor e të justifikuar ekonomikisht në një ndërmarrje të pajisur për këtë qëllim e që rezulton në prodhimin e një produkti të ri ose që përfaqëson një fazë të rëndësishme të prodhimit, sipas përcaktimeve të nenit 60;

b) rregullat procedurale për lëshimin dhe verifikimin e provës së origjinës, sipas përcaktimeve të nenit 61.

SEKSIONI 2
ORIGJINA PREFERENCIALE

Neni 63
Origjina preferenciale e mallrave

1. Në mënyrë që të përfitohet nga masat e përmendura në shkronjat "ç" ose "d", të pikës 2, të nenit 56, ose nga masat preferenciale jotarifore, mallrat duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në rregullat për origjinën preferenciale, të parashikuara në pikat 2 deri në 3, të këtij neni.

2. Në rastin e mallrave që përfitojnë nga masat preferenciale, të përcaktuara në marrëveshjet në fuqi, të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve ose territoreve a grup-vendeve ose territoreve jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, rregullat për origjinën preferenciale përcaktohen në këto marrëveshje.

3. Në rastin e mallrave që përfitojnë nga masat preferenciale, të miratuara në mënyrë të njëanshme nga Republika e Shqipërisë, për sa u përket vendeve a territoreve apo grup - vendeve a territoreve, masat që përcaktojnë rregullat për origjinën preferenciale miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij Kodi.

Këto rregulla duhet të bazohen si në kriterin e mallrave tërësisht të përftuara, ashtu edhe në kriterin e përpunimeve të mjaftueshme.

Neni 64
Aktet nënligjore

1. Me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me pikën 1, të nenit 63, përcaktohen rregullat procedurale për përcaktimin e origjinës preferenciale të mallrave në Republikën e Shqipërisë.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave miraton manuale të detajuara, lidhur me procedurat e lëshimit të certifikatës EURO-1

KREU III
VLERA E MALLRAVE PËR QËLLIME DOGANORE

Neni 65
Fusha e zbatimit

Vlera doganore e mallrave, me qëllim zbatimin e Tarifës Doganore të Republikës së Shqipërisë dhe masave jotarifore, të parashikuara nga dispozita të tjera, që rregullojnë fusha specifike, lidhur me tregtinë e mallrave, përcaktohet në përputhje me nenet 66 deri 70.

Neni 66
Metoda e vlerësimit doganor bazuar në vlerën e transaksionit

1. Baza kryesore për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave është vlera e transaksionit, që është çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke marrë në konsideratë edhe rregullimet, kur është e nevojshme.

2. Çmimi realisht i paguar apo që duhet paguar është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi te shitësi ose nga blerësi te një palë e tretë në përfitim të shitësit për mallrat e importuara dhe përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë si kusht për shitjen e mallrave të importuara.

3. Vlera e transaksionit zbatohet nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) nuk ka asnjë kufizim për tjetërsimin/shkatërrimin ose përdorimin e mallrave nga blerësi, përveç kufizimeve:

i) të vëna ose të kërkuara me ligj, ose nga autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë;

ii) të zonës gjeografike, në të cilën mallrat mund të rishiten;

iii) të cilat nuk ndikojnë në mënyrë thelbësore në vlerën doganore të mallrave.

b) shitja ose çmimi nuk janë objekt i ndonjë kushti ose kërkese, për shkak të të cilave nuk mund të përcaktohet vlera doganore e mallrave që duhen vlerësuar;

c) asnjë pjesë e të ardhurave të çdo rishitjeje, tjetërsimi ose përdorimi të mëvonshëm të mallrave nga blerësi të mos i kthehet drejtpërdrejt ose tërthorazi shitësit, përveç rastit kur mund të bëhet një rregullim i duhur;

ç) blerësi dhe shitësi nuk janë të lidhur ose kur lidhja nuk ndikon në çmim.

Neni 67
Elementet e vlerës së transaksionit

1. Në përcaktimin e vlerës së transaksionit sipas nenit 66, çmimit realisht të paguar ose për t'u paguar për mallrat e importuara i duhen shtuar:

a) elementet e mëposhtme, në masën që ato kanë qenë në ngarkim të blerësit, por nuk janë përfshirë në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar për mallrat, si:

i) komisionet dhe ndërmjetësitë, me përjashtim të komisioneve të blerjes;

ii) kostoja e mbajtësve të mallrave të cilët, për qëllime doganore, trajtohen si një tërësi e vetme me mallrat në fjalë;

iii) kostoja e ambalazhimit, përfshirë këtu punën dhe materialet;

b) vlera e përpjesëtuar në mënyrën e duhur e mallrave dhe e shërbimeve të mëposhtme, kur këto mallra furnizohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga blerësi pa pagesë ose me pagesë të reduktuar, për t'u përdorur për prodhimin dhe shitjen për eksport të mallrave të importuara, në atë masë që kjo vlerë nuk është përfshirë në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar, për:

i) materiale, pjesë përbërëse, pjesë dhe artikuj të ngjashëm të trupëzuar në mallrat e importuara;

ii) vegla, matrica, kallëpe e artikuj të ngjashëm, të përdorur për prodhimin e mallrave të importuara;

iii) materiale të harxhuara gjatë prodhimit të mallrave të importuara;

iv) punë inxhinierike dhe zhvilluese, punimet artistike, punë projektuese dhe vizatimet e skicat, të kryera jashtë Republikës së Shqipërisë dhe të nevojshme për prodhimin e mallrave të importuara;

c) pagesa për përdorimin e së drejtës së pronësisë intelektuale (royalties) dhe pagesa për përdorimin e licencës (license fee), që lidhen me mallrat që po vlerësohen, për të cilat blerësi duhet të paguajë drejtpërdrejt ose tërthorazi, si kusht i shitjes së mallrave që po vlerësohen, në masën që këto pagesa nuk janë përfshirë në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar;

ç) vlera e çdo pjese të fitimit nga çdo rishitje, tjetërsim ose përdorim i mëvonshëm i mallrave të importuara që i shkon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi shitësit;

d) kostot e mëposhtme, deri në vendin e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si:

i) kostot e transportit e të sigurimit për mallrat e importuara;

ii) shpenzimet e ngarkimit e të trajtimit që lidhen me transportin e mallrave të importuara.

2. Shtesat në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar, sipas këtij neni, bëhen vetëm në bazë të të dhënave objektive e të llogaritshme.

3. Në përcaktimin e vlerës doganore nuk mund t'i bëhet asnjë shtesë çmimit realisht të paguar ose që duhet të paguhet, përveç rasteve të përmendura në këtë nen.

Neni 68
Elementet që nuk përfshihen në vlerën doganore

Në përcaktimin e vlerës doganore, sipas nenit 66, nuk përfshihen asnjë prej elementeve të mëposhtme:

a) shpenzimet e transportit të mallrave të importuara pas hyrjes së tyre në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) shpenzimet për ndërtimin, ngritjen, montimin, mirëmbajtjen ose asistencën teknike, të ndërmarra pas hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave të importuara, si për shembull, komplekse industriale, makineri ose pajisje;

c) pagesa interesash, që rrjedhin nga një marrëveshje financiare e lidhur nga blerësi dhe që lidhet me porositjen e mallrave të importuara, pavarësisht nëse financimi mund të jetë bërë nga vetë shitësi ose nga një person tjetër, por me kusht që marrëveshja financiare të jetë lidhur me shkrim dhe, kur kërkohet, blerësi të jetë në gjendje të vërtetojë se kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

i) këto mallra janë shitur realisht me çmimin e deklaruar si çmim faktikisht i paguar ose që duhet paguar;

ii) norma e interesit të pretenduar nuk e kalon nivelin e normës për transaksione të tilla që mbizotëron në vendin ku dhe në çastin kur është siguruar financimi;

ç) shpenzimet për të drejtën e riprodhimit në Republikën e Shqipërisë të mallrave të importuara;

d) komisionet e blerjes;

dh) detyrime importi dhe pagesa të tjera që duhen paguar në Republikën e Shqipërisë për arsye të importimit ose të shitjes së mallrave;

e) pavarësisht nga përcaktimi i shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 67, pagesat e bëra nga blerësi për të drejtën e distribuimit (shpërndarjes) ose rishitjes së mallrave të importuara, nëse pagesa të tilla nuk janë kusht për shitjen për eksport të mallrave në Republikën e Shqipërisë.

Neni 69
Thjeshtësime

Mbi baza aplikimi, autoritetet doganore mund të autorizojnë që shumat e mëposhtme të përcaktohen në bazë të kritereve të veçanta në rastet kur ato nuk janë të matshme në datën e pranimit të deklaratës doganore:

a) shuma që i shtohen vlerës sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 66;

b) shuma sipas përcaktimeve të neneve 67 dhe 68.

Neni 70
Metoda dytësore për vlerësimin doganor

1. Kur vlera doganore e mallrave nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 66, ajo përcaktohet duke ndjekur, sipas radhës, procedurën e përmendur nga shkronja "a" deri në "ç", të pikës 2, të këtij neni, duke u ndalur në të parën shkronjë, sipas së cilës mund të përcaktohet vlera doganore e mallrave.

Radha e zbatimit të shkronjave "c" dhe "ç" këmbehet nëse këtë e kërkon deklaruesi.

2. Vlera doganore, sipas pikës 1, është:

a) vlera e transaksionit e mallrave identike, të shitura për eksport për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në kohën ose afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;

b) vlera e transaksionit e mallrave të ngjashme, të shitura për eksport për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në kohën ose afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;

c) vlera e bazuar në çmimin për njësi, me të cilën mallrat e importuara ose mallrat identike apo të ngjashme, që u korrespondojnë mallrave të importuara, u janë shitur brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në sasinë më të madhe të përgjithshme, personave, të cilët nuk kanë lidhje me shitësit;

ç) vlera e përllogaritur e cila konsiston në shumën e:

i) kostos ose vlerës së materialeve dhe prodhimit ose të përpunimeve të tjera, të përfshira në prodhimin e mallrave të importuara;

ii) një shume, që përfaqëson fitimet dhe shpenzimet e përgjithshme, të barabartë me atë që sjellin zakonisht shitjet e mallrave të së njëjtës cilësi ose të të njëjtit lloj me mallrat për t'u vlerësuar, të prodhuara nga prodhues të vendit eksportues e me destinacion Republikën e Shqipërisë;

iii) kostos ose vlerës të elementeve të përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 67.

3. Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas pikës 1, të këtij neni, ajo përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke përdorur mjete të arsyeshme, në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme të:

a) marrëveshjes për zbatimin e nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT);

b) nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë;

c) këtij kreu.

Neni 71
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kushtet për dhënien e autorizimit, në përputhje me parashikimin e nenit 69;

b) rregullat për përcaktimin e vlerës doganore, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 66, dhe nenet 67 e 68, përfshirë rregullat për rregullimin e çmimit të paguar apo për t'u paguar;

c) rregullat për zbatimin e kushteve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 66;

ç) rregullat për përcaktimin e vlerës doganore, sipas përcaktimeve të nenit 70.

TITULLI III
BORXHI DOGANOR DHE GARANCITË

KREU I
LINDJA E NJË BORXHI DOGANOR

SEKSIONI 1
BORXHI DOGANOR NË IMPORT

Neni 72
Çlirimi për qarkullim të lirë dhe lejimi i përkohshëm

1. Një borxh doganor në import lind gjatë vendosjes së mallrave joshqiptare që u nënshtrohen detyrimeve të importit nën një prej regjimeve doganore të mëposhtme:

a) çlirimit për qarkullim të lirë, përfshirë regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use);

b) lejimit të përkohshëm, me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit.

2. Borxhi doganor lind në datën e pranimit të deklaratës doganore.

3. Debitor është deklaruesi. Në rastin e përfaqësimit të tërthortë, debitor është gjithashtu personi, për llogari të të cilit bëhet deklarimi doganor.

Kur deklarata doganore, lidhur me një nga regjimet e përmendura në pikën 1, hartohet në bazë të një informacioni, i cili shkakton mosvjeljen e një pjese ose të të gjithë shumës së detyrimeve të importit, personat, që e kanë dhënë informacionin e nevojshëm për hartimin e deklaratës dhe ata, ndaj të cilëve provohet se ishin në dijeni ose objektivisht duhej të ishin në dijeni se ky informacion ishte i rremë, janë gjithashtu debitorë.

Neni 73
Dispozita të veçanta në lidhje me mallrat joorigjinuese

1. Kur zbatohet ndalimi i rimbursimit ose përjashtimi nga detyrimet e importit për mallrat joorigjinuese, që janë përdorur në prodhimin e produkteve, për të cilat është lëshuar një provë origjine në kuadër të një marrëveshjeje preferenciale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe disa vendeve, territoreve ose grup-vendeve ose territoreve të vendosura jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, një borxh doganor importi lind në momentin e pranimit të deklaratës doganore të rieksportit për këto mallra.

2. Kur lind një borxh doganor, sipas pikës 1, shuma e detyrimit të importit, që i korrespondon këtij borxhi, përcaktohet nën të njëjtat kushte si në rastin e një borxhi doganor që rrjedh nga pranimi në të njëjtën datë i deklaratës doganore për çlirimin për qarkullim të lirë të mallrave joorigjinuese, të përdorura në prodhimin e produkteve në fjalë, me qëllim mbylljen e regjimit të përpunimit aktiv.

3. Si rregull, debitor është personi i përcaktuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 72. Megjithatë, në rastin e mallrave joshqiptare të përcaktuara në nenin 242, debitor është personi, i cili depoziton deklaratën e rieksportit. Në rastin e përfaqësimit të tërthortë, debitor është gjithashtu edhe personi për llogari të të cilit bëhet deklarimi.

Neni 74
Borxhi doganor i lindur nëpërmjet mospërmbushjes

1. Për mallrat që u nënshtrohen detyrimeve të importit, një borxh doganor në import lind nëpërmjet mospërmbushjes së:

a) një prej detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor, në lidhje me futjen e mallrave joshqiptare në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, shmangien e tyre nga mbikëqyrja doganore ose në lidhje me lëvizjen, përpunimin, magazinimin, magazinimin e përkohshëm, lejimin e përkohshëm ose shkatërrimin e mallrave të tilla brenda këtij territori;

b) një prej detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor, që ka të bëjë me përdorimin e veçantë përfundimtar (end–use) të mallrave brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) një kushti që rregullon vendosjen e mallrave joshqiptare nën një regjim doganor ose dhënien, për shkak të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) të mallrave, e përjashtimit ose të një reduktimi të detyrimit të importit.

2. Momenti, në të cilin lind borxhi doganor është:

a) momenti kur nuk plotësohet ose pushon së plotësuari detyrimi, mospërmbushja e të cilit sjell lindjen e borxhit doganor; ose

b) momenti kur pranohet një deklaratë doganore me qëllim vendosjen e mallrave nën një regjim doganor e kur, për të cilën më vonë, (aposteriori), konstatohet që nuk është përmbushur kushti që rregullon vendosjen e mallrave nën atë regjim ose dhënien e një përjashtimi nga detyrimi ose reduktimin e një detyrimi importi për shkak të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use).

3. Në rastet e përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, debitor është:

a) çdo person të cilit i ishte kërkuar plotësimi i detyrimeve në fjalë;

b) çdo person, ndaj të cilit provohet se kishte dijeni ose objektivisht duhet të kishte dijeni që nuk ishte përmbushur një detyrim sipas legjislacionit doganor dhe që veproi në emër të personit, i cili ishte i detyruar të përmbushte detyrimet apo mori pjesë në veprimin që solli mospërmbushjen e detyrimit;

c) çdo person i cili blen ose mban mallrat në fjalë, ndaj të cilit provohet se kishte dijeni ose objektivisht duhej të kishte dijeni në momentin e blerjes ose marrjes së mallrave që detyrimi, sipas legjislacionit doganor, nuk ishte përmbushur.

4. Në rastin e përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 1, debitor është personi, të cilit i kërkohet të përmbushë kushtet që rregullojnë vendosjen e mallrave nën një regjim doganor ose deklarimin doganor të mallrave nën atë regjim apo kushtet që rregullojnë dhënien e një përjashtimi a të një reduktimi nga detyrimet e importit për shkak të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) të mallrave.

Kur një deklaratë doganore, e hartuar për një prej regjimeve doganore, sipas përcaktimit të shkronjës "c", të pikës 1, dhe çdo informacion i kërkuar sipas legjislacionit doganor, në lidhje me kushtet që vendosin mallrat nën atë regjim doganor, që u është dhënë autoriteteve doganore, çojnë në mosmbledhjen e të gjithave ose të një pjesë të detyrimeve të importit, personi, i cili jep këtë informacion për hartimin e deklaratës dhe ndaj të cilit provohet se kishte dijeni ose objektivisht duhej të kishte dijeni që një informacion i tillë ishte i rremë, gjithashtu është debitor.

Neni 75
Zbritja e një shume nga detyrimet e importit të paguara

1. Kur lind një borxh doganor, sipas pikës 1, të nenit 74, që i përket mallrave të çliruara për qarkullim të lirë me reduktim të detyrimit të importit, për shkak të përdorimit të veçantë përfundimtar (end use) të tyre, shuma e detyrimit të importit, e paguar në çastin kur mallrat ishin çliruar për qarkullim të lirë duhet të zbritet nga shuma e detyrimit të importit që i korrespondon borxhit doganor.

Paragrafi i mësipërm zbatohet kur një borxh doganor lind për mbetjet dhe hedhurinat, që dalin nga shkatërrimi i këtyre mallrave.

2. Kur lind një borxh doganor, sipas pikës 1, të nenit 74, për mallra të vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm, me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit, shuma e paguar e detyrimit të importit për përjashtimin e pjesshëm i zbritet shumës së detyrimit të importit që i korrespondon borxhit doganor.

SEKSIONI 2
BORXHI DOGANOR NË EKSPORT

Neni 76
Eksporti dhe përpunimi pasiv

1. Një borxh doganor në eksport lind nëpërmjet vendosjes së mallrave, që u nënshtrohen detyrimeve të eksportit, nën regjimin e eksportit ose nën regjimin e përpunimit pasiv.

2. Borxhi doganor lind në momentin e pranimit të deklaratës doganore.

3. Debitor është deklaruesi. Në rast të përfaqësimit të tërthortë, debitor është gjithashtu personi, për llogari të të cilit është bërë deklarimi doganor.

Kur një deklaratë doganore është hartuar duke u mbështetur në informacion, i cili sjell mosmbledhjen e të gjitha ose të një pjese të detyrimeve të eksportit, personi, i cili ka dhënë këtë informacion për hartimin e deklaratës dhe kishte dijeni apo objektivisht duhej të kishte dijeni që një informacion i tillë ishte jo i saktë, gjithashtu është debitor.

Neni 77
Borxhi doganor i lindur nëpërmjet mospërmbushjes

1. Për mallra që u nënshtrohen detyrimeve të eksportit, një borxh doganor lind nëpërmjet mospërmbushjes së:

a) një prej detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor për daljen e mallrave;

b) kushteve, në të cilat mallrat janë lejuar të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e eksportit.

2. Momenti i lindjes së borxhit doganor është:

a) momenti kur mallrat dalin efektivisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pa një deklarim doganor;

b) momenti kur mallrat mbërrijnë në një destinacion të ndryshëm nga ai për të cilin ato janë lejuar të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e eksportit;

c) nëse autoritetet doganore nuk janë në gjendje të përcaktojnë momentin e përmendur në shkronjën "b", përfundimi i afatit kohor të vendosur për dhënien e provës që vërteton se janë përmbushur kushtet për përfitimin e këtij përjashtimi.

3. Në rastet e parashikuara në shkronjën "a", të pikës 1, debitor është:

a) çdo person, të cilit i ishte kërkuar plotësimi i detyrimeve në fjalë;

b) çdo person, i cili kishte dijeni ose objektivisht duhej të kishte dijeni që detyrimi në fjalë nuk ishte përmbushur dhe që veproi në emër të personit, i cili ishte i detyruar të përmbushte detyrimin;

c) çdo person, i cili mori pjesë në veprimin që çoi në mospërmbushjen e detyrimit dhe që kishte dijeni ose objektivisht duhej të kishte dijeni që deklarata doganore nuk është depozituar, por duhej të ishte depozituar.

4. Në rastet e përmendura në shkronjën "b", të pikës 1, debitor është çdo person, të cilit i kërkohet të plotësojë kushtet, në të cilat mallrat u lejuan të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e eksportit.

SEKSIONI 3
DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR BORXHIN DOGANOR TË LINDUR NË IMPORT DHE EKSPORT

Neni 78
Ndalimet dhe kufizimet

1. Borxhi doganor në import ose eksport lind edhe kur ka lidhje me mallra që janë objekt i masave ndaluese ose kufizuese të çdo lloji në import ose eksport.

2. Megjithatë, asnjë borxh doganor nuk lind me:

a) futjen e paligjshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të monedhave false;

b) futjen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të drogave dhe substancave psikotrope, ndryshe nga ato që mbikëqyren rreptësisht nga autoritetet kompetente, me qëllim përdorimin mjekësor ose shkencor të tyre.

3. Për qëllimet e sanksioneve që zbatohen për shkeljet doganore, borxhi doganor konsiderohet gjithashtu sikur ka lindur kur, sipas legjislacionit shqiptar, detyrimet doganore të importit ose eksportit ose ekzistenca e borxhit doganor shërben si bazë për përcaktimin e sanksioneve.

Neni 79
Debitorët solidarë

Kur disa persona janë përgjegjës për pagesën e shumës së detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon një borxhi doganor, ata janë përgjegjës së bashku dhe veçmas për pagesën e shumës së plotë të borxhit.

Neni 80
Rregulla të përgjithshme për përllogaritjen e shumës së detyrimit të importit apo eksportit

1. Shuma e detyrimeve të importit ose eksportit përcaktohet në bazë të atyre rregullave për përllogaritjen e detyrimeve, që ishin të zbatueshme dhe u takojnë mallrave në fjalë në momentin e lindjes së borxhit doganor në lidhje me to.

2. Kur nuk është e mundur të përcaktohet me saktësi momenti kur lind borxhi doganor, ky moment konsiderohet të jetë momenti, në të cilin autoritetet doganore arrijnë në përfundimin se këto mallra ndodhen në një situatë në të cilën ka lindur një borxh doganor.

Megjithatë, kur informacioni në dispozicion të autoriteteve doganore u mundëson atyre të përcaktojnë që borxhi doganor ka lindur përpara se ata të arrinin në këtë përfundim, borxhi doganor konsiderohet si i lindur në momentin më të hershëm të përcaktimit të një situate të tillë.

Neni 81
Rregulla të veçanta për përllogaritjen e shumës së detyrimit të importit

1. Kur brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë janë krijuar kosto magazinimi ose trajtimi të zakonshme për mallra të vendosura nën një regjim doganor ose në një magazinim të përkohshëm, kosto të tilla ose rritja e vlerës nuk merren në konsideratë për përllogaritjen e shumës së detyrimit të importit, me kusht që deklaruesi të paraqesë provat e mjaftueshme lidhur me to.

Megjithatë, vlera doganore, sasia, lloji dhe origjina e mallrave joshqiptare, të përdorura në operacione merret në konsideratë për përllogaritjen e shumës së detyrimit të importit.

2. Kur klasifikimi tarifor i mallrave të vendosura nën një regjim doganor ndryshon, si rezultat i trajtimeve të zakonshme, të kryera brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të deklaruesit zbatohet klasifikimi tarifor fillestar i mallrave të vendosura nën regjim.

3. Kur lind një borxh doganor për produkte të përpunuara, që rezultojnë nga regjimi i përpunimit aktiv, me kërkesë të deklaruesit, shuma e detyrimit të importit që i korrespondon këtij borxhi përcaktohet duke u mbështetur në klasifikimin tarifor, vlerën doganore, sasinë, llojin dhe origjinën e mallrave, të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv, në momentin e pranimit të deklaratës doganore për këto mallra.

4. Në raste të veçanta, shuma e detyrimit të importit përcaktohet në përputhje me pikat 2 dhe 3, të këtij neni, pa kërkesë nga ana e deklaruesit, me qëllim që të evitohet shmangia nga masat tarifore të përmendura në shkronjën "ë", të pikës 2, të nenit 56.

5. Kur lind një borxh doganor për produktet e përpunuara që rezultojnë nga regjimi i përpunimit pasiv ose për produkte zëvendësuese, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 234, shuma e detyrimit të importit llogaritet në bazë të kostos së operacioneve të përpunimit, të kryera jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

6. Kur legjislacioni doganor parashikon një trajtim tarifor favorizues ose një përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit ose eksportit, sipas shkronjës "ç" deri "e", të pikës 2, të nenit 56, të neneve 184, 185, 186, 187 dhe 189 ose 232 deri 235, ky trajtim tarifor favorizues ose ky përjashtim gjithashtu zbatohet në rastet kur borxhi doganor lind sipas neneve 74 ose 77, me kusht që faktet dhe rrethanat, që çuan në krijimin e borxhit doganor, të mos përbëjnë përpjekje për mashtrim.

Neni 82
Vendi ku lind borxhi doganor

1. Një borxh doganor lind në vendin ku depozitohet deklarata doganore ose deklarata doganore e rieksportit, sipas përcaktimeve të neneve 72, 73 dhe 76.

Në të gjitha rastet e tjera, vendi ku lind borxhi doganor është vendi ku ndodhin ngjarjet/faktet që e krijojnë atë.

Kur nuk është e mundur të përcaktohet ky vend, borxhi doganor lind në vendin ku autoritetet doganore arrijnë në përfundimin se mallrat janë në një situatë, në të cilën ka lindur një borxh doganor.

2. Nëse mallrat janë vendosur në një regjim doganor që nuk është mbyllur dhe kur një magazinim i përkohshëm nuk ka mbaruar siç duhet dhe vendi ku ka lindur borxhi doganor nuk mund të përcaktohet sipas nënparagrafëve të dytë dhe të tretë, të pikës 1, brenda një afati të përcaktuar, borxhi doganor lind në vendin ku mallrat ose ishin vendosur nën regjimin në fjalë, ose ishin futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nën këtë regjim, ose ishin në magazinim të përkohshëm.

3. Kur informacioni që disponojnë autoritetet doganore u mundëson atyre të përcaktojnë që borxhi doganor mund të ketë lindur në disa vende, borxhi doganor konsiderohet si i lindur në vendin ku ka lindur për herë të parë.

Neni 83
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rregullat për llogaritjen e shumës së detyrimit të importit ose eksportit, të aplikueshme për mallrat, për të cilat ka lindur një borxh doganor, në kuadër të një regjimi të veçantë në plotësim të rregullave të përcaktuara në nenet 80 dhe 81;

b) rastet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 81;

c) afatet kohore, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 82.

KREU II
GARANCIA PËR NJË BORXH DOGANOR TË MUNDSHËM OSE EKZISTUES

Neni 84
Dispozita të përgjithshme

1. Ky kre, përveçse kur parashikohet ndryshe, zbatohet si për garancitë për borxhe doganore që kanë lindur, ashtu edhe për ato, të cilat mund të lindin.

2. Kur autoritetet doganore kërkojnë depozitimin e një garancie, për të garantuar një borxh doganor ekzistues ose të mundshëm, kjo garanci duhet të mbulojë shumën e detyrimit të importit ose eksportit dhe detyrimeve të tjera që kanë lidhje me importin, eksportin ose transitin.

3. Kur autoritetet doganore kërkojnë depozitimin e një garancie, ajo i kërkohet debitorit ose personit, i cili mund të bëhet debitor. Ato gjithashtu mund të lejojnë depozitimin e garancisë nga një person tjetër, i ndryshëm nga ai, të cilit i është kërkuar garancia.

4. Pa cenuar nenin 92, autoritetet doganore kërkojnë depozitimin e një garancie të vetme për mallra të caktuara ose për një deklaratë të caktuar.

Garancia e depozituar për një deklaratë të caktuar zbatohet për shumën e detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon borxhit doganor dhe pagesave të tjera, në lidhje me të gjitha mallrat e mbuluara ose të çliruara nga ajo deklaratë, pavarësisht nëse kjo deklaratë është e saktë ose jo.

Në qoftë se garancia nuk është çliruar, ajo mund të përdoret gjithashtu, brenda kufijve të shumës së siguruar për vjeljen e shumave të detyrimit të importit ose eksportit dhe pagesave të tjera që duhen paguar, si rrjedhojë e kontrolleve pas çlirimit (a posteriori) për këto mallra.

5. Me kërkesë të personit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, autoritetet doganore, në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 90, mund të autorizojnë depozitimin e një garancie globale, për të mbuluar shumën e detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon borxhit doganor, në lidhje me dy ose më shumë operacione, deklarata ose regjime doganore.

6. Autoritetet doganore mbikëqyrin garancinë.

7. Depozitimi i një garancie nuk kërkohet për autoritetet shtetërore, autoritetet e qeverisjes vendore ose organet e tjera publike, kur ato veprojnë si autoritete publike.

8. Nuk kërkohet depozitim garancie në rastet e mëposhtme:

a) gjatë transportit të mallrave me instalime fikse;

b) në raste të veçanta të vendosjes së mallrave në regjimin e lejimit të përkohshëm.

9. Autoritetet doganore mund të heqin dorë nga kërkesa për depozitimin e një garancie kur shuma e detyrimit të importit ose eksportit për t'u siguruar nuk kalon kufirin e dërgesave me vlerë të papërfillshme të përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 3, të nenit 184.

Neni 85
Garancia e detyrueshme

1. Kur depozitimi i një garancie është i detyrueshëm, autoritetet doganore caktojnë shumën e kësaj garancie në masë të njëjtë me shumën e saktë të detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon borxhit doganor dhe pagesave të tjera, kur kjo shumë mund të përcaktohet me saktësi në momentin kur kërkohet garancia.

Kur nuk është e mundur të përcaktohet shuma e saktë, sipas vlerësimit të autoriteteve doganore, garancia caktohet në shumën maksimale të detyrimit të importit

ose eksportit që i korrespondon borxhit doganor dhe pagesave të tjera, të cilat kanë lindur ose mund të lindin.

2. Pa cenuar nenin 90, kur depozitohet një garanci globale për shumën e detyrimit të importit ose eksportit, që i korrespondon borxhit doganor dhe pagesave të tjera, të cilat ndryshojnë në vlerë me kalimin e kohës, shuma e kësaj garancie caktohet në një masë që lejon mbulimin e shumës së detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon borxhit doganor dhe pagesave të tjera gjatë gjithë kohës.

Neni 86
Garancia fakultative

Kur depozitimi i një garancie është fakultativ, kjo garanci sidoqoftë kërkohet nga autoritetet doganore nëse ato konsiderojnë se nuk është e sigurt që shuma e detyrimit të importit ose eksportit, që i korrespondon borxhit doganor dhe pagesave të tjera, do të paguhet brenda periudhës kohore të parashikuar. Kjo shumë caktohet nga këto autoritete në mënyrë të tillë që të mos kalojë masën e përmendur në nenin 85.

Neni 87
Depozitimi i një garancie

1. Një garanci mund të ketë një nga format e mëposhtme:

a) depozitë në të holla (cash) në një institucion bankar ose mënyra të tjera pagesash të njohura nga autoritetet doganore si të barasvlefshme me një depozitë në të holla, në monedhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë;

b) dorëzani e dhënë nga një dorëzanës;

c) forma të tjera garancie, të njohura nga ligji, të cilat japin siguri të barasvlefshme që shuma e detyrimit të importit ose eksportit, që i korrespondon borxhit doganor dhe pagesave të tjera, do të paguhet.

2. Kur depozitohet një garanci në të holla, nga ana e autoriteteve doganore nuk paguhet asnjë interes.

Neni 88
Zgjedhja e garancisë

Personi, të cilit i kërkohet të depozitojë një garanci, mund të zgjedhë ndërmjet formave të garancive, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 87.

Autoritetet doganore mund të refuzojnë formën e garancisë së zgjedhur kur është në papajtueshmëri me kriteret e përcaktuara për funksionimin e duhur të regjimit doganor përkatës.

Autoritetet doganore mund të kërkojnë që forma e garancisë së zgjedhur të ruhet për një afat të caktuar.

Neni 89
Dorëzanësi

1. Dorëzanësi i përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 87, është një person i tretë i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Dorëzanësi miratohet nga autoritetet doganore që kërkojnë garancinë, përveçse kur dorëzanës është një institucion kreditimi, institucion financiar ose kompani sigurimesh e akredituar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2. Dorëzanësi merr përsipër me shkrim të paguajë shumën e siguruar të detyrimit të importit ose eksportit, që i korrespondon borxhit doganor dhe pagesave të tjera.

3. Autoritetet doganore mund të refuzojnë miratimin e dorëzanësit ose formën e garancisë të propozuar kur nuk shfaqet qartazi sigurimi i pagesës së shumës së detyrimit të importit ose eksportit, që i korrespondon borxhit doganor dhe pagesave të tjera, brenda afatit të parashikuar.

Neni 90
Garancia globale

1. Autorizimi i përmendur në pikën 5, të nenit 84, u jepet vetëm personave, të cilët plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) janë të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) plotësojnë kushtet e përcaktuara në shkronjën “a”, të nenit 41;

c) janë përdorues të rregullt të regjimeve doganore ku ata përfshihen ose operatorë të ambienteve të magazinimit të përkohshëm ose që plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjën “ç”, të nenit 41.

2. Kur duhet të depozitohet një garanci globale për borxhet doganore dhe pagesat e tjera që mund të lindin, një operator ekonomik mund të autorizohet për të përdorur një garanci globale me një shumë të reduktuar ose për të përfituar një përjashtim nga depozitimi i garancisë, me kusht që të plotësojë kriteret e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të nenit 41.

3. Kur duhet të depozitohet një garanci globale për borxhet doganore dhe pagesat e tjera që mund të lindin, një operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësi doganore mund të autorizohet që të përdorë një garanci globale me një shumë të reduktuar.

4. Garancia globale me shumë të reduktuar, e përcaktuar në pikën 3, është e barasvlefshme me depozitimin e një garancie.

Neni 91
Ndalime të përkohshme në lidhje me përdorimin e garancive globale

1. Për nevoja të zbatimit të regjimeve të posaçme ose të magazinimit të përkohshëm, Këshilli i Ministrave mund të ndalojë përkohësisht depozitimin/dhënien:

a) e garancisë globale me një shumë të reduktuar ose përjashtimit nga garancia, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 90;

b) e garancisë globale, të parashikuar në nenin 90, për mallrat, të cilat janë identifikuar si objekt i mashtrimeve në shkallë të gjerë.

2. Kur zbatohen shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij neni, mund të autorizohet përdorimi i garancisë globale me një shumë të reduktuar të garancisë ose të përjashtimit nga garancia ose përdorimi i garancisë globale, të përcaktuar në nenin 90, kur personi i interesuar plotëson njërin prej kushtet e mëposhtme:

a) personi provon se nuk ka lindur ndonjë borxh doganor për mallrat në fjalë për veprimet që personi ka kryer gjatë dy vjetëve që i paraprijnë vendimit të përmendur në pikën 1;

b) personi provon se të gjitha borxhet e lindura gjatë periudhës dyvjeçare, para vendimit të përmendur në pikën 1, janë paguar plotësisht nga debitori, debitorët ose garantuesi brenda afateve kohore të parashikuara.

Për të përfituar autorizimin e përdorimit të një garancie globale të ndaluar përkohësisht, personi i interesuar duhet gjithashtu të plotësojë kushtet e përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c", të nenit 41.

Neni 92
Garancia plotësuese ose zëvendësuese

Kur autoritetet doganore konstatojnë që garancia e depozituar nuk garanton ose nuk është më e sigurt apo e mjaftueshme të garantojë pagesën e shumës së detyrimit të importit ose të eksportit, që i korrespondon borxhit doganor dhe pagesave të tjera, brenda afatit të parashikuar, ato i kërkojnë çdo personi, të përcaktuar në pikën 3, të nenit 84, të depozitojë një garanci plotësuese ose të zëvendësojë garancinë fillestare të depozituar me një garanci të re, sipas zgjedhjes së tij.

Neni 93
Çlirimi i garancisë

1. Autoritetet doganore çlirojnë menjëherë garancinë sapo borxhi doganor ose detyrimi për pagesat e tjera shuhet ose nuk mund të lindë më.

2. Kur borxhi doganor ose detyrimi për pagesat e tjera shuhet pjesërisht ose mund të lindë vetëm për sa i përket një pjese të shumës, e cila është siguruar, pjesa korresponduese e garancisë çlirohet sipas kërkesës së personit në fjalë, përveçse kur shuma e përfshirë nuk e justifikon një veprim të tillë.

Neni 94
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet e veçanta, të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 8, të nenit 84, kur nuk kërkohet garanci për mallrat e vendosura në regjimin e lejimit të përkohshëm;

b) forma e garancisë, sipas përcaktimeve të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 87, dhe rregullat për dorëzanësin, të përcaktuara në nenin 89;

c) kushtet për dhënien e një autorizimi për përdorimin e garancisë globale me një reduktim të detyrimit ose përjashtim nga garancia, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 90;

ç) afatet kohore për çlirimin e një garancie;

d) rregullat procedurale për përcaktimin e masës së garancisë, përfshirë dhe garancitë me reduktim të shumës, sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3, të nenit 90;

dh) rregullat procedurale për depozitimin dhe mbikëqyrjen e garancisë, sipas përcaktimeve të nenit 84, për revokimin dhe anulimin e dorëzanisë dhënë nga një garantues, sipas përcaktimeve të nenit 89, dhe për çlirimin e garancisë, sipas përcaktimeve të nenit 93;

e) rregullat procedurale që lidhen me ndalimet e përkohshme, sipas përcaktimeve të nenit 91;

ë) rregullat për masat e përcaktuara në nenin 91.

KREU III
VJELJA, PAGESA, RIMBURSIMI DHE FALJA E SHUMËS SË DETYRIMIT TË IMPORTIT OSE EKSPORTIT

SEKSIONI 1
PËRCAKTIMI I SHUMËS SË DETYRIMIT TË IMPORTIT OSE EKSPORTIT, NJOFTIMI I BORXHIT DOGANOR DHE KONTABILIZIMI

Neni 95
Përcaktimi i shumës së detyrimit të importit ose eksportit

1. Shuma e detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar përcaktohet nga autoritetet doganore kompetente të vendit ku ka lindur ose vlerësohet se ka lindur borxhi doganor, sipas përcaktimeve të nenit 82, sapo ato të kenë informacionin e nevojshëm.

2. Pa cenuar nenin 49, autoritetet doganore mund të pranojnë shumën e detyrimit doganor të importit ose eksportit për t'u paguar, të përcaktuar nga deklaruesi.

3. Kur shuma e detyrimit të importit ose eksportit është një numër jo i plotë, ajo mund të rrumbullakoset në numrin më të afërt të plotë.

Neni 96
Njoftimi i borxhit doganor

1. Si rregull, borxhi doganor i njoftohet debitorit, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) kur, në pritje të një përcaktimi përfundimtar të shumës së detyrimit të importit ose eksportit, vendoset një masë e përkohshme e politikave tregtare që merr formën e një detyrimi;

b) kur shuma e detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar është më e madhe se ajo e përcaktuar në bazë të një vendimi të marrë në përputhje me nenin 36;

c) kur vendimi fillestar për të mos njoftuar borxhin doganor ose për ta njoftuar atë në një shumë më të vogël sesa shuma e detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar merret në bazë të dispozitave të karakterit të përgjithshëm, të shfuqizuara më vonë me vendim gjyqësor;

ç) në rastet kur autoritetet doganore, sipas legjislacionit doganor, përjashtohen nga detyrimi për të njoftuar borxhin doganor.

2. Kur shuma e detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar është e barabartë me shumën e paraqitur në deklaratën doganore, çlirimi i mallrave nga autoritetet doganore shërben edhe si njoftim i debitorit për borxhin doganor.

3. Kur nuk zbatohet pika 2, e këtij neni, borxhi doganor i njoftohet debitorit nga ana e autoriteteve doganore, kur ato janë në gjendje të përcaktojnë shumën e detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar dhe kanë marrë vendimin mbi të.

Megjithatë, kur njoftimi i borxhit doganor pengon një hetim penal, autoritetet doganore mund të shtyjnë njoftimin deri në kohën kur nuk pengohet ky hetim.

4. Me kusht që pagesa të garantohet, borxhi doganor, që i korrespondon shumës totale të detyrimit të importit ose eksportit për të gjitha mallrat e çliruara nga i njëjti person, gjatë një afati të përcaktuar nga autoritetet doganore, mund të njoftohet në fund të atij afati. Afati i përcaktuar nga autoritetet doganore nuk duhet të jetë më i madh se 31 ditë.

Neni 97
Parashkrimi i borxhit doganor

1. Asnjë borxh doganor nuk do t'i njoftohet debitorit pas përfundimit të një periudhe prej tre vjetësh nga data kur ka lindur ky borxh doganor.

2. Kur borxhi doganor ka lindur si rezultat i një veprimi, i cili, sipas vlerësimit të autoriteteve doganore, në kohën që është kryer, përbënte vepër penale, sipas legjislacionit të kohës dhe legjislacionit në fuqi, afati i përcaktuar në pikën 1 zgjatet për një periudhë nga 5 deri në 10 vjet. Në këtë rast autoritetet doganore vënë në lëvizje organin përgjegjës të procedimit penal.

3. Periudhat e parashikuara në pikën 1 dhe 2 pezullohen kur:

a) depozitohet një kërkesë ankimore në përputhje me nenin 45. Pezullimi zbatohet nga data, në të cilën është depozituar kërkesa ankimore dhe deri në përfundim të procedurave të ankimit; ose

b) autoritetet doganore i komunikojnë debitorit arsyet, mbi të cilat ato mbështesin vendimin e tyre për njoftimin e borxhit doganor, para marrjes së tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 27, pika 6. Pezullimi zbatohet nga data e komunikimit deri në fund të afatit, brenda të cilit debitorit i është dhënë mundësia të shprehë pikëpamjet e tij.

4. Kur një borxh doganor është rivendosur, në përputhje me pikën 7, të nenit 109, afatet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, konsiderohen si të pezulluara, duke filluar nga data në të cilën është paraqitur aplikimi për rimbursim ose falje, sipas nenit 114, deri në datën, në të cilën merret vendimi për rimbursim ose falje.

Neni 98
Kontabilizimi

1. Autoritetet doganore, të përmendura në nenin 95, në përputhje me legjislacionin në fuqi, bëjnë kontabilizimin e shumës së përcaktuar të detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar, në përputhje me këtë nen.

Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet në rastet e përmendura në shkronjat "a" deri në "ç", të pikës 1, të nenit 96.

2. Autoritetet doganore nuk kontabilizojnë shumat e detyrimit të importit ose eksportit, të cilat, sipas nenit 97, i përkasin një borxhi doganor, i cili nuk mund t'i njoftohet më debitorit.

3. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen procedurat praktike për kontabilizimin e shumës së detyrimit të importit ose eksportit. Këto procedura mund të jenë të ndryshme nëse autoritetet doganore, në varësi të rrethanave, në të cilat është krijuar borxhi doganor, binden që këto shuma do të paguhen.

Neni 99
Koha e kontabilizimit

1. Kur një borxh doganor lind si pasojë e pranimit të një deklarate doganore për vendosjen e mallrave nën një regjim doganor, të ndryshëm nga lejimi i përkohshëm, me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit ose nga çdo akt tjetër që ka efekt të njëjtë juridik me këtë lejim, autoritetet doganore kontabilizojnë shumën e duhur të detyrimit të importit ose eksportit brenda 14 ditëve nga data e çlirimit të mallrave.

Shuma e plotë e detyrimit të importit ose eksportit, që ka të bëjë me të gjitha mallrat e çliruara nga i njëjti

person gjatë një periudhe të caktuar nga autoritetet doganore, e cila nuk duhet t'i kalojë 31 ditë, mund të mbulohet nga një kontabilizim i vetëm në fund të këtij afati, me kusht që pagesa të jetë garantuar

2. Kur çlirimi i mallrave i nënshtrohet kushteve të caktuara, të cilat rregullojnë përcaktimin e shumës së detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar ose mbledhjen (vjeljen) e saj, kontabilizimi kryhet brenda 14 ditëve nga dita në të cilën është përcaktuar shuma e detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar ose nga dita kur është përcaktuar detyrimi për të vjelë këtë shumë.

Megjithatë, kur borxhi doganor ka të bëjë me një masë të përkohshme të politikës tregtare, që merr formën e një detyrimi, shuma e detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar kontabilizohet brenda 2 muajve nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare të aktit që përcakton si të përhershme masën e politikës tregtare.

3. Kur një borxh doganor krijohet në rrethana që nuk parashikohen në pikën 1, shuma e detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar kontabilizohet brenda 14 ditëve nga data, në të cilën autoritetet doganore janë në gjendje të përcaktojnë shumën e detyrimit të importit ose eksportit në fjalë dhe të marrin një vendim.

4. Pika 3 zbatohet për shumat e detyrimit të importit ose eksportit që do të vilen ose mbeten për t'u vjelë, kur shuma e detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar nuk është kontabilizuar, në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3, ose është përcaktuar dhe kontabilizuar në një shumë më të vogël se shuma për t'u paguar.

5. Afatet kohore për kontabilizim, të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, nuk zbatohen në rastet e rrethanave të paparashikuara ose në rastet e forcave madhore.

6. Kontabilizimi mund të shtyhet, në rastin e përmendur në paragrafin e dytë, të pikës 3, të nenit 96, për sa kohë që njoftimi i borxhit doganor nuk pengon një hetim penal.

Neni 100
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet e parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të nenit 96, kur autoritetet doganore janë të përjashtuara nga detyrimi për të njoftuar borxhin doganor;

b) modalitetet për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve doganore dhe autoriteteve të tjera publike ose private, me qëllim vjeljen e borxhit doganor.

SEKSIONI 2
PAGESA E SHUMËS SË DETYRIMIT TË IMPORTIT OSE EKSPORTIT

Neni 101
Afatet e përgjithshme kohore për pagesën dhe pezullimi i afateve kohore për pagesën

1. Shuma e detyrimit të importit ose eksportit, që i përket një borxhi doganor të njoftuar, në përputhje me nenin 96, paguhet nga debitori brenda afatit të përcaktuar nga autoritetet doganore.

Pa cenuar pikën 2, të nenit 46, ky afat nuk duhet të kalojë 10 ditë nga data e njoftimit të borxhit doganor debitorit. Në rastin e kontabilizimit përmbledhës, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin e dytë, të pikës 1, të nenit 99, ky afat duhet të fiksohet në mënyrë të tillë që të mos i lejojë debitorit që të përfitojë një afat pagese më të gjatë se ai që do të kishte përfituar nëse do të kishte marrë zgjatje të afatit të pagesës, në përputhje me nenin 103.

Autoritetet doganore mund ta shtyjnë këtë afat me aplikim nga debitori kur shuma e detyrimit të importit ose eksportit për t'u paguar është përcaktuar gjatë kontrollit pas çlirimit (a posteriori) të përmendur në nenin 49. Pa cenuar pikën 1, të nenit 105, një shtyrje e tillë nuk duhet të kalojë kohën e nevojshme që i duhet debitorit për të ndërmarrë hapat e duhur për të shlyer detyrimin e tij.

2. Nëse debitori përfiton një nga lehtësitë e pagesës, të përcaktuara në nenet 103 deri 105, pagesa duhet të kryhet brenda afatit ose afateve të përcaktuara për këto lehtësi.

3. Afati i pagesës së shumës së detyrimit të importit ose eksportit, që i korrespondon borxhit doganor, pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) kur bëhet një kërkesë për faljen e detyrimit, në përputhje me nenin 114;

b) kur mallrat konfiskohen, shkatërrohen ose braktisen në favor të shtetit;

c) kur lind një borxh doganor, sipas nenit 74 dhe ka më shumë se një debitor.

Neni 102
Pagesa

1. Pagesa kryhet në të holla ose me çdo mënyre tjetër, e cila, sipas dispozitave në fuqi, ka të njëjtin efekt shlyerjeje, përfshirë rregullimet e balancës së kreditit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Pagesa mund të bëhet nga një person i tretë, në vend të debitorit, i autorizuar prej tij.

3. Debitori mund, në çdo rast, të paguajë plotësisht ose pjesërisht shumën e detyrimit të importit ose eksportit para përfundimit të afatit që i është dhënë për të kryer pagesën.

Neni 103
Shtyrja e pagesës

Autoritetet doganore, bazuar në aplikimin e personit të interesuar dhe përkundrejt një garancie, autorizojnë shtyrjen e pagesës së detyrimeve për t'u paguar në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) veçmas, për secilën nga shumat e detyrimit të importit ose eksportit të kontabilizuar, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 4, të nenit 99;

b) globalisht, për tërësinë e shumave të detyrimit të importit ose eksportit, të kontabilizuara, në përputhje me paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 99, gjatë një periudhe të caktuar nga autoritetet doganore që nuk i kalon 31 ditë;

c) globalisht, për të gjitha shumat e detyrimit të importit ose eksportit që formojnë një kontabilizim të vetëm, në përputhje me paragrafin e dytë, të pikës 1, të nenit 99.

Neni 104
Afatet e shtyrjes së pagesës

1. Afati, për të cilën shtyhet pagesa, sipas nenit 103, është 30 ditë.

2. Kur pagesa shtyhet në përputhje me shkronjën "a", të nenit 103, afati fillon nga dita e nesërme e njoftimit të borxhit doganor debitorit.

3. Kur pagesa shtyhet në përputhje me shkronjën "b", të nenit 103, afati fillon nga dita e nesërme e mbarimit të afatit të kontabilizimit përmbledhës. Këtij afati i zbritet numri i ditëve, që i korrespondon gjysmës së numrit të ditëve të afatit të kontabilizimit përmbledhës.

4. Kur pagesa shtyhet në përputhje me shkronjën "c", të nenit 103, periudha fillon nga dita e nesërme e mbarimit të afatit për çlirimin e mallrave në fjalë. Këtij afati i zbritet numri i ditëve, që i korrespondon gjysmës së numrit të ditëve të afatit në fjalë.

5. Kur numri i ditëve për afatet e përmendura në pikat 3 dhe 4 është një numër tek, numri i ditëve, që i zbriten afatit prej 30 ditësh, sipas këtyre pikave, është i barabartë me gjysmën e numrit më të vogël çift që vjen më pas.

6. Kur afatet e përmendura në pikat 3 dhe 4 janë javë kalendarike, autoritetet doganore mund të parashikojnë që pagesa e shumës së detyrimit të importit ose eksportit, për të cilën është shtyrë pagesa, të bëhet maksimumi të premten e javës së katërt që vjen pas asaj jave kalendarike.

Kur afatet janë muaj kalendarikë, autoritetet doganore mund të parashikojnë që shuma e detyrimit të importit ose eksportit, për të cilën është shtyrë pagesa, të paguhet ditën e 16-të të muajit pasardhës.

Neni 105
Lehtësi të tjera pagese

1. Autoritetet doganore mund t'i japin debitorit lehtësi pagese, përveç shtyrjes së pagesës, me kusht që ai të ofrojë një garanci.

2. Kur lehtësitë jepen sipas pikës 1, paguhet interes kredie mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit. Norma e interesit të kredisë është e njëjtë me normën e aplikuar në ditën e parë të muajit në fjalë nga Banka e Shqipërisë, për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, të rritura me 1 për qind.

3. Autoritetet doganore mund të mos kërkojnë një garanci ose të mos aplikojnë interesa kredie kur, në bazë të një vlerësimi të dokumentuar të situatës së debitorit, gjykohet se mund t'i krijohen vështirësi serioze ekonomike ose sociale.

4. Autoritetet doganore nuk aplikojnë interesin e kredisë kur shuma për t'u vjelë është më e vogël se 1 500 lekë.

Neni 106
Ekzekutimi i pagesës

Kur shuma e detyrimit të importit ose eksportit nuk është paguar brenda afatit të caktuar, autoritetet doganore përdorin të gjitha mjetet ligjore në fuqi për të siguruar ekzekutimin e pagesës.

Neni 107
Kamatëvonesat

1. Norma e kamatëvonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit nga data e përfundimit të afatit të parashikuar deri në datën e pagesës.

Norma e kamatëvonesave është e njëjtë me normën e aplikuar në ditën e parë të muajit në fjalë nga Banka e Shqipërisë, për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, të rritura me 2 për qind.

2. Kur një borxh doganor lind sipas nenit 74 ose 77 apo kur njoftimi i borxhit doganor vjen në vijim të një kontrolli, pas çlirimit, norma e kamatëvonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit, duke filluar nga data, në të cilën lind borxhi doganor deri në datën e njoftimit të tij.

Norma e kamatëvonesave vendoset në përputhje me paragrafin e dytë, të pikës 1.

3. Autoritetet doganore mund të mos kërkojnë zbatimin e normës së kamatëvonesave kur, në bazë të një vlerësimi të dokumentuar të situatës së debitorit, gjykohet se atij i krijohen vështirësi serioze ekonomike ose sociale.

4. Autoritetet doganore nuk zbatojnë kamatëvonesa kur shuma për t'u vjelë është më e vogël se 1 500 lekë.

Neni 108
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat për pezullimin e afatit kohor për pagesën e shumës së detyrimit të importit ose eksportit, që i korrespondon një borxhi doganor, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 101, dhe për afatin e pezullimit.

SEKSIONI 3
RIMBURSIMI DHE FALJA

Neni 109
Dispozita të përgjithshme

1. Bazuar në kushtet e përcaktuara në këtë seksion, shuma e detyrimeve të importit ose eksportit rimbursohet apo falet për arsyet e mëposhtme:

a) kur shumat e vjela janë më të mëdha se detyrimi i importit ose eksportit;

b) për mallrat defektoze ose që nuk janë në përputhje me kushtet e kontratës;

c) për gabime nga autoritetet kompetente;

ç) për kompensimin.

Kur një shumë e detyrimit të importit ose eksportit është paguar dhe deklarata doganore përkatëse anulohet, në përputhje me nenin 159, shuma rimbursohet.

2. Autoritetet doganore rimbursojnë shumën e detyrimit të importit ose eksportit, të përcaktuar në pikën 1, kur ajo është më e madhe se 1 500 lekë, përveçse kur personi i interesuar kërkon rimbursim edhe për shuma më të vogla.

3. Kur autoritetet doganore vlerësojnë që rimbursimi ose falja duhet të jepen në bazë të nenit 112 ose 113, ato ia kalojnë rastin/dosjen Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për vendimmarrje në rastet e mëposhtme:

a) kur autoritetet doganore konstatojnë se rrethanat e veçanta janë rezultat i një gabimi në aplikimin e detyrimeve të shkaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

b) kur autoritetet doganore konstatojnë se ka ndodhur një gabim brenda përcaktimeve të nenit 112;

c) kur rrethanat e çështjes lidhen me hetime që kryhen në kuadër të marrëveshjeve të asistencës së ndërsjellë dhe bashkëpunimit apo marrëveshjeve të tjera që Republika e Shqipërisë ka lidhur me vende apo grup-vendesh;

ç) kur shuma për t'u rimbursuar ose falur një personi për një ose më shumë operacione importi ose eksporti është më e madhe se 70 milionë lekë dhe është rrjedhojë e një gabimi ose rrethane të veçantë.

4. Bazuar në kompetencat për vendime, kur autoritetet doganore konstatojnë, brenda periudhave të parashikuara në pikën 1, të nenit 114, që shuma e detyrimit të importit ose eksportit duhet të jetë objekt i rimbursimit ose faljes, sipas parashikimeve të neneve 110, 112 ose 113, ato rimbursojnë ose falin shumën përkatëse me nismën e tyre.

5. Nuk jepet rimbursim ose falje kur situata, që ka çuar në njoftimin e borxhit doganor, rezulton të jetë shkaktuar nga një mashtrim i debitorit.

6. Rimbursimi nuk përfshin pagesën e interesave nga autoritetet doganore kompetente.

Megjithatë, interesi paguhet nëse vendimi për të dhënë rimbursimin nuk është zbatuar brenda tre muajve nga data e marrjes së vendimit, me përjashtim të rastit kur shkaqet e mosrespektimit të këtij afati ishin jashtë kontrollit të autoriteteve doganore.

Në raste të tilla, interesi paguhet nga data e përfundimit të afatit prej tre muajsh deri në datën e rimbursimit. Norma e interesit përcaktohet në përputhje me nenin 105.

7. Kur autoritetet doganore kanë bërë rimbursim ose falje të gabuar, rivendoset borxhi doganor fillestar për sa kohë nuk është tejkaluar afati i parashkrimit, sipas përcaktimeve të nenit 97.

Në raste të tilla, çdo interes i paguar sipas paragrafit e dytë, të pikës 5, rimbursohet.

Neni 110
Shuma të paguara tepër të detyrimit të importit ose eksportit

1. Një shumë e detyrimit të importit ose eksportit rimbursohet ose falet në atë masë sa shuma, që i korrespondon borxhit doganor të njoftuar fillimisht, kalon shumën që duhet paguar ose kur borxhi doganor i njoftohet debitorit në kundërshtim me shkronjat "c" ose "ç", të pikës 1, të nenit 96.

2. Kur aplikimi për rimbursim ose falje është bazuar në ekzistencën, në kohën e pranimit, të deklaratës doganore për qarkullim të lirë, të një detyrimi zero apo të reduktuar për mallrat, në kuadër të një kuote tarifore, tavani tarifor ose masave tarifore favorizuese, rimbursimi ose falja jepet me kusht që, në kohën e depozitimit të aplikimit, të shoqëruar me dokumentet përkatëse, të plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) në rastin e kuotave tarifore, nuk është arritur volumi i kuotës;

b) në rastet e tjera, nuk është rivendosur tarifa normale.

Neni 111
Mallrat defektoze ose jo në përputhje me kushtet e kontratës

1. Shuma e detyrimit të importit rimbursohet ose falet nëse njoftimi i borxhit doganor ka të bëjë me mallra, të cilat janë refuzuar nga importuesi, sepse, në momentin e çlirimit, ato ishin defektoze ose jo në përputhje me kushtet e kontratës, në bazë të së cilës ato janë importuar.

Mallra defektoze konsiderohen edhe mallrat e dëmtuara përpara çlirimit të tyre.

2. Pa anashkaluar dispozitat e pikës 3, rimbursimi ose falja e detyrimeve të importit jepet me kusht që mallrat të mos jenë përdorur, përveçse në një përdorim fillestar të domosdoshëm për të përcaktuar që mallrat janë defektoze ose nuk përputhen me kushtet e kontratës dhe me kusht që ato të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

3. Nuk jepet rimbursim ose falje kur:

a) mallrat, përpara se të çlirohen për qarkullim të lirë, ishin të vendosura nën një regjim të veçantë për testim, përveçse kur përcaktohet se fakti që mallrat ishin defektoze ose jo në përputhje me kushtet e kontratës nuk mund të dallohej në kuadër të kryerjes së testit;

b) natyra e defektit të mallrave ishte marrë në konsideratë gjatë hartimit të kushteve të kontratës, në veçanti të çmimit, përpara se mallrat të vendoseshin në një regjim doganor që përfshin lindjen e një borxhi doganor; ose

c) mallrat janë shitur nga aplikuesi pasi është bërë e qartë se kanë qenë defektoze ose nuk përputhen me kushtet e kontratës.

4. Me aplikim nga personi i interesuar, mallra të tilla, në vend që të nxirren nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, mund të autorizohen nga autoritetet doganore që të vendosen nën regjimin e përpunimit aktiv, përfshirë dhe shkatërrimin, në regjimin e transitit të jashtëm, në regjimin e magazinës doganore ose të zonës së lirë.

Neni 112
Gabime të autoriteteve kompetente

1. Në raste të tjera nga ato të përmendura në paragrafin e dytë, të pikës 1, të nenit 109, dhe në nenet 110, 111 dhe 113, shuma e detyrimit të importit ose eksportit rimbursohet ose falet kur, si rezultat i gabimit nga autoritetet kompetente, shuma, që i korrespondon borxhit doganor që ishte njoftuar fillimisht, ishte më e ulët se shuma që duhet paguar, me kusht që të përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) debitori nuk ka qenë në dijeni të gabimit;

b) debitori po vepronte në mirëbesim.

2. Kur nuk përmbushen kushtet e pikës 2, të nenit 110, jepet përjashtim ose falje kur mosaplikimi i tarifës zero ose të reduktuar ka ardhur si rezultat i një gabimi nga ana e autoriteteve doganore dhe kur deklarata doganore përmban të gjitha detajet dhe është e shoqëruar me të gjitha dokumentet për aplikimin e një tarife zero ose të reduktuar.

3. Kur trajtimi preferencial i mallrave është dhënë mbështetur në një sistem të bashkëpunimit administrativ me autoritetet e një vendi ose territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, lëshimi i një certifikate nga këto autoritete, nëse rezulton që është jokorrekt (i gabuar), përbën një gabim, i cili nuk mund të zbulohej në mënyrë të arsyeshme, sipas kuptimit të shkronjës “a”, të pikës 1.

Lëshimi i një certifikate të pasaktë, megjithatë, nuk përbën gabim, kur certifikata mbështetet në fakte jo të sakta, të dhëna nga eksportuesi, përveçse kur është evidente që autoritetet lëshuese të certifikatës ishin në dijeni ose duhej të ishin në dijeni se mallrat nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara për dhënien e trajtimit preferencial.

Debitori konsiderohet në mirëbesim nëse ai mund të provojë që brenda periudhës kohore të veprimeve tregtare në fjalë ai ka treguar kujdesin e duhur për të garantuar përmbushjen e të gjitha kushteve të trajtimit preferencial.

Debitori nuk mund të justifikohet me faktin se ka qenë në mirëbesim nëse është miratuar/publikuar dhe/ose njoftuar një akt që tregon se ka dyshime të arsyeshme që kanë të bëjnë me zbatimin e duhur të marrëveshjeve preferenciale nga vendi ose territori përfitues.

Neni 113
Kompensimi

1. Në raste të tjera nga ato të përcaktuara në paragrafin e dytë, të pikës 1, të nenit 109, dhe në nenet 110, 111 dhe 112, një shumë e detyrimit të importit ose eksportit rimbursohet ose falet për shkak të kompensimit kur një borxh doganor ka lindur nën rrethana të veçanta, në të cilat asnjë mashtrim ose neglizhencë e dukshme nuk mund t’i atribuohet debitorit.

2. Rrethanat e veçanta, të përmendura në pikën 1 konsiderohet se ekzistojnë kur, nga rrethanat e rastit, është e qartë se debitori është në një situatë shumë të veçantë, krahasuar me operatorët e tjerë të së njëjtës fushë dhe që, në mungesë të kësaj situate, ai nuk do të kishte pësuar disavantazhe nga vjelja e detyrimeve të importit ose eksportit.

Neni 114
Procedura për rimbursim dhe falje

1. Aplikimi për rimbursim ose falje, në përputhje me nenin 109, paraqitet në zyrën doganore kompetente brenda afateve të mëposhtme:

a) në rast vjeljeje më tepër të shumës së detyrimeve të importit ose eksportit, si rrjedhojë e gabimit nga autoritetet kompetente, ose për arsye të kompensimit brenda një afati trevjeçar, duke filluar nga data e njoftimit të borxhit doganor;

b) në rast të mallrave defektoze ose jo në përputhje me kushtet e kontratës, brenda një viti nga data e njoftimit të borxhit doganor;

c) në rast të anulimit të një deklarate doganore, brenda afatit të përcaktuar në rregullat që kanë lidhje me anulimin.

Afatet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, shtyhen kur aplikuesi siguron prova që ai nuk mund të paraqiste kërkesën e tij brenda afatit të parashikuar, si rezultat i rrethanave të paparashikueshme ose të një force madhore.

2. Kur autoritetet doganore, për shkak të arsyeve të caktuara, nuk kanë mundësi të rimbursojnë ose të falin një shumë detyrimesh importi ose eksporti, atëherë ato duhet ta shqyrtojnë atë aplikim për rimbursim ose falje, në kuadër të hapësirave të tjera që disponojnë, sipas përcaktimeve të nenit 109.

3. Kur është depozituar një ankim kundër një njoftimi të borxhit doganor, sipas përcaktimeve të nenit 45, afatet e përcaktuara në paragrafin e parë, të pikës 1, të këtij neni, pezullohen, duke filluar nga data e depozitimit të ankimit deri në përfundimin e procedurave të këtij ankimi.

Neni 115
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat, të cilat zbatohen gjatë marrjes së një vendimi, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 109, dhe në veçanti, për:

a) kushtet për pranimin e aplikimit/dosjes;

b) afatin kohor për marrjen e vendimit dhe të pezullimit të këtij afati kohor;

c) njoftimin e arsyeve, mbi të cilat do të bazohet vendimi, përpara se ky vendim, që ka pasoja jo në favor të personit të interesuar, të merret.

ç) njoftimin e vendimit;

d) pasojat e mosmarrjes së një vendimi ose mosnjoftimit të tij;

dh) rregullat procedurale të rimbursimit dhe faljes, të përcaktuara në nenin 109.

KREU IV
SHUARJA E BORXHIT DOGANOR

Neni 116
Shuarja

1. Pa cenuar dispozitat në fuqi, në lidhje me mosvjeljen e shumës së detyrimit të importit ose eksportit, që i korrespondon borxhit doganor në rastin e paaftësisë paguese të debitorit, të përcaktuar në rrugë gjyqësore, një borxh doganor në import ose eksport shuhet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) kur debitori nuk mund të marrë më njoftimin e borxhit doganor, sipas nenit 97;

b) me anë të pagesës së shumës së detyrimit të importit ose eksportit;

c) në përputhje me pikën 5, me anë të faljes së shumës së detyrimit të importit ose eksportit;

ç) kur deklarata doganore për mallrat e deklaruara nën një regjim doganor, për të cilat duhet të paguhet detyrimi i importit ose eksportit, është anuluar;

d) kur mallrat, që u nënshtrohen detyrimeve të importit ose eksportit, janë sekuestruar dhe njëkohësisht ose më vonë janë konfiskuar;

dh) kur mallrat, që i nënshtrohen detyrimeve të importit ose eksportit, asgjësohen nën mbikëqyrjen doganore ose braktisen në favor të shtetit;

e) kur zhdukja e mallrave ose mosplotësimi i detyrimeve, sipas legjislacionit doganor, rrjedhin nga shkatërrimi total ose nga humbja e pakthyeshme e këtyre mallrave, për shkak të vetë natyrës së mallrave ose të rrethanave të paparashikueshme ose të një force madhore apo si pasojë e udhëzimeve të autoriteteve doganore. Për qëllim të kësaj pike, mallrat konsiderohen si humbje e pakthyeshme kur ato janë bërë të papërdorshme nga çdo person;

ë) kur borxhi doganor lind sipas nenit 74 ose 77 dhe kur plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

i) mangësitë që kanë shkaktuar lindjen e borxhit doganor nuk kanë pasur pasoja reale në funksionimin korrekt të regjimit doganor dhe nuk përbëjnë një tentativë mashtrimi;

ii) të gjitha formalitetet e nevojshme për të rregulluar situatën e mallrave kryhen në një fazë të mëvonshme;

f) kur mallrat e çliruara për qarkullim të lirë, të përjashtuara nga detyrimet e importit ose që kanë detyrime importi të reduktuara, për arsye të përdorimit të tyre të veçantë përfundimtar (end-use), janë eksportuar me lejen e autoriteteve doganore;

g) kur borxhi doganor ka lindur bazuar në nenin 73 dhe kur formalitetet e kryera për të mundësuar dhënien e trajtimit tarifor preferencial, të përmendur në këtë nen, janë anuluar;

gj) kur, mbështetur në pikën 6, të këtij neni, borxhi doganor ka lindur sipas nenit 74 dhe bazuar në provat e vëna në dispozicion, autoritetet doganore vlerësojnë se mallrat nuk janë përdorur ose konsumuar dhe që ato kanë dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Në rastet e parashikuara në shkronjën "d", të pikës 1, borxhi doganor, për qëllime të sanksioneve të zbatueshme, në rast të shkeljeve doganore, konsiderohet si të mos jetë shuar kur, sipas ligjit, në Republikën e Shqipërisë, detyrimet e importit ose eksportit ose ekzistenca e borxhit doganor shërben si bazë për përcaktimin e sanksioneve.

3. Kur, në përputhje me shkronjën "e", të pikës 1, një borxh doganor shuhet për sa u përket mallrave të çliruara për qarkullim të lirë me detyrime importi të përjashtuara ose me detyrime të reduktuara, për arsye të

përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) të tyre dhe çdo hedhurinë ose mbetje, si rezultat i shkatërrimit të tyre, konsiderohet si mall joshqiptar.

4. Dispozitat e legjislacionit doganor në fuqi për normativat standarde të humbjeve të pakthyeshme, për arsye që kanë lidhje me vetë natyrën e mallit, zbatohen kur personi i interesuar nuk është në gjendje të provojë që humbja reale është më e madhe se ajo e llogaritur, duke zbatuar normativat standarde që lidhen me mallin në fjalë.

5. Kur disa persona janë përgjegjës për pagesën e shumës së detyrimit të importit ose eksportit, që i korrespondon borxhit doganor dhe është dhënë falja, borxhi doganor shuhet vetëm për personin ose personat të cilit/të cilëve u është dhënë falja.

6. Në rastin e përmendur në shkronjën "h", të pikës 1, borxhi doganor nuk shuhet për personin/personat që kanë bërë një tentativë për mashtrim.

7. Kur borxhi doganor krijohet sipas nenit 74, ai shuhet për personin, sjellja e të cilit nuk përbën tentativë për mashtrim dhe që ka ndihmuar autoritetet doganore në luftën kundër mashtrimit.

Neni 117
Zbatimi i sanksioneve

Kur borxhi doganor shuhet në bazë të shkronjës "ë", të pikës 1, të nenit 116, nuk zbatohen sanksione për mosrespektim të legjislacionit doganor.

Neni 118
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohet lista e mangësive që janë pa pasojë reale në funksionimin korrekt të regjimit doganor përkatës dhe që përfshihen në nënndarjen "i", të shkronjës "ë", të pikës 1, të nenit 116.

TITULLI IV
MALLRAT QË HYJNË NË TERRITORIN DOGANOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KREU I
DEKLARATA PËRMBLEDHËSE E HYRJES

Neni 119
Depozitimi i deklaratës përmbledhëse të hyrjes

1. Mallrat që futen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë shoqërohen nga një deklaratë përmbledhëse e hyrjes.

2. Detyrimi i parashikuar në pikën 1 nuk zbatohet:

a) për mjetet e transportit dhe mallrave që gjenden në to, të cilat përshkojnë pa ndalesë ujërat territoriale ose hapësirën ajrore të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) në raste të tjera të justifikuara nga lloji i transportit ose nga detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare.

3. Deklarata përmbledhëse e hyrjes depozitohet në zyrën doganore hyrëse, brenda një afati të përcaktuar, para hyrjes së mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Autoritetet doganore mund të lejojnë që deklarata përmbledhëse e hyrjes të depozitohet në një zyrë tjetër doganore, me kusht që kjo e fundit të komunikojë menjëherë ose t'ia bëjë të disponueshme në rrugë elektronike zyrës doganore hyrëse të dhënat e nevojshme.

4. Deklarata përmbledhëse e hyrjes depozitohet nga transportuesi. Pavarësisht nga detyrimet e transportuesit, deklarata përmbledhëse e hyrjes mund të depozitohet edhe nga njëri prej personave të mëposhtëm:

a) importuesi e pritësi apo çdo person tjetër në emër ose për llogari të të cilit vepron transportuesi;

b) çdo person, i cili është i aftë të paraqesë mallrat në fjalë ose t'i ketë paraqitur ato në zyrën doganore të hyrjes.

5. Deklarata përmbledhëse e hyrjes përmban të dhënat e nevojshme për kryerjen e analizave të riskut, për qëllime të sigurisë dhe mbrojtjes.

6. Në raste të veçanta, kur nuk është e mundur marrja e të gjitha të dhënave, në përputhje me pikën 5, nga personat e parashikuar në pikën 4, dhënia e këtyre informacioneve mund t'u kërkohet personave të tjerë që i disponojnë këto të dhëna dhe që legjitimohen për këtë dhënie.

7. Autoritetet doganore mund të pranojnë përdorimin e sistemeve informatike të operatorëve tregtarë, operatorëve portualë ose transportues për depozitimin e një deklarate përmbledhëse hyrjeje, me kusht që këto sisteme të përmbajnë të dhënat e nevojshme të kësaj deklarate dhe të dhënat të vihen në dispozicion brenda një afati të caktuar para hyrjes së mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

8. Autoritetet doganore mund të pranojnë, në vend të depozitimit të deklaratës përmbledhëse të hyrjes, depozitimin e një njoftimi dhe aksesin në të dhënat përkatëse të deklaratës përmbledhëse hyrëse që gjenden në sistemin informatik të operatorit ekonomik.

Neni 120
Analiza e riskut

Zyra doganore e përcaktuar në pikën 3, të nenit 119, siguron që brenda një afati kohor të caktuar dhe kryesisht për qëllime të sigurisë dhe mbrojtjes të kryejë një analizë risku, mbi bazë të deklaratës përmbledhëse të hyrjes, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 119, ose të të dhënave të përcaktuara në pikën 8, të nenit 119, dhe duhet të marrë masat e nevojshme bazuar në rezultatet e kësaj analize risku.

Neni 121
Ndryshimi dhe anulimi i deklaratës përmbledhëse të hyrjes

1. Deklaruesi, përmes një aplikimi, mund të autorizohet të ndryshojë një ose më shumë të dhëna të deklaratës përmbledhëse të hyrjes, pas depozitimit të saj.

Asnjë ndryshim i tillë nuk do të jetë i mundur pas njërit prej rasteve të mëposhtme:

a) autoritetet doganore kanë informuar personin i cili depozitoi deklaratën përmbledhëse të hyrjes që ato kanë si qëllim të kontrollojnë mallrat;

b) autoritetet doganore kanë përcaktuar që të dhënat e deklaratës përmbledhëse të hyrjes janë të pasakta;

c) mallrat janë paraqitur në doganë.

2. Kur mallrat, për të cilat është depozituar një deklaratë përmbledhëse e hyrjes, nuk kanë hyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, autoritetet doganore e anulojnë deklaratën në një prej rasteve të mëposhtme:

a) me aplikim nga deklaruesi;

b) brenda 200 ditëve nga data e depozitimit të deklaratës.

Neni 122
Deklarata të depozituara që zëvendësojnë deklaratën përmbledhëse të hyrjes

1. Zyra doganore e përcaktuar në pikën 3, të nenit 119, mund të mos kërkojë depozitimin e një deklarate përmbledhëse të hyrjes për mallrat, për të cilat, përpara mbarimit të afatit kohor për të depozituar deklaratën përmbledhëse të hyrjes, është depozituar një deklaratë doganore. Në këtë rast, deklarata doganore duhet të përmbajë të paktën të dhënat e nevojshme të deklaratës përmbledhëse të hyrjes. Deri në momentin që deklarata doganore pranohet në përputhje me nenin 157, ajo ka statusin e deklaratës përmbledhëse të hyrjes.

2. Zyra doganore e përcaktuar në pikën 3, të nenit 119, mund të mos kërkojë depozitimin e një deklarate përmbledhëse të hyrjes për mallrat, për të cilat, përpara mbarimit të afatit kohor për të depozituar deklaratën përmbledhëse të hyrjes, është depozituar një deklaratë për magazinim të përkohshëm. Kjo deklaratë duhet të përmbajë të paktën të dhënat e nevojshme të deklaratës përmbledhëse të hyrjes. Deri në momentin që mallrat e deklaruara të paraqiten në doganë, sipas përcaktimeve të nenit 130, deklarata për magazinim të përkohshëm ka statusin e deklaratës përmbledhëse të hyrjes.

Neni 123
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet kur, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 119, nuk kërkohet depozitimi i një deklarate përmbledhëse të hyrjes;

b) afatet kohore, të përmendura në pikat 3 dhe 7, të nenit 119, brenda të cilave, përpara se mallrat të hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duhet të depozitohet deklarata përmbledhëse e hyrjes, duke marrë në konsideratë llojin e mallrave dhe të trafikut;

c) rastet e përcaktuara në pikën 6, të nenit 119, dhe personat e tjerë, të cilëve u kërkohet të depozitojnë të dhëna të deklaratës përmbledhëse të hyrjes në ato raste;

ç) rregullat procedurale për depozitimin e një deklarate përmbledhëse të hyrjes, sipas përcaktimeve të nenit 119;

d) rregullat procedurale për dhënien e të dhënave të deklaratës përmbledhëse të hyrjes nga persona të tjerë, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 119;

dh) afati kohor, brenda të cilit duhet të kryhet analiza e riskut, dhe masat që ndërmerren në përputhje me nenin 120;

e) rregullat procedurale për ndryshimin e deklaratës përmbledhëse të hyrjes, në përputhje me pikën 1, të nenit 121;

ë) rregullat procedurale për bërjen të pavlefshme të deklaratës përmbledhëse të hyrjes, në përputhje me pikën 2, të nenit 121, duke marrë parasysh menaxhimin e duhur të hyrjes së mallrave.

KREU II
MBËRRITJA E MALLRAVE

SEKSIONI 1
HYRJA E MALLRAVE NË TERRITORIN DOGANOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 124
Njoftimi i mbërritjes së një anijeje detare ose një mjeti ajror

1. Operatori (përdoruesi) i një anijeje detare ose i një mjeti ajror, që hyn në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në momentin e mbërritjes së mjetit të transportit, njofton zyrën doganore hyrëse.

Kur informacioni për mbërritjen e një anijeje detare ose të një mjeti ajror është i disponueshëm nga autoritetet doganore, ato mund të mos kërkojnë njoftimin e mbërritjes së përmendur në paragrafin e parë të kësaj pike.

2. Autoritetet doganore mund të pranojnë që të përdoren sistemet portuale, aeroportuale ose metoda të tjera informimi të vlefshme për të njoftuar mbërritjen e mjeteve.

Neni 125
Mbikëqyrja doganore

1. Mallrat e futura në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, nga momenti i hyrjes së tyre, i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore dhe mund të jenë objekt i kontrolleve doganore. Në përputhje me ligjin,

mallrat janë objekt i ndalimeve dhe kufizimeve për arsye të mbrojtjes së moralit shoqëror, rendit publik ose sigurisë publike, mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve apo bimëve, mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes së pasurive kombëtare me vlerë artistike, historike apo arkeologjike dhe mbrojtjes së pronësisë industriale ose tregtare. Këto ndalime dhe kufizime përfshijnë edhe kontrollin e prekursorëve kimikë, të mallrave që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale dhe shumat në të holla që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, si edhe zbatimin e masave mbrojtëse dhe menaxhuese për peshkimin dhe masat e politikës tregtare.

Ato mbeten nën një mbikëqyrje të tillë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për t'u përcaktuar statusi i tyre doganor dhe nuk duhet të lëvizen pa lejen e autoriteteve doganore.

Pa cenuar nenin 227, mallrat shqiptare, sapo përcaktohet statusi i tyre doganor, nuk janë objekt i mbikëqyrjes doganore.

Mallrat joshqiptare mbeten nën mbikëqyrje doganore derisa ato ndryshojnë statusin e tyre doganor ose ato dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë apo shkatërrohen.

2. Mbajtësi i mallrave nën mbikëqyrje doganore mund, me lejen e autoriteteve doganore, në çdo kohë, të shqyrtojë mallrat ose të marrë mostra, në veçanti, për të përcaktuar klasifikimin e tyre tarifor, vlerën doganore ose statusin doganor.

Neni 126
Transporti drejt vendit të duhur

1. Personi, i cili fut mallra në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, i transporton ato pa vonesë në rrugën e përcaktuar nga autoritetet doganore dhe, në përputhje me udhëzimet e tyre, nëse ka të tilla, drejt zyrës doganore të caktuar ose në një vend tjetër të përcaktuar nga këto autoritete apo në një zonë të lirë.

2. Çdo person, i cili merr përgjegjësinë për transportimin e mallrave, pasi ato janë futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, është përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në pikën 1.

3. Pika 1 nuk pengon zbatimin e dispozitave të veçanta për sa u përket mallrave të transportuara në zonat kufitare ose në tubacione apo kabllo, po ashtu edhe trafikut me rëndësi të papërfillshme ekonomike, siç janë letrat, kartolinat dhe materialet e printuara dhe ekuivalentët e tyre elektronikë ose mallrave të transportuara nga udhëtarët, për aq sa mbikëqyrja doganore dhe mundësitë e kontrollit doganor nuk rrezikohen.

4. Pika 1 nuk zbatohet për mjetet e transportit dhe mallrat e transportuara në to, të cilat vetëm kalojnë nëpërmjet ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë pa ndalesë brenda këtij territori.

Neni 127
Shërbimet e brendshme ajrore dhe detare

Nenet 119 deri në 122 dhe pika 1 e nenit 124, nenet 126, 128, 130 deri në 132, e 134 deri në 139 nuk zbatohen për mallrat joshqiptare dhe mallrat e përcaktuara në nenin 144, të cilat kanë lënë përkohësisht territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që lëvizin ndërmjet dy pikave në këtë territor nga deti ose ajri, me kusht që transporti të jetë kryer nga një rrugë direkte pa ndalesë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 128
Transporti nën rrethana të veçanta

1. Kur, për arsye të rrethanave të paparashikuara ose të një force madhore, detyrimi i përcaktuar në pikën 1, të nenit 126, nuk mund të përmbushet, personi përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi ose çdo person tjetër që vepron në emër dhe për llogari të atij personi duhet të informojë pa vonesë autoritetet doganore për situatën. Kur rrethanat e paparashikuara ose forca madhore nuk kanë shkaktuar humbjen e plotë të mallrave, autoritetet doganore duhet gjithashtu të informohen për vendndodhjen e saktë të tyre.

2. Kur, për arsye të rrethanave të paparashikuara ose të një force madhore, një mjet lundrimi ose ajror, sipas pikës 4, të nenit 126, është i detyruar të hyjë në port ose të ulet përkohësisht në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe detyrimi i përcaktuar në pikën 1, të nenit 126, nuk mund të përmbushet, personi, i cili solli mjetin e lundrimit ose atë ajror në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë apo çdo person tjetër që vepron në emër dhe për llogari të tij, duhet të informojë pa vonesë autoritetet doganore për situatën.

3. Autoritetet doganore përcaktojnë masat që duhen marrë për të lejuar mbikëqyrjen doganore të mallrave të përmendura në pikën 1 ose të mjetit të lundrimit apo atij ajror dhe të çdo malli në to në rrethanat e specifikuara në pikën 2 dhe të sigurojë, kur është me vend, që ato janë transportuar më pas në një zyrë doganore ose në çdo vend tjetër të caktuar apo miratuar nga autoritetet.

Neni 129
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat procedurale për:

a) njoftimin e mbërritjes, sipas përcaktimeve të nenit 124;

b) transportin e mallrave, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 126.

SEKSIONI 2
PARAQITJA, SHKARKIMI DHE VERIFIKIMI I MALLRAVE

Neni 130
Paraqitja e mallrave në doganë

1. Mallrat e futura në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë paraqiten në doganë menjëherë pas mbërritjes së tyre në zyrën doganore të caktuar ose në çdo vend tjetër të caktuar apo miratuar nga autoritetet doganore ose në zonë të lirë nga një prej personave të mëposhtëm:

a) personi, i cili futi mallrat në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) personi, në emër e për llogari të të cilit vepron personi që futi mallrat në këtë territor;

c) personi, i cili merr përgjegjësi për transportimin e mallrave, pasi ato janë futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Mallrat, që futen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë detare ose ajrore dhe që për qëllime transporti mbeten në të njëjtin mjet transporti, paraqiten në doganë vetëm në portin ose aeroportin, në të cilin janë shkarkuar ose transborduar. Megjithatë nuk paraqiten në doganë në port ose aeroport mallrat që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që shkarkohen dhe ringarkohen në të njëjtin mjet transporti gjatë itinerarit në fjalë për të mundësuar shkarkimin ose ngarkimin e mallrave të tjera.

3. Pavarësisht nga detyrimet e personit të përmendur në pikën 1, paraqitja e mallrave mund të kryhet edhe nga një prej personave të mëposhtëm:

a) çdo person, i cili i vendos menjëherë mallrat nën një regjim doganor;

b) mbajtësi i një autorizimi për shfrytëzimin e ambienteve të magazinimit ose çdo person, i cili kryen një aktivitet në një zonë të lirë.

4. Personi që paraqet mallrat i referohet deklaratës përmbledhëse të hyrjes ose, në rastet e parashikuara në nenin 122, deklaratës doganore ose deklaratës për magazinim të përkohshëm që është depozituar për këto mallra përveçse kur depozitimi i një deklarate përmbledhëse të hyrjes nuk kërkohet.

5. Kur mallrat joshqiptare të paraqitura në doganë nuk janë të mbuluara nga një deklaratë përmbledhëse e hyrjes dhe përveçse kur nuk kërkohet depozitimi i një deklarate të tillë, një nga personat e përcaktuar në pikën 4, të nenit 119, pa rënë ndesh me pikën 6, të nenit 119, duhet të depozitojë menjëherë deklaratën përmbledhëse të hyrjes ose në vend të saj një deklaratë doganore ose deklaratë për magazinim të përkohshëm.

6. Përcaktimet sipas pikës 1 të këtij neni nuk përjashtojnë zbatimin e rregullave të veçanta për sa u përket mallrave të transportuara në zonat kufitare ose në tubacione apo kabllo, si dhe trafikut me rëndësi të papërfillshme ekonomike, siç janë letrat, kartolinat dhe materialet e printuara dhe ekuivalentët e tyre elektronikë ose mallrave të transportuara nga udhëtarët, për aq sa mbikëqyrja doganore dhe mundësitë e kontrollit doganor nuk rrezikohen.

7. Mallrat e paraqitura në doganë nuk mund të lëvizen nga vendi ku ato janë paraqitur pa autorizimin e autoriteteve doganore.

Neni 131
Shkarkimi dhe verifikimi i mallrave

1. Mallrat shkarkohen ose transbordohen nga mjetet e transportit, në të cilat ato gjenden vetëm me autorizim të autoriteteve doganore dhe vetëm në vendet e caktuara ose të miratuara nga këto autoritete.

Megjithatë, ky autorizim nuk kërkohet në rast të një rreziku të pashmangshëm që sjell si nevojë shkarkimin e menjëhershëm të të gjitha mallrave ose të një pjese të tyre. Në këtë rast, autoritetet doganore duhet të informohen menjëherë.

2. Autoritetet doganore mund të kërkojnë në çdo kohë që mallrat të shkarkohen dhe të shpaketohen me qëllim verifikimin e tyre, marrjen e mostrave ose verifikimin/kontrollin e mjetit të transportit që i transporton ato.

Neni 132
Mallrat që lëvizin nën regjimin e transitit

1. Pikat 2 deri në 4, të nenit 126, dhe nenet 130, 131 e 134 deri në 139 nuk zbatohen kur mallrat, që janë aktualisht nën një regjim transiti, hyjnë brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Nenet 131 dhe 134 deri në 139 zbatohen për mallrat joshqiptare që lëvizin nën një regjim transiti, sapo ato paraqiten në zyrën doganore të destinacionit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me dispozitat mbi regjimin e transitit.

Neni 133
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kushtet për miratimin e vendeve të përmendura në pikën 1, të nenit 130;

b) rregullat procedurale për sa i përket paraqitjes të mallrave në doganë, sipas nenit 130.

SEKSIONI 3
MAGAZINIMI I PËRKOHSHËM I MALLRAVE

Neni 134
Mallrat në magazinim të përkohshëm

Mallrat joshqiptare vendosen në magazinim të përkohshëm nga momenti që ato paraqiten në doganë.

Neni 135
Deklarata e magazinimit të përkohshëm

1. Mallrat joshqiptare që paraqiten në doganë mbulohen nga një deklaratë e magazinimit të përkohshëm, e cila përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për zbatimin e dispozitave që rregullojnë magazinimin e përkohshëm.

2. Dokumentet, që kanë lidhje me mallrat në magazinim të përkohshëm, u vihen në dispozicion autoriteteve doganore kur e kërkon legjislacioni shqiptar ose kur është e nevojshme për kryerjen e kontrolleve doganore.

3. Deklarata për magazinim të përkohshëm depozitohet nga një prej personave të përcaktuar në pikën 1 ose 3, të nenit 130, në një moment të dytë pas paraqitjes së mallrave në doganë.

4. Përveçse kur nuk kërkohet depozitimi i një deklarate përmbledhëse të hyrjes, deklarata e magazinimit të përkohshëm duhet të përmbajë një referencë të çdo deklarate përmbledhëse të hyrjes për mallrat që paraqiten në doganë, përveçse kur mallrat kanë qenë ndërkohë në magazinim të përkohshëm ose janë vendosur nën një regjim doganor dhe nuk kanë lënë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

5. Autoritetet doganore mund të pranojnë që deklarata e magazinimit të përkohshëm të marrë një nga format e mëposhtme:

a) e një reference të deklaratës përmbledhëse të hyrjes, të depozituar për mallrat në fjalë, të plotësuar me të dhënat e një deklarate të magazinimit të përkohshëm;

b) e një manifesti ose të një dokumenti tjetër transporti, me kusht që ai të përmbajë të dhënat e një deklarate të magazinimit të përkohshëm, përfshirë referencën e çdo deklarate përmbledhëse të hyrjes për mallrat në fjalë.

6. Autoritetet doganore mund të pranojnë përdorimin e sistemeve informatike të dokumenteve tregtare, portuale ose të transportit për paraqitjen e një deklarate të magazinimit të përkohshëm, me kusht që këto sisteme të përmbajnë të dhënat e nevojshme të kësaj deklarate dhe që këto të dhëna të vihen në dispozicion të tyre, në përputhje me pikën 3.

7. Nenet 169 deri në 174 zbatohen për deklaratën e magazinimit të përkohshëm.

8. Deklarata e magazinimit të përkohshëm mund të përdoret gjithashtu për qëllime të:

a) njoftimit të mbërritjes, sipas përcaktimeve të nenit 124;

b) paraqitjes së mallrave në doganë sipas përcaktimeve të nenit 130, për sa kohë që ajo plotëson kushtet e parashikuara në ato dispozita.

9. Një deklaratë e magazinimit të përkohshëm nuk kërkohet kur, pas momentit të paraqitjes së mallrave në doganë, statusi doganor i tyre si mallra shqiptare përcaktohet në përputhje me nenet 142 deri në 145.

10. Deklarata e magazinimit të përkohshëm mbahet nga autoritetet doganore ose u bëhet e aksesueshme atyre për qëllime të verifikimit që mallrat, me të cilat ajo (deklarata) ka lidhje, janë vendosur më vonë nën një regjim doganor ose janë rieksporuar në përputhje me nenin 139.

11. Për qëllime të pikave 1 deri në 10, kur mallrat joshqiptare të lëvizura nën një regjim transiti janë paraqitur në doganë në një zyrë destinacioni brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, të dhënat për operacionin e transitit në fjalë konsiderohen si të jenë deklaratë e magazinimit të përkohshëm, me kusht që ato të plotësojnë kërkesat për atë qëllim. Megjithatë mbajtësi i mallrave mund të depozitojë një deklaratë të magazinimit të përkohshëm pas mbylljes së regjimit të transitit.

Neni 136
Ndryshimi dhe anulimi i një deklarate për magazinim të përkohshëm

1. Me anë të një aplikimi, deklaruesi lejohet të ndryshojë një ose më shumë të dhëna të deklaratës për magazinim të përkohshëm, pasi ajo është depozituar. Nuk mund të bëhet ndryshim në deklaratën fillestare për mallrat, të ndryshme nga ato të deklaruara fillimisht në atë deklaratë.

Nuk mund të bëhet asnjë ndryshim pasi autoritetet doganore:

a) kanë informuar personin që ka depozituar deklaratën se ato kanë për qëllim të kontrollojnë mallrat;

b) përcaktojnë se të dhënat e deklaratës janë të pasakta.

2. Kur mallrat, për të cilat është depozituar një deklaratë e magazinimit të përkohshëm, nuk janë paraqitur në doganë, autoritetet doganore e anulojnë deklaratën në një prej rasteve të mëposhtme:

a) me aplikim nga deklaruesi;

b) brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të deklaratës.

Neni 137
Kushtet dhe përgjegjësitë për magazinimin e përkohshëm të mallrave

1. Mallrat në magazinim të përkohshëm mund të magazinohen vetëm në ambiente magazinimi të përkohshme, në

përputhje me nenin 138 ose, kur është e justifikueshme, në vende të tjera të caktuara ose të miratuara nga autoritetet doganore.

2. Pa cenuar pikën 2, të nenit 125, mallrat në magazinim të përkohshëm janë objekt vetëm i atyre formave të trajtimit, të destinuara për të garantuar ruajtjen e tyre në një gjendje të pandryshueshme, pa i ndryshuar pamjen ose karakteristikat teknike.

3. Mbajtësi i autorizimit, i përcaktuar në nenin 138, ose personi, që magazinon mallrat në rastet kur ato magazinohen në vende të tjera, të caktuara ose të miratuara nga autoritetet doganore, është përgjegjës:

a) për të siguruar që mallrat në magazinim të përkohshëm nuk i shmangen mbikëqyrjes doganore;

b) për të plotësuar detyrimet që rrjedhin nga magazinimi i mallrave në magazinë të përkohshme.

4. Kur, për çdo arsye, mallrat nuk mund të mbahen në magazinë të përkohshme, autoritetet doganore, pa vonesë, marrin të gjitha masat e nevojshme për të rregulluar situatën e mallrave, në përputhje me nenet 178, 179 dhe 180.

Neni 138

Autorizimi për përdorimin e ambienteve të magazinimit të përkohshëm

1. Për përdorimin e ambienteve të magazinimit të përkohshëm kërkohet një autorizim nga ana e autoriteteve doganore. Ky autorizim nuk kërkohet kur operatorë të ambienteve të magazinimit të përkohshëm janë vetë autoritetet doganore.

Kushtet, në të cilat lejohet përdorimi i ambienteve të magazinimit të përkohshëm, përcaktohen në autorizim.

2. Autorizimi i përcaktuar në pikën 1 u jepet vetëm personave që plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) janë të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) japin garancitë e nevojshme për zhvillimin e duhur të operacioneve. Një operator ekonomik i autorizuar në fushën e thjeshtësimeve doganore konsiderohet që e plotëson këtë kusht në rast se përdorimi i ambienteve të magazinimit të përkohshëm është përfshirë në autorizim, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 40;

c) depozitojnë një garanci, në përputhje me nenin 84.

Kur depozitohet një garanci globale, autoritetet doganore mbikëqyrin përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i kësaj garancie.

3. Autorizimi i përcaktuar në pikën 1 jepet vetëm kur autoritetet doganore mund të garantojnë mbikëqyrjen doganore, duke përdorur masa administrative në mënyrë proporcionale me nevojat ekonomike në fjalë.

4. Mbajtësi i autorizimit i mban regjistrimet e duhura në një formë të miratuar nga autoritetet doganore.

Regjistrimet duhet të përmbajnë informacionin dhe të dhënat që u mundësojnë autoriteteve doganore të mbikëqyrin operacionet në ambientet e magazinimit të përkohshëm dhe, në veçanti, për sa i përket identifikimit të mallrave të magazinuara, statusin e tyre doganor dhe të dhëna për lëvizjen e tyre.

Një operator ekonomik, i autorizuar për thjeshtësi doganore, konsiderohet se përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë pikë, kur ai mban regjistrimet e duhura për përdorimin e një magazine të përkohshme.

5. Autoritetet doganore mund të autorizojnë mbajtësin e autorizimit të lëvizë mallrat në magazinim të përkohshëm nga një ambient magazinimi i përkohshëm në një tjetër, me kusht që kjo lëvizje të mos rritë rezikun për mashtrim, si më poshtë:

a) një lëvizje e tillë zhvillohet nën përgjegjësinë e një autoriteti doganor;

b) kjo lëvizje mbulohet nga një autorizim i vetëm, i lëshuar për një operator ekonomik të autorizuar për thjeshtësi doganore; ose

c) në raste të tjera lëvizjeje.

6. Autoritetet doganore, kur ekziston një nevojë ekonomike dhe nuk pengohet mbikëqyrja doganore, mund të autorizojnë magazinimin e mallrave shqiptare në një ambient magazinimi të përkohshëm. Këto mallra nuk konsiderohen si mallra në magazinim të përkohshëm.

Neni 139

Përfundimi i magazinimit të përkohshëm

Mallrat joshqiptare në magazinim të përkohshëm vendosen nën një regjim doganor ose rieksportohen brenda 90 ditëve.

Neni 140

Zgjedhja e regjimit doganor

Përveçse kur parashikohet ndryshe, deklaruesi është i lirë të zgjedhë regjimin doganor, nën të cilin do të vendosë mallrat me kushtet e atij regjimi, pavarësisht nga lloji dhe sasia e mallrave ose vendi i tyre i origjinës, i nisjes a i destinacionit.

Neni 141

Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kushtet për miratimin e vendeve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 137;

b) kushtet për dhënien e autorizimit për përdorimin e ambienteve të magazinimit të përkohshëm, sipas përcaktimeve të nenit 138;

c) rastet e lëvizjes, të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 5, të nenit 138;

ç) rregullat procedurale për depozitimin e deklaratës së magazinimit të përkohshëm, të përcaktuara në nenin 135;

d) rregullat procedurale për ndryshimin e deklaratës së magazinimit të përkohshëm, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 136;

dh) rregullat procedurale për anulimin e deklaratës së magazinimit të përkohshëm, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 136;

e) rregullat procedurale për lëvizjen e përcaktuar në pikën 5, të nenit 138.

TITULLI V
RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR STATUSIN DOGANOR,VENDOSJA E MALLRAVE NËN NJË REGJIM DOGANOR, VERIFIKIMI, ÇLIRIMI DHE TJETËRSIMI/SHKATËRRIMI I MALLRAVE

KREU I
STATUSI DOGANOR I MALLRAVE

Neni 142
Prezumimi i statusit doganor të mallrave shqiptare

1. Të gjitha mallrat, që gjenden në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, prezumohen të kenë statusin doganor të mallrave shqiptare, përveçse kur përcaktohet që ato janë mallra joshqiptare.

2. Në disa raste, prezumimi i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, nuk aplikohet dhe statusi doganor i mallrave shqiptare duhet të provohet.

3. Në disa raste, mallrat tërësisht të përftuara në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nuk kanë statusin doganor të mallrave shqiptare nëse ato janë përftuar nga mallra të vendosura në magazinim të përkohshëm ose të vëna nën regjimin e transitit të jashtëm, nën një regjim magazinimi, regjim lejimi të përkohshëm apo regjim përpunimi aktiv.

Neni 143
Humbja e statusit doganor të mallrave shqiptare

Mallrat shqiptare bëhen mallra joshqiptare në rastet e mëposhtme:

a) kur ato dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, për aq kohë sa nuk zbatohen rregullat për transitin e brendshëm;

b) kur ato janë vendosur në regjimin e transitit të jashtëm, në regjimin e magazinimit ose regjimin e përpunimit aktiv, për aq sa e lejon legjislacioni doganor;

c) kur ato janë vendosur nën një regjim përdorimi të veçantë përfundimtar (end-use) dhe më pas janë braktisuar në favor të shtetit ose shkatërrohen duke lënë mbetje;

ç) kur deklarata doganore për çlirimin e mallrave për qarkullim të lirë anulohet pas çlirimit të mallrave.

Neni 144
Mallrat shqiptare që lënë përkohësisht territorin doganor të Republikës së Shqipërisë

1. Në rastet e përcaktuara në shkronjat “b” deri në “d”, të pikës 2, të nenit 204, mallrat mbajnë statusin e tyre doganor si mallra shqiptare vetëm nëse ky status është përcaktuar nën kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga legjislacioni doganor.

2. Në raste të veçanta mallrat shqiptare mund të lëvizin, pa qenë objekt i një regjimi doganor, nga një pikë në një pikë tjetër, të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke lënë përkohësisht këtë territor pa ndryshuar statusin e tyre doganor.

Neni 145
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet kur prezumimi i parashikuar në pikën 1, të nenit 142, nuk zbatohet;

b) kushtet për dhënien e lehtësive, në lidhje me depozitimin e provave për të vërtetuar statusin doganor të mallrave shqiptare;

c) rastet kur mallrat e përcaktuara në pikën 3, të nenit 142, nuk kanë statusin doganor të mallrave shqiptare;

ç) rastet kur statusi doganor i mallrave, të përcaktuara pikën 2, të nenit 144, nuk ndryshon;

d) rregullat procedurale për depozitimin dhe verifikimin e provës së statusit doganor të mallrave shqiptare.

KREU II
VENDOSJA E MALLRAVE NËN NJË REGJIM DOGANOR

SEKSIONI 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 146
Deklarata doganore e mallrave dhe mbikëqyrja doganore e mallrave shqiptare

1. Të gjitha mallrat e destinuara për t’u vendosur nën një regjim doganor, me përjashtim të regjimit të zonës së lirë, mbulohen nga deklarata doganore e duhur për regjimin përkatës.

2. Në raste të veçanta, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të nenit 17, një deklaratë doganore mund të depozitohet, duke përdorur mënyra të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave.

3. Mallrat shqiptare, të deklaruara për eksport, transit të brendshëm ose përpunim pasiv, janë objekt i mbikëqyrjes doganore që nga momenti i pranimit të deklaratës së përmendur në pikën 1 deri në momentin që ato dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë ose, kur janë braktisur në favor të shtetit, shkatërrohen apo deklarata doganore anulohet.

Neni 147
Zyrat doganore kompetente

1. Këshilli i Ministrave përcakton vendndodhjen dhe kompetencat e zyrave të ndryshme doganore të vendosura në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Zyra doganore kompetente për vendosjen e mallrave në një regjim doganor është zyra doganore përgjegjëse për vendin ku mallrat paraqiten në doganë, përveç rasteve të parashikuara ndryshe.

Neni 148
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet kur një deklaratë doganore mund të depozitohet duke përdorur mënyra të ndryshme nga teknikat informatike të përpunimit të të dhënave, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 146;

b) rastet dhe rregullat procedurale për përcaktimin e zyrave doganore, të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 2, të nenit 147, përfshirë zyrat doganore të hyrjes dhe zyrat doganore të daljes;

c) rregullat procedurale për depozitimin e deklaratës doganore për rastet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 146.

SEKSIONI 2
DEKLARATAT DOGANORE STANDARDE

Neni 149
Përmbajtja e një deklarate doganore standarde

Deklarata doganore standarde duhet të përmbajë të gjitha të dhënat e nevojshme për zbatimin e dispozitave që rregullojnë regjimin doganor, në të cilin mallrat janë deklaruar.

Neni 150
Dokumentet shoqëruese

1. Dokumentet shoqëruese, të kërkuara për zbatimin e dispozitave që rregullojnë regjimin doganor, për të cilin janë deklaruar mallrat, duhet të posedohen nga deklaruesi dhe t'u vihen në dispozicion autoriteteve doganore në momentin kur depozitohet deklarata.

2. Dokumentet shoqëruese u vihen në dispozicion autoriteteve doganore kur kërkohet nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë ose kur është e nevojshme për qëllime të kontrolleve doganore.

3. Në raste të veçanta, operatorët ekonomikë mund të hartojnë dokumentet shoqëruese, me kusht që të jenë të autorizuar nga autoritetet doganore për këtë qëllim.

Neni 151
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rregullat për dhënien e autorizimit të përcaktuar në pikën 3, të nenit 150;

b) rregullat procedurale për depozitimin e deklaratës standarde, sipas përcaktimeve të nenit 149;

c) rregullat për procedurat e dhënies së dokumenteve shoqëruese, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 150.

SEKSIONI 3
DEKLARATAT DOGANORE TË THJESHTUARA

Neni 152
Deklarata e thjeshtuar

1. Autoritetet doganore mund të pranojnë që një person të vendosë mallrat në një regjim doganor, në bazë të një deklarate të thjeshtuar, e cila mund të anashkalojë paraqitjen e disa të dhënave, sipas përcaktimeve të nenit 149 ose të dokumenteve shoqëruese, sipas përcaktimeve të nenit 150.

2. Përdorimi i vazhdueshëm i deklaratës së thjeshtuar, të përcaktuar në pikën 1, është objekt i lëshimit të një autorizimi nga autoritetet doganore.

Neni 153
Deklarata plotësuese

1. Në rastin e një deklarate të thjeshtuar, sipas përcaktimeve të nenit 152, ose në rastet e hyrjes në regjistrimet e deklaruesit, sipas përcaktimeve të nenit 165, deklaruesi depoziton në zyrën doganore kompetente, brenda një afati të caktuar, një deklaratë plotësuese, e cila përmban të dhënat e nevojshme për regjimin doganor përkatës.

Në rastin e një deklarate të thjeshtuar sipas përcaktimeve të nenit 152, dokumentet shoqëruese të nevojshme janë në posedim të deklaruesit dhe në dispozicion të autoriteteve doganore brenda një afati kohor të caktuar.

Deklarata plotësuese mund të jetë e një natyre të përgjithshme, periodike apo përmbledhëse.

2. Nuk është i detyrueshëm depozitimi i deklaratës plotësuese në rastet e mëposhtme:

a) kur mallrat vendosen nën regjimin e magazinës doganore;

b) në raste të tjera të veçanta.

3. Autoritetet doganore mund të mos kërkojnë depozitimin e një deklarate plotësuese kur zbatohen kushtet e mëposhtme:

a) deklarata plotësuese ka të bëjë me mallra, vlera dhe sasia e të cilave është poshtë nivelit të dërgesave me vlerë të papërfillshme, të përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 3, të nenit 184.

b) deklarata e thjeshtuar i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për regjimin doganor në fjalë; dhe

c) deklarata e thjeshtuar nuk është bërë me anë të hyrjes në regjistrimet e deklaruesit.

4. deklarata e thjeshtuar, referuar nenit 152, ose hyrja në regjistrimet e deklaruesit, sipas përcaktimeve të nenit

165, dhe deklarata plotësuese konsiderohen që përbëjnë një akt të vetëm e të pandashëm që i shtrin efektet, respektivisht, në datën kur deklarata e thjeshtuar është pranuar sipas përcaktimeve të nenit 157 dhe në datën, në të cilën mallrat janë regjistruar në regjistrat e deklaruesit.

5. Për qëllime të nenit 82, vendi, ku duhet të depozitohet deklarata plotësuese, është vendi ku është depozituar deklarata doganore.

Neni 154
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kushtet për dhënien e autorizimeve, të përcaktuara në nenin 152;

b) afatet kohore, të përmendura në paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 153, brenda të cilave depozitohet deklarata plotësuese;

c) afatet kohore, të përmendura në paragrafin e dytë, të pikës 1, të nenit 153, brenda të cilave dokumentet shoqëruese duhet të jenë në posedim të deklaruesit;

ç) rastet e veçanta kur, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 153, depozitimi i deklaratës plotësuese nuk është i detyrueshëm;

d) rregullat procedurale për depozitimin e deklaratës së thjeshtuar, përcaktuar në nenin152;

dh) rregullat procedurale për depozitimin e deklaratës plotësuese, të përcaktuar në nenin 153.

SEKSIONI 4
DISPOZITA TË ZBATUESHME PËR TË GJITHA DEKLARATAT DOGANORE

Neni 155
Depozitimi i deklaratës doganore

1. Pa rënë ndesh me pikën 1, të nenit 153, një deklaratë doganore mund të depozitohet nga çdo person, në kuptim të këtij Kodi, që mund të paraqesë të gjitha dokumentet, të cilat kërkohen për zbatimin e dispozitave që rregullojnë regjimin doganor, në të cilin janë deklaruar mallrat. Ky person duhet të jetë gjithashtu i aftë të paraqesë mallrat në fjalë ose të bëjë të mundur paraqitjen e tyre në doganë.

Megjithatë, kur pranimi i një deklarate doganore imponon detyrime të posaçme mbi një person të veçantë, kjo deklaratë bëhet nga ai person apo nga përfaqësuesi i tij.

2. Deklaruesi duhet të jetë i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. Përjashtimisht nga sa është parashikuar në pikën 2, për deklaruesit e mëposhtëm nuk kërkohet të jenë të vendosur brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë:

a) personat, të cilët depozitojnë një deklaratë doganore transiti apo lejimi të përkohshëm;

b) personat, të cilët depozitojnë në mënyrë rastësore një deklaratë doganore, përfshirë deklaratat për përdorimin e veçantë përfundimtar (end–use) ose përpunim aktiv, me kusht që autoritetet doganore ta konsiderojnë këtë deklarim të justifikuar;

c) personat që janë të vendosur në një vend kufitar me territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që prezantojnë mallra në një doganë kufitare me vendin kufitar të sipërpërmendur, me kusht që ai vend, në të cilin janë vendosur personat, u jep përfitime reciproke personave të vendosur në Republikën e Shqipërisë.

4. Deklarata doganore duhet të autentifikohet nga vetë personi.

Neni 156
Depozitimi i një deklarate doganore përpara paraqitjes së mallrave

Një deklaratë doganore mund të depozitohet përpara paraqitjes së pritshme të mallrave në doganë. Në qoftë se mallrat nuk paraqiten brenda 30 ditëve nga dita e depozitimit të deklaratës, deklarata doganore konsiderohet sikur të mos ishte depozituar.

Neni 157
Pranimi i një deklarate doganore

1. Deklaratat doganore, të cilat përmbushin kushtet e përcaktuara në këtë kre, pranohen menjëherë nga autoritetet doganore, me kusht që mallrat, të cilave ato u referohen, të jenë paraqitur në doganë.

2. Data e pranimit të deklaratës doganore nga autoritetet doganore, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, është data që do të përdoret për zbatimin e dispozitave që rregullojnë regjimin doganor, në të cilin mallrat janë deklaruar dhe për të gjitha formalitetet e tjera të importit apo eksportit.

Neni 158
Ndryshimi i një deklarate doganore

1. Deklaruesi, përmes një aplikimi, lejohet të ndryshojë një apo më shumë të dhëna të deklaratës doganore pasi deklarata doganore është pranuar nga dogana. Ndryshimi nuk duhet ta bëjë deklaratën doganore të zbatueshme për mallra, të ndryshme nga ato që janë deklaruar në fillim.

2. Asnjë ndryshim i tillë nuk mund të lejohet kur aplikimi është bërë pasi autoritetet doganore:

a) kanë informuar deklaruesin që mallrat do të kontrollohen;

b) kanë informuar deklaruesin që të dhënat e deklaratës doganore do të kontrollohen;

c) kanë çliruar mallrat.

3. Me aplikim nga deklaruesi, brenda tre vjetëve nga data e pranimit të deklaratës doganore, mund të lejohet ndryshimi i deklaratës doganore pas çlirimit të mallrave,

me qëllim që deklaruesi të përmbushë detyrimet e tij të lidhura me vënien e mallrave nën regjimin doganor në fjalë.

Neni 159
Anulimi i një deklarate doganore

1. Autoritetet doganore, në bazë të aplikimit nga deklaruesi, anulojnë një deklaratë doganore, tashmë të pranuar, në rastet e mëposhtme:

a) kur ato vlerësojnë se mallrat do të vendosen menjëherë në një regjim tjetër doganor;

b) kur ato vlerësojnë se, si rezultat i rrethanave të veçanta, vendosja e mallrave nën regjimin doganor, në të cilin ishin deklaruar, nuk është më e justifikuar.

Megjithatë, kur autoritetet doganore kanë informuar deklaruesin që mallrat do të kontrollohen, aplikimi për anulimin e deklaratës doganore nuk pranohet përpara se të jetë kryer kontrolli.

2. Deklarata doganore nuk anulohet pasi mallrat janë çliruar, përveçse kur parashikohet ndryshe.

Neni 160
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet kur një deklaratë doganore anulohet pas çlirimit të mallrave, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 159;

b) rregullat procedurale për depozitimin e deklaratës doganore, sipas përcaktimeve të nenit 156;

c) rregullat procedurale për pranimin e një deklarate doganore, sipas përcaktimeve të nenit 157, përfshirë dhe zbatimin e rregullave për rastet e parashikuara në nenin 163;

ç) rregullat procedurale për ndryshimin e deklaratës doganore pas çlirimit të mallrave, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 158.

SEKSIONI 5
THJESHTËSIME TË TJERA

Neni 161
Thjeshtësimi i përpilimit të deklaratës doganore për mallrat që klasifikohen në kode të ndryshme tarifore

1. Kur një ngarkesë është e përbërë nga mallra, që u përkasin nënkrerëve të ndryshëm tariforë, dhe përpilimi i deklaratës doganore për secilin prej këtyre mallrave, sipas nënkrerëve të tyre tariforë, do të kërkonte punë dhe shpenzime në shpërpjesëtim me detyrimet e importit dhe eksportit për t'u paguar, autoritetet doganore, në bazë të një aplikimi nga deklaruesi, mund të bien dakord që detyrimet doganore në import dhe eksport të aplikohen mbi të gjithë ngarkesën, bazuar në nënkreun tarifor të mallit, i cili ka nivelin tarifor më të lartë të detyrimit doganor në import apo eksport.

2. Autoritetet doganore refuzojnë përdorimin e thjeshtësimit të përcaktuar në pikën 1 për mallra që janë objekt i ndalimeve ose kufizimeve ose i detyrimeve të akcizës kur kërkohet klasifikimi korrekt, me qëllim zbatimin e masës.

Neni 162
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen nënkrerët tariforë për zbatimin e pikës 1, të nenit 161.

Neni 163
Zhdoganimi i centralizuar

1. Autoritetet doganore, kundrejt një aplikimi, mund të autorizojnë një person të depozitojë, në zyrën doganore përgjegjëse për vendin ku është vendosur personi, një deklaratë doganore për mallrat, të cilat janë paraqitur në një zyrë tjetër doganore.

Kërkesa për autorizim nuk kërkohet kur deklarata doganore është depozituar dhe mallrat paraqiten në zyrën doganore nën përgjegjësinë e një autoriteti të vetëm doganor.

2. Aplikuesi për autorizimin e parashikuar në pikën 1 është një operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësi doganore.

3. Zyra doganore, në të cilën është depozituar deklarata:

a) mbikëqyr vendosjen e mallrave nën regjimin doganor në fjalë;

b) kryen kontrollet doganore për verifikimin e deklaratës doganore, sipas përcaktimeve të shkronjave "a" dhe "b", të nenit 169;

c) kur është e nevojshme, kërkon që zyra doganore, në të cilën janë paraqitur mallrat, të kryejë kontrollet doganore për verifikimin e deklaratës doganore, të përcaktuar në shkronjat "c" dhe "ç", të nenit 169;

ç) kryen formalitetet për vjeljen e shumës së detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon çdo borxhi doganor.

4. Zyra doganore, në të cilën është depozituar deklarata doganore dhe zyra doganore, në të cilën prezantohen mallrat, shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për verifikimin e deklaratës doganore dhe për çlirimin e mallrave.

5. Zyra doganore, në të cilën janë paraqitur mallrat, pa cenuar kontrollet e saj të lidhura me mallrat e hyra në/ose të dala nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, kryen kontrollet doganore, të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 3, dhe i njofton zyrës doganore, në të cilën është depozituar deklarata doganore, rezultatet e kontrollit.

6. Zyra doganore, në të cilën depozitohet deklarata doganore, çliron mallrat në përputhje me nenin 175 dhe 176, duke marrë në konsideratë:

a) rezultatet e kontrolleve të saj për verifikimin e deklaratës doganore;

b) rezultatet e kontrolleve të kryera nga zyra doganore, në të cilën janë prezantuar mallrat, për verifikimin e deklaratës doganore dhe të kontrolleve që lidhen me mallrat e hyra në/ose të dala nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Neni 164
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kushtet për dhënien e autorizimit të përcaktuar në paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 163;

b) rregullat procedurale në lidhje me zhdoganimin e centralizuar, përfshirë dhe formalitetet doganore e kontrollet, sipas përcaktimeve të nenit 163;

c) rregullat procedurale në lidhje me përjashtimin nga detyrimi i paraqitjes së mallrave, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 165, në kuadër të zhdoganimit të centralizuar.

Neni 165
Hyrja në regjistrimet e deklaruesit

1. Autoritetet doganore, përkundrejt një aplikimi, mund të autorizojnë një person të depozitojë një deklaratë doganore, përfshirë një deklaratë të thjeshtuar, në formën e një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit, me kusht që këto të dhëna të jenë në dispozicion të autoriteteve doganore në kohën kur depozitohet deklarata doganore në formën e një hyrjeje në sistemin elektronik të deklaruesit.

2. Deklarata doganore konsiderohet e pranuar në momentin, në të cilin mallrat janë regjistruar në regjistrat elektronikë.

3. Autoritetet doganore, përkundrejt një aplikimi, mund të përjashtojnë deklaruesin nga detyrimi për të paraqitur mallrat.

Përjashtimi nga detyrimi jepet kur të gjitha kushtet e mëposhtme plotësohen:

a) deklaruesi është një operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësi doganore;

b) lloji dhe fluksi i mallrave në fjalë e justifikojnë dhe kur autoritetet doganore janë në dijeni;

c) zyra doganore mbikëqyrëse ka akses në gjithë informacionin që ajo konsideron të nevojshëm për të siguruar ushtrimin e së drejtës së saj për të verifikuar mallrat, nëse lind nevoja;

ç) në momentin e regjistrimit, mallrat nuk janë më objekt i ndalimeve dhe kufizimeve, përveçse kur parashikohet ndryshe në autorizim.

Megjithatë, zyra doganore mbikëqyrëse, në rrethana të veçanta, mund të kërkojë që mallrat të paraqiten në doganë.

4. Kushtet, nën të cilat çlirimi i mallrave është i lejuar, përcaktohen në autorizim.

Neni 166
Aktet zbatuese

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kushtet për dhënien e autorizimit, sipas pikës 1, të nenit 165;

b) rregullat procedurale për hyrjen në regjistrimet e deklaruesit, sipas përcaktimeve të nenit 165, përfshirë dhe formalitetet dhe kontrollet doganore përkatëse.

c) rrethanat e veçanta, në të cilat kërkohen që mallrat të paraqiten në doganë, sipas përcaktimit të paragrafit 3, të pikës 3, të nenit 165.

Neni 167
Vetëvlerësimi

1. Autoritetet doganore, përkundrejt një aplikimi, mund të autorizojnë një operator ekonomik të kryejë disa formalitete doganore, që normalisht kryhen nga autoritetet doganore, të përcaktojnë shumën e detyrimeve të importit dhe eksportit për t'u paguar dhe të kryejnë disa kontrolle nën mbikëqyrjen doganore.

2. Aplikuesi për autorizim, sipas pikës 1, është një operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësi doganore.

Neni 168
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kushtet për dhënien e autorizimit, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 167;

b) formalitetet doganore dhe kontrollet që do të kryhen nga mbajtësi i autorizimit, sipas përcaktimeve të nenit 167;

c) rregullat procedurale në lidhje me formalitetet dhe kontrollet doganore që kryhen nga mbajtësi i autorizimit, në përputhje me pikën 1, të nenit 167.

KREU III
VERIFIKIMI DHE ÇLIRIMI I MALLRAVE

SEKSIONI 1
VERIFIKIMI

Neni 169
Verifikimi i një deklarate doganore

Autoritetet doganore, me qëllim verifikimin e saktësisë së të dhënave që përmban një deklarate doganore tashmë e pranuar, mund:

a) të verifikojnë deklaratën dhe dokumentet shoqëruese;

b) t'i kërkojnë deklaruesit të paraqesë dokumente të tjera;

c) të verifikojnë mallrat;

ç) të marrin mostra për analiza apo verifikim të detajuar të mallrave.

Neni 170
Verifikimi i mallrave dhe marrja e mostrave

1. Transportimi i mallrave në vendet, ku ato do të verifikohen dhe do të merren mostra dhe ku do të kryhen të gjitha veprimet e nevojshme për verifikime të tilla ose për marrjen e mostrave, kryhet nga deklaruesi ose nën përgjegjësinë e tij. Kostot mbulohen nga deklaruesi.

2. Deklaruesi ka të drejtë të jetë i pranishëm apo të përfaqësohet kur verifikohen mallrat dhe kur merren mostrat. Kur autoritetet doganore kanë motive të arsyeshme për t'i kryer këto veprime, ato mund të kërkojnë që deklaruesi të jetë i pranishëm apo të përfaqësohet kur verifikohen mallrat dhe kur merren mostrat apo t'u sigurojnë atyre asistencën e nevojshme për lehtësimin e verifikimit apo në marrjen e mostrave.

3. Nëse mostrat janë marrë në përputhje me dispozitat në fuqi, autoritetet doganore nuk janë përgjegjëse për pagesën e ndonjë kompensimi në lidhje me mostrat, por përballojnë kostot e analizave apo kontrolleve të tyre.

Neni 171
Verifikimi i pjesshëm i mallrave dhe marrja e mostrave

1. Kur verifikohet ose kur merren mostra vetëm për një pjesë të mallrave të mbuluara nga një deklaratë doganore, rezultatet e verifikimit të pjesshëm apo të analizave a të kontrollit të mostrave vlejnë për të gjitha mallrat e mbuluara nga e njëjta deklaratë.

Megjithatë, deklaruesi mund të kërkojë një verifikim të mëtejshëm të mallrave ose marrje mostrash të tjera nëse ai e konsideron rezultatin e verifikimit të pjesshëm apo të analizave a të kontrollit të mostrave të marra si jo të vlefshëm për pjesën e mbetur të mallrave të deklaruara. Kërkesa pranohet me kusht që mallrat të mos jenë çliruar ende apo, nëse ato janë çliruar, deklaruesi provon që ato nuk kanë pësuar asnjë ndryshim.

2. Për qëllime të pikës 1, kur një deklaratë doganore mbulon dy ose më shumë artikuj, të dhënat për secilin artikull konsiderohen sikur përbëjnë deklarata të veçanta doganore.

Neni 172
Rezultatet e verifikimit

1. Rezultatet e verifikimit të deklaratës doganore përdoren për zbatimin e dispozitave që rregullojnë regjimin doganor, nën të cilën janë vendosur mallrat.

2. Nëse deklarata doganore nuk është verifikuar, pika 1 zbatohet duke u bazuar në të dhënat e deklaratës.

Neni 173
Masat identifikuese

1. Autoritetet doganore ose, kur shihet si e arsyeshme, operatorët ekonomikë që autorizohen nga autoritetet doganore për të vepruar kështu, marrin masat e nevojshme për të identifikuar mallrat, kur identifikimi i tyre kërkohet me qëllim që të sigurojë përputhjen me dispozitat që rregullojnë regjimin doganor nën të cilën mallrat janë deklaruar

2. Mjetet identifikuese të vendosura në mallra, paketime ose mjete transporti hiqen apo prishen vetëm nga autoritetet doganore ose, kur janë të autorizuar nga autoritetet doganore për të vepruar kështu, nga operatorët ekonomikë, vetëm nëse, si rrjedhojë e rrethanave të paparashikuara apo një force madhore, heqja apo shkatërrimi i tyre është i domosdoshëm për të siguruar ruajtjen e mallrave apo mjeteve të transportit.

Neni 174
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen masat për:

a) verifikimin e deklaratës doganore, verifikimin e mallrave dhe marrjen e mostrave dhe rezultatet e verifikimit;

b) rastet kur operatorët ekonomikë që autorizohen të kryejnë identifikimin e mallrave, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 173.

SEKSIONI 2
ÇLIRIMI I MALLRAVE

Neni 175
Çlirimi i mallrave nga autoritetet doganore

1. Kur kushtet për vendosjen e mallrave nën një regjim të caktuar janë përmbushur dhe me kusht që çdo kufizim të jetë zbatuar e që mallrat të mos jenë objekt i ndonjë ndalimi, autoritetet doganore i çlirojnë mallrat sapo të dhënat e deklaratës doganore të jenë verifikuar ose të jenë pranuar pa verifikim.

Paragrafi i mësipërm gjithashtu zbatohet kur verifikimi, sipas përcaktimeve të nenit 169, nuk mund të përfundojë brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe për mallrat nuk kërkohet që të jenë të pranishme për qëllime verifikimi.

2. Të gjitha mallrat e mbuluara nga e njëjta deklaratë çlirohen në të njëjtën kohë.

Për qëllime të paragrafit të parë, të kësaj pike, kur një deklaratë doganore mbulon mallra që klasifikohen nën dy apo më shumë nënkrerë tariforë, të dhënat e lidhura me mallrat e çdo nënkreu tarifor konsiderohen sikur përbëjnë deklarata të veçanta doganore.

Neni 176
Çlirimi në varësi të pagesës së shumës së detyrimit të importit apo eksportit që i korrespondon borxhit doganor apo të depozitimit të një garancie

1. Kur nga vendosja e mallrave nën një regjim doganor lind një borxh doganor, çlirimi i mallrave kushtëzohet me pagesën e shumës së detyrimit të importit ose eksportit, që i korrespondon këtij borxhi doganor ose depozitimit të një garancie për të mbuluar këtë borxh.

Megjithatë, pa cenuar paragrafin e tretë, paragrafi i parë nuk zbatohet për lejimin e përkohshëm, me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit.

Kur, sipas dispozitave që rregullojnë regjimin doganor, nën të cilin mallrat janë deklaruar, autoritetet doganore kërkojnë depozitimin e një garancie, këto mallra nuk çlirohen për regjimin doganor në fjalë derisa kjo garanci të depozitohet.

2. Në raste të veçanta, për mallrat që janë objekt i një kërkese për përfitim nga një kontingjent tarifor, çlirimi i mallrave nuk kushtëzohet me depozitimin e një garancie.

3. Kur përdoret një thjeshtësim, sipas përcaktimeve të neneve 152, 165 dhe 167, dhe është depozituar një garanci globale, çlirimi i mallrave nuk kushtëzohet me mbikëqyrjen e garancisë nga autoritetet doganore.

Neni 177
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 176.

KREU IV
TJETËRSIMI/SHKATËRRIMI I MALLRAVE

Neni 178
Shkatërrimi i mallrave

Kur autoritetet doganore kanë motive të arsyeshme, ato mund të kërkojnë që mallrat, të cilat janë paraqitur në doganë, të shkatërrohen dhe të informojnë për këtë mbajtësin e mallrave. Kostot e shkatërrimit i ngarkohen mbajtësit të mallrave.

Neni 179
Masat që duhet të merren nga autoritetet doganore

1. Autoritetet doganore marrin çdo masë të nevojshme, përfshirë konfiskimin dhe shitjen ose shkatërrimin e mallrave, për të rregulluar situatën për këto mallra, në rastet e mëposhtme:

a) kur një nga detyrimet e përcaktuara në legjislacionin doganor për hyrjen e mallrave joshqiptare në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nuk është përmbushur ose mallrat i janë shmangur mbikëqyrjes doganore;

b) kur mallrat nuk mund të çlirohen për një nga arsyet e mëposhtme:

i) për arsye që i atribuohen deklaruesit, verifikimi i mallrave apo vazhdimi i verifikimit të tyre ka qenë i pamundur të kryhet brenda afatit të përcaktuar nga autoritetet doganore;

ii) nuk janë depozituar dokumentet që kushtëzojnë vendosjen e mallrave në një regjim doganor të kërkuar apo çlirimin prej tij;

iii) pagesa apo një garanci, e cila duhet të ishte bërë apo depozituar në lidhje me detyrimet e importit apo eksportit, sipas rastit, nuk është bërë apo depozituar brenda afatit të përcaktuar;

iv) mallrat u nënshtrohen masave ndaluese apo kufizuese;

c) kur mallrat nuk janë tërhequr nga ambientet e doganës, brenda një afati të arsyeshëm pas çlirimit të tyre;

ç) kur, pas çlirimit të tyre, konstatohet se mallrat nuk kanë plotësuar kushtet që justifikojnë këtë çlirim;

d) kur mallrat janë braktisur në favor të shtetit, sipas nenit 180.

2. Mallrat joshqiptare, të cilat janë braktisur në favor të shtetit, janë sekuestruar ose konfiskuar, konsiderohen si të vendosura nën regjimin e magazinimit të përkohshëm. Ato regjistrohen në regjistrat e operatorit të magazinës së përkohshme ose, kur ato mbahen nga autoritetet doganore, në regjistrat e këtyre të fundit.

Kur mallrat e destinuara për t'u shkatërruar, për t'u braktisur në favor të shtetit, për t'u sekuestruar ose për t'u konfiskuar, janë ndërkohë objekt i një deklarate doganore, regjistrimet duhet të përmbajnë një referencë të deklaratës doganore. Autoritetet doganore anulojnë deklaratën doganore.

3. Shpenzimet për masat e përcaktuara në pikën 1 i ngarkohen:

a) në rastin e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, çdo personi, të cilit i ishte kërkuar të plotësonte detyrimet në fjalë ose që ka shmangur mallrat nga mbikëqyrja doganore;

b) në rastin e përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, deklaruesit;

c) në rastin e përcaktuar në shkronjën "ç", të pikës 1, personit të cilit i ishte kërkuar të plotësonte kushtet që rregullojnë çlirimin e mallrave;

ç) në rastin e përcaktuar në shkronjën "d", të pikës 1, personit që braktis mallrat në favor të shtetit.

Neni 180
Braktisja e mallrave
(Heqja dorë nga posedimi ose pronësia)

Me miratim paraprak të autoriteteve doganore, mallrat joshqiptare dhe mallrat e vendosura nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use), mund të

braktisen në favor të shtetit nga mbajtësi i regjimit ose, kur është rasti, nga mbajtësi i mallrave.

Neni 181
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rregullat procedurale mbi shkatërrimin e mallrave, sipas përcaktimeve të nenit 178;

b) rregullat procedurale mbi shitjen e mallrave, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 179;

c) kushtet dhe rregullat procedurale mbi braktisjen e mallrave në favor të shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 180.

TITULLI VI
ÇLIRIMI PËR QARKULLIM TË LIRË DHE PËRJASHTIMI NGA DETYRIMET E IMPORTIT

KREU I
ÇLIRIMI PËR QARKULLIM TË LIRË

Neni 182
Fusha e zbatimit dhe efekti

1. Mallrat joshqiptare, të destinuara për tregun shqiptar ose të destinuara për përdorim apo konsum privat brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, çlirohen për qarkullim të lirë.

2. Çlirimi për qarkullim të lirë përfshin:

a) vjeljen e çdo detyrimi importi që duhet paguar;

b) vjeljen, kur është rasti, të pagesave të tjera, siç parashikohet në dispozitat përkatëse në fuqi për mbledhjen e këtyre pagesave;

c) zbatimin e masave të politikave tregtare, si dhe ndalimet e kufizimet, nëse këto nuk janë zbatuar më përpara;

ç) përmbushjen e formaliteteve të tjera, të parashikuara për importimin e mallrave.

Çlirimi për qarkullim të lirë u jep mallrave joshqiptare statusin doganor të mallrave shqiptare.

Neni 183
Masat e politikës tregtare

1. Kur produktet e përpunuara, të përftuara në kuadër të përpunimit aktiv, çlirohen për qarkullim të lirë dhe llogaritja e detyrimeve të importit bëhet në përputhje me pikën 3, të nenit 81, masa e politikës tregtare për t'u aplikuar është ajo që zbatohet për çlirimin për qarkullim të lirë për mallrat që ishin vendosur në regjimin e përpunimit aktiv.

2. Pika 1 nuk zbatohet për mbetjet dhe hedhurinat.

3. Kur produktet e përpunuara, të përftuara në kuadër të përpunimit aktiv, çlirohen për qarkullim të lirë dhe llogaritja e detyrimeve të importit bëhet në përputhje me pikën 1, të nenit 80, masa e politikës tregtare për t'u aplikuar është ajo që zbatohet për këto mallra vetëm nëse mallrat që ishin vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv janë objekt i këtyre masave.

4. Kur legjislacioni shqiptar parashikon masa të politikës tregtare për çlirimin për qarkullim të lirë, këto masa nuk aplikohen për produktet e përpunuara, të çliruara për qarkullim të lirë në vijim të përpunimit pasiv kur:

a) produktet e përpunuara ruajnë origjinën e tyre shqiptare, në kuptim të nenit 60;

b) përpunimi pasiv ka të bëjë me riparimin, përfshirë sistemin e shkëmbimit standard, parashikuar në nenin 234;

c) përpunimi pasiv është në vijim të operacioneve të mëtejshme të përpunimit, në përputhje me nenin 231.

KREU II
OPERACIONE TË PRIVILEGJUARA

SEKSIONI 1
PËRJASHTIME NGA DETYRIMI I IMPORTIT

Neni 184
Rastet e përjashtimeve dhe kushtet

1. Përjashtimi nga detyrimi i importit jepet në kuadër të:

a) misioneve diplomatike e konsullore, si dhe misioneve speciale të akredituara në Shqipëri, për të cilat parashikohet përjashtim, sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, të datës 18 prill 1961, Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, të datës 24 prill 1963, apo konventave të tjera konsullore dhe të Konventës së Nju Jorkut, të datës 16 dhjetor 1969, për misionet speciale;

b) marrëveshjeve, në bazë të parimit të reciprocitetit, me vendet e tjera që janë palë kontraktuese e Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar (Çikago, 1944).

2. Përjashtim nga detyrimi i importit jepet gjithashtu me ligj të veçantë dhe në çdo rast tjetër të parashikuar me marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, të nënshkruara nga Këshilli i Ministrave dhe të ratifikuara nga Kuvendi, për aq sa këto ligje apo marrëveshje e parashikojnë shprehimisht përjashtimin nga detyrimi i importit.

3. Përjashtime nga detyrimi i importit jepet edhe në rastet e:

a) sendeve vetjake që u përkasin individëve, që ndryshojnë vendqëndrimin (vendbanimin) nga një vend tjetër për në Republikën e Shqipërisë;

b) mallrave të importuara në raste martese;

c) sendeve personale të fituara nga trashëgimia;

ç) uniformave shkollore, materialeve të studimit dhe pajisjeve shtëpiake për përdorim nga nxënës e studentë;

d) dërgesave me vlerë të papërfillshme;

dh) dërgesave të dërguara falas nga një individ te një tjetër;

e) mjeteve kryesore të prodhimit dhe pajisjeve të tjera, të importuara gjatë transferimit të aktiviteteve nga një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë;

ë) produkteve të përftuara nga fermerët e Republikës së Shqipërisë në prona të vendosura në vende kufitare me Republikën e Shqipërisë;

f) farave, plehrave dhe produkteve për trajtimin e tokës dhe të të mbjellave, të importuara nga prodhuesit bujqësorë të vendeve të tjera për përdorim në pronat fqinje me këto vende;

g) mallrave që gjenden në bagazhin personal të udhëtarit;

gj) materialeve arsimore, shkencore dhe kulturore; instrumenteve dhe aparaturave shkencore;

h) kafshëve të laboratorit dhe lëndëve biologjike ose kimike që nevojiten për kërkime;

i) substancave terapeutike me origjinë njerëzore dhe reagjentëve për analizat e grupeve të gjakut dhe indeve;

j) instrumenteve dhe aparaturave të destinuara për kërkime mjekësore për përcaktimin e diagnozave mjekësore ose për kryerjen e trajtimeve mjekësore;

k) substancave referuese për kontrollin e cilësisë së produkteve mjekësore;

l) produkteve farmaceutike për t'u përdorur në veprimtari sportive ndërkombëtare;

ll) mallrave për organizata bamirësie ose filantropike; artikuj të destinuar për të verbrit dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara;

m) dekoratave apo çmimeve të nderit;

n) dhuratave të marra në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare;

nj) mallrave për t'u përdorur nga personalitetet e larta të shtetit;

o) mallrave të importuara, me qëllim nxitjen e tregtisë;

p) mallrave të importuara për qëllime ekzaminimi, analizash ose testi;

q) dërgesave për organizata që mbrojnë të drejtat e autorit ose të drejtat e patentës industriale dhe tregtare;

r) botimeve informuese me karakter turistik;

rr) dokumenteve dhe artikujve të ndryshëm;

s) materialeve të ndryshme, për të fiksuar dhe ruajtur mallrat gjatë transportimit të tyre;

sh) shtrojeve, foragjereve dhe ushqimeve që nevojiten gjatë transportit të kafshëve;

t) karburanteve dhe lubrifikantëve në depozitën e mjeteve motorike tokësore, si dhe në depozita për përdorim të veçantë;

th) materialeve për ndërtimin, mirëmbajtjen ose zbukurimin e përmendoreve apo të varrezave të viktimave të luftës;

u) arkivoleve, urnave funerale dhe artikujve dekorativë funeralë.

4. Ky nen zbatohet si për mallrat e deklaruara për herë të parë për qarkullim të lirë, ashtu edhe për mallrat e deklaruara për qarkullim të lirë, pasi kanë qenë objekt i një regjimi tjetër doganor.

5. Autoritetet doganore marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që mallrat e vendosura në qarkullim të lirë, me përjashtim nga detyrimi i importit, me kushtin e vendosjes së mallrave në një përdorim të përcaktuar nga marrësi, nuk lejohen të përdoren për qëllime të tjera, pa kryer më parë pagesën e detyrimit përkatës të importit, përveçse kur përdorimi i ndryshëm i mallrave përputhet me kushtet e përcaktuara në këtë nen.

6. Kur parashikohet që përjashtimi duhet t'i nënshtrohet plotësimit të kushteve të caktuara, personi që ka përfituar përjashtim duhet t'u paraqesë autoriteteve doganore prova që vërtetojnë plotësimin e këtyre kushteve.

7. Përjashtimisht nga sa është parashikuar në këtë nen, mund të zbatohen ndalime ose kufizime të justifikuara, për motive të tilla si, morali shoqëror, rendi ose siguria publike, mbrojtja e shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve apo bimëve, mbrojtja e pasurisë kombëtare që kanë vlerë artistike, historike ose arkeologjike, të mbrojtjes së pronësisë industriale ose tregtare.

8. Zbatimi i pikave 1-4 të këtij neni nuk përjashton kufizimet bazuar në parimin e reciprocitetit, kufizime në lloj, sasi apo vlerë malli a regjim doganor, sipas specifikave.

SEKSIONI 2
MALLRAT E RIKTHYERA

Neni 185
Fusha e zbatimit dhe efekti

1. Mallrat joshqiptare, të cilat, pasi fillimisht janë eksportuar si mallra shqiptare nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, rikthehen në këtë territor brenda një afati trevjeçar dhe deklarohen për në qarkullim të lirë, përmes aplikimit nga personi i interesuar, përfitojnë përjashtim nga detyrimet e importit.

Paragrafi i parë zbatohet edhe kur mallrat e rikthyera përbëjnë vetëm një pjesë të mallrave paraprakisht të eksportuara nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Afati prej tre vjetësh, i përmendur në pikën 1, mund të zgjatet, me qëllim marrjen në konsideratë të rrethanave të veçanta.

3. Kur, përpara eksportit të tyre nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, mallrat e rikthyera kishin qenë të çliruara për qarkullim të lirë me përjashtim ose me reduktim të detyrimeve të importit, për arsye të përdorimit të tyre të veçantë përfundimtar

(end-use), përjashtimi nga detyrimi, sipas pikës 1, jepet vetëm nëse ato çlirohen për qarkullim të lirë për të njëjtin përdorim të veçantë përfundimtar (end-use).

Kur përdorimi i veçantë përfundimtar (end-use), për të cilin mallrat në fjalë janë çliruar, nuk është më i njëjti, nga shuma e detyrimit të importit duhet të zbritet çdo shumë e mbledhur për mallrat kur ato ishin çliruar për qarkullim të lirë për herë të parë. Nëse shuma e fundit është më e madhe se shuma e detyrimit të çlirimit për qarkullim të lirë të mallrave të rikthyera, nuk jepet asnjë rimbursim.

4. Kur mallrat shqiptare e kanë humbur statusin e tyre doganor si mallra shqiptare, sipas përcaktimeve të nenit 143 dhe në vijim, janë çliruar për qarkullim të lirë, atëherë zbatohen pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni.

5. Përjashtimi nga detyrimet e importit jepet vetëm nëse mallrat janë riimportuar në gjendjen në të cilën ishin eksportuar.

6. Përjashtimi nga detyrimet e importit duhet të mbështetet me të dhëna që tregojnë se kushtet për përjashtim janë plotësuar.

Neni 186

Mallra që kanë përfituar nga masat e politikës bujqësore

Përjashtimi nga detyrimi i importit, i parashikuar në nenin 185, nuk jepet për mallrat, të cilat kanë përfituar nga masat e politikës bujqësore që përfshin eksportin e tyre jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, përveçse kur parashikohet ndryshe në raste të veçanta.

Neni 187

Mallrat e vendosura paraprakisht nën regjimin e përpunimit aktiv

1. Neni 185 zbatohet për produktet e përpunuara, të cilat fillimisht ishin rieksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, në vijim të një regjimi të përpunimit aktiv.

2. Me aplikim nga ana e deklaruesit dhe me kusht që ai të japë informacionin e nevojshëm, shuma e detyrimit të importit për mallrat e përmenduara në pikën 1, të këtij neni, përcaktohet në përputhje me pikën 3, të nenit 81. Data e pranimit të deklaratës së rieksportit konsiderohet si datë e çlirimit të mallrave për qarkullim të lirë.

3. Përjashtimi nga detyrimet e importit, i parashikuar në nenin 185, nuk jepet për produktet e përpunuara, të cilat ishin eksportuar në përputhje me shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 201, përveçse kur garantohet që asnjë mall i importuar nuk do të vendoset nën regjimin e përpunimit aktiv.

Neni 188

Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kushtet për të përfituar përjashtim nga detyrimi i importit dhe rregullat procedurale për dhënien e përjashtimeve, sipas përcaktimeve të pikave 1 deri në 3, të nenit 184;

b) mallrat që përfitojnë përjashtim nga detyrimi i importit, përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", "ç", "e", "ë", "f", "gj", "h", "i", "j", "ll", "m", "o", "r", "rr", "s" dhe "u", të pikës 3, të nenit 184;

c) mallrat që nuk përfitojnë përjashtim nga detyrimi i importit, të përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", "d", "dh", "e", "ll", "n" dhe "o", të pikës 3, të nenit 184;

ç) vlerat, sasitë limit, të përcaktuara në shkronjat "b", "d", "dh", "f", "g", "o" dhe "t", të pikës 3, të nenit 184;

d) rastet kur nuk jepet përjashtim nga detyrimi i importit për mallrat e deklaruara për qarkullim të lirë, pasi kanë qenë objekt i një regjimi tjetër doganor, sipas pikës 4, të nenit 184;

dh) rregullat procedurale për dhënien e përjashtimeve, sipas pikave 1 deri në 3, të nenit 184;

e) rastet kur mallrat konsiderohen që janë kthyer në gjendjen në të cilën ato ishin eksportuar;

ë) rastet e veçanta, sipas përcaktimeve të nenit 186;

f) rregullat procedurale për dhënien e informacionit, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 185.

SEKSIONI 3

PESHKIMI DETAR DHE PRODUKTET E NXJERRA NGA DETI

Neni 189

Produktet e peshkimit detar dhe produkte të tjera të nxjerra nga deti

1. Pa cenuar pikën 1, të nenit 60, përjashtohen nga detyrimet e importit, kur çlirohen për qarkullim të lirë:

a) produktet e peshkimit detar dhe produktet e tjera, të nxjerra nga ujërat territoriale detare të një vendi ose territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë vetëm nga anije të matrikuluara ose të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe që mbajnë flamurin shqiptar;

b) produktet e përftuara nga produktet e përcaktuara në shkronjën "a" në bordin e anijeve-fabrikë, që përmbushin kushtet e përcaktuara në këtë shkronjë.

2. Përjashtimi nga detyrimi i importit, i përcaktuar në pikën 1, duhet të mbështetet me prova që kushtet e parashikuara në këtë pikë janë plotësuar.

Neni 190
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat procedurale për provat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 189.

TITULLI VII
REGJIME TË POSAÇME

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 191
Fusha e zbatimit

Mallrat mund të vendosen nën një nga kategoritë e mëposhtme të regjimeve të posaçme:

a) transit, i cili përfshin transitin e jashtëm dhe të brendshëm;

b) magazinim, i cili përfshin magazinimin doganor dhe zonat e lira;

c) përdorimin e veçantë, i cili përfshin lejimin e përkohshëm dhe përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use);

ç) përpunim, i cili përfshin përpunimin aktiv dhe pasiv.

Neni 192
Autorizimi

1. Kërkohet autorizim nga autoritetet doganore për:

a) përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv ose pasiv, regjimin e lejimit të përkohshëm apo regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use);

b) përdorimin e ambienteve të magazinimit për magazinimin doganor të mallrave, përveçse kur operatori i ambientit të magazinimit është vetë autoriteti doganor.

Kushtet, nën të cilat lejohet përdorimi i një ose më shumë regjimeve të përcaktuara në paragrafin e parë ose përdorimi i ambienteve të magazinimit përcaktohen në autorizim.

2. Autoritetet doganore japin autorizimin me efekt prapaveprues kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) ekziston një nevojë ekonomike e provuar;

b) aplikimi nuk lidhet me ndonjë përpjekje për mashtrim;

c) aplikuesi ka provuar në bazë të kontabilitetit ose regjistrimeve që:

i) të gjitha kërkesat e regjimit janë plotësuar;

ii) kur është e mundur, mallrat mund të identifikohen për periudhën e përfshirë;

iii) kontabiliteti dhe regjistrimet lejojnë kontrollin e regjimit;

ç) mund të kryhen të gjitha formalitetet e nevojshme për rregullimin e situatës së mallrave, përfshirë, kur është e nevojshme, anulimin e deklaratës doganore në fjalë;

d) asnjë autorizim me efekt prapaveprues nuk i është dhënë aplikuesit brenda tre vjetëve nga data në të cilën është pranuar aplikimi;

dh) nuk kërkohet verifikimi i kushteve ekonomike, përveçse kur aplikimi ka të bëjë me rinovimin e një autorizimi për të njëjtin lloj operacionesh e mallrash;

e) aplikimi nuk lidhet me përdorimin e ambienteve të magazinimit për magazinimin doganor të mallrave;

ë) kur një aplikim ka të bëjë me rinovimin e një autorizimi për të njëjtin lloj operacionesh e mallrash, aplikimi duhet të dorëzohet brenda tre vjetëve nga skadimi i autorizimit origjinal.

Autoritetet doganore mund të japin një autorizim me efekt prapaveprues edhe kur mallrat, që ishin vendosur nën një regjim doganor, nuk janë më të disponueshme në momentin kur është pranuar aplikimi për një autorizim të tillë.

3. Përveçse kur parashikohet ndryshe, autorizimi i përcaktuar në pikën 1, u jepet vetëm personave që plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) janë të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) japin sigurinë e nevojshme për funksionimin siç duhet të operacioneve. Një operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësi doganore konsiderohet se e plotëson këtë kusht, nëse aktiviteti i lidhur me regjimin e posaçëm në fjalë është marrë në konsideratë në autorizimin e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 40;

c) kur mund të lindë një borxh doganor ose detyrime të tjera për mallra të vendosura nën një regjim të posaçëm, ata japin një garanci në përputhje me nenin 84;

ç) në rast të regjimit të lejimit të përkohshëm ose të regjimit të përpunimit aktiv, respektivisht, personave, që përdorin mallrat ose marrin përsipër përdorimin e tyre apo personave që kryejnë operacionet e përpunimit mbi mallrat ose marrin përsipër kryerjen e tyre.

4. Përveçse kur parashikohet ndryshe dhe në plotësim të pikës 3, autorizimi i përmendur në pikën 1 jepet vetëm kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kur autoritetet doganore janë në gjendje të ushtrojnë mbikëqyrjen doganore pa pasur nevojë marrjen e masave administrative në disproporcion me nevojat ekonomike në fjalë;

b) kur interesat thelbësorë të prodhuesve vendas nuk ndikohen negativisht nga një autorizim për një regjim përpunimi (kushtet ekonomike).

5. Interesat thelbësorë të prodhuesve vendas konsiderohen se nuk ndikohen negativisht, siç përcaktohet në shkronjën "b", të pikës 4, përveçse kur provohet ndryshe ose kur kushtet ekonomike konsiderohen si të përmbushura.

6. Afati i autorizimit për regjimin e përpunimit aktiv është deri në 5 vjet, në përputhje me llojin e aktivitetit të regjimit të përpunimit aktiv, vlefshmërinë dhe afatet kohore të kontratave me shoqëritë porositëse të lëndës së parë, me ciklet e prodhimit, etj

Neni 193
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kushtet për dhënien e autorizimeve për regjimet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 192;

b) përjashtimet nga kushtet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të nenit 192;

c) rastet, në të cilat kushtet ekonomike konsiderohen si të plotësuara, siç përcaktohet në pikën 5, të nenit 192.

Neni 194
Regjistrimet

1. Përveç regjimit të transitit ose kur parashikohet ndryshe, mbajtësi i autorizimit, mbajtësi i regjimit dhe të gjithë personat e tjerë që kryejnë një aktivitet që përfshin magazinim, punimin ose përpunimin e mallrave, apo shitjen a blerjen e mallrave në zona të lira, mbajnë regjistrimet e duhura në një formë të miratuar nga autoritetet doganore.

Regjistrimet përmbajnë informacione dhe të dhëna, të cilat u mundësojnë autoriteteve doganore të mbikëqyrin regjimet në fjalë, në veçanti lidhur me identifikimin e mallrave të vendosura nën atë regjim, statusin e tyre doganor dhe lëvizjet e tyre.

2. Një operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësi doganore konsiderohet sikur t'i ketë plotësuar detyrimet e përcaktuara në pikën 1, nëse regjistrimet e tij janë ato të duhurat për qëllime të regjimit të posaçëm në fjalë.

Neni 195
Mbyllja e një regjimi të posaçëm

1. Në raste të ndryshme nga regjimi i transitit dhe pa cenuar nenin 227, një regjim i posaçëm mbyllet kur mallrat e vendosura nën regjim ose produktet e përpunuara janë vendosur në një regjim doganor pasues, janë nxjerrë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose janë shkatërruar pa lënë asnjë mbetje a janë braktisur në favor të shtetit, në përputhje me nenin 180.

2. Regjimi i transitit mbyllet nga autoritetet doganore kur ato, duke u bazuar në krahasimin e të dhënave të disponueshme në zyrën doganore të nisjes dhe ato të disponueshme në zyrën doganore të destinacionit, janë në gjendje të përcaktojnë që regjimi është mbyllur në mënyrë korrekte.

3. Autoritetet doganore marrin të gjitha masat e nevojshme për rregullimin e situatës për mallrat, në lidhje me të cilat një regjim nuk është mbyllur sipas kushteve të përcaktuara.

4. Mbyllja e regjimit bëhet brenda afatit kohor të përcaktuar, përveçse kur parashikohet ndryshe.

Neni 196
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) afati kohor i përcaktuar në pikën 4, të nenit 195;

b) rregullat procedurale për mbylljen e një regjimi të posaçëm, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të këtij neni.

Neni 197
Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve

Të drejtat dhe detyrimet e mbajtësit të një regjimi, për sa u përket mallrave, të cilat janë vendosur nën një regjim të posaçëm të ndryshëm nga ai i transitit, mund të transferohen plotësisht ose pjesërisht te një person tjetër, i cili përmbush kushtet e përcaktuara për regjimin në fjalë.

Neni 198
Lëvizja e mallrave

Në raste të veçanta, mallrat e vendosura nën një regjim të posaçëm, të ndryshëm nga ai i transitit, ose në një zonë të lirë, mund të lëvizin ndërmjet dy vendeve të ndryshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 199
Format e zakonshme të trajtimit

Mallrat e vendosura nën magazinim doganor ose një regjim përpunimi apo në një zonë të lirë mund t'u nënshtrohen trajtimeve të zakonshme, që kanë për qëllim ruajtjen e tyre, përmirësimin e pamjes ose të cilësisë së tyre tregtare apo përgatitjen e tyre për shpërndarje ose rishitje.

Neni 200
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet dhe kushtet për lëvizjen e mallrave të vendosura nën një regjim të posaçëm, të ndryshëm nga ai i transitit ose të vendosura në një zonë të lirë, në përputhje me nenin 198;

b) format e zakonshme të trajtimit për mallrat e vendosura nën regjimin e magazinimit doganor ose në një regjim përpunimi a në një zonë të lirë, siç përcaktohet në nenin 199;

c) rregullat procedurale për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të mbajtësit të regjimit për sa u përket mallrave të vendosura nën një regjim të posaçëm, të ndryshëm nga ai i transitit, në përputhje me nenin 197;

ç) rregullat procedurale për lëvizjen e mallrave të vendosura në një regjim të posaçëm, të ndryshëm nga ai i transitit ose në një zonë të lirë, sipas përcaktimeve të nenit 198.

Neni 201
Mallrat ekuivalente

1. Termi "Mallrat ekuivalente" ka të bëjë me mallra shqiptare, të cilat janë magazinuar, përdorur ose përpunuar në vend të mallrave të vendosura nën një regjim të posaçëm.

Nën regjimin e përpunimit pasiv, mallrat ekuivalente kanë të bëjnë me mallra joshqiptare, të cilat përpunohen në vend të mallrave shqiptare, të vendosura nën regjimin e përpunimit pasiv.

Përveçse kur parashikohet ndryshe, mallrat ekuivalente duhet të kenë të njëjtin kod tetëshifror të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, të njëjtat cilësi tregtare dhe të njëjtat karakteristika teknike si mallrat që zëvendësojnë.

2. Autoritetet doganore, përmes aplikimit dhe me kusht që të sigurohet zbatimi korrekt i regjimit, në veçanti për sa i përket mbikëqyrjes doganore, autorizojnë:

a) përdorimin e mallrave ekuivalente nën një regjim magazinimi doganor, zonë të lirë, përdorim të veçantë përfundimtar (end-use) dhe një regjim përpunimi;

b) përdorimin e mallrave ekuivalente nën regjimin e lejimit të përkohshëm, në raste të veçanta;

c) në rast të regjimit të përpunimit aktiv, eksportimin e produkteve të përpunuara, të përftuara nga mallrat ekuivalente përpara importimit të mallrave që ato zëvendësojnë;

ç) në rast të regjimit të përpunimit pasiv, importimin e produkteve të përpunuara, të përftuara nga mallrat ekuivalente përpara eksportimit të mallrave që ato zëvendësojnë.

Një operator ekonomik i autorizuar për thjeshtësi doganore konsiderohet sikur e plotëson kushtin që është siguruar zbatimi korrekt i regjimit për sa kohë që aktiviteti, që i përket përdorimit të mallrave ekuivalente për regjimin në fjalë, është marrë në konsideratë kur është lëshuar autorizimi i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 40.

3. Përdorimi i mallrave ekuivalente nuk autorizohet në asnjë prej rasteve të mëposhtme:

a) kur, nën regjimin e përpunimit aktiv, kryhen vetëm format e zakonshme të trajtimit, të përcaktuara në nenin 199;

b) kur ndalohet rimbursimi i detyrimeve të importit ose përjashtimi nga detyrimet e importit për mallrat joorigjinuese, të përdorura në prodhimin e produkteve të përpunuara nën regjimin e përpunimit aktiv, për të cilat është lëshuar një provë e origjinës në kuadrin e një marrëveshjeje preferenciale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve ose territoreve të caktuara jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose grupeve të vendeve ose territoreve të tilla;

c) kur çon në një avantazh të pajustifikuar të detyrimit të importit ose kur parashikohet me ligj.

4. Në rastin e përmendur në shkronjën "c", të pikës 2, të këtij neni, dhe kur produktet e përpunuara i nënshtrohen detyrimit të eksportit, nëse ato nuk do të ishin eksportuar në kontekst të regjimit të përpunimit aktiv, mbajtësi i autorizimit depoziton një garanci për të siguruar pagesën e detyrimit, nëse mallrat joshqiptare nuk importohen brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të nenit 230.

Neni 202
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) përjashtimet nga paragrafi i tretë, i pikës 1, të nenit 201;

b) kushtet, nën të cilat përdoren mallrat ekuivalente, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 201;

c) rastet e veçanta kur mallrat ekuivalente përdoren nën regjimin e lejimit të përkohshëm, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 201;

ç) rastet kur përdorimi i mallrave ekuivalente nuk autorizohet, në përputhje me shkronjën "c", të pikës 3, të nenit 201;

d) rregullat procedurale për përdorimin e mallrave ekuivalente të autorizuara, në përputhje me pikën 2, të nenit 201.

KREU II
TRANSITI

SEKSIONI 1
TRANSITI I BRENDSHËM DHE I JASHTËM

Neni 203
Transiti i jashtëm

1. Nën procedurën e transitit të jashtëm, mallrat joshqiptare mund të lëvizin nga një pikë te një tjetër e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, pa iu nënshtruar:

a) detyrimeve të importit;

b) pagesave të tjera të parashikuara nga dispozita të tjera në fuqi;

c) masave të politikës tregtare, për aq sa ato nuk e ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Në raste të veçanta mallrat shqiptare vendosen nën regjimin e transitit të jashtëm.

3. Lëvizja e përmendur në pikën 1 bëhet sipas njërës prej mënyrave të mëposhtme:

a) nën regjimin e transitit të jashtëm kombëtar;

b) në përputhje me Konventën TIR, me kusht që kjo lëvizje:

i) të ketë filluar ose do të përfundojë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

ii) të jetë kryer midis dy pikave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet territorit të një vendi ose territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) në përputhje me Konventën ATA/Konventa e Stambollit, kur kryhet një lëvizje transiti;

ç) kur mbulohet nga formati 302, i parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, në lidhje me statusin e forcave të tyre, të nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951;

d) sipas sistemit postar, në përputhje me aktet e Bashkimit Postar Universal, kur mallrat janë transportuar nga/ose për zotëruesit e të drejtave dhe detyrimeve sipas akteve të tilla.

Neni 204
Transiti i brendshëm

1. Nën regjimin e transitit të brendshëm dhe sipas kushteve të përcaktuara në pikën 2, mallrat shqiptare mund të lëvizin nga një pikë te një pikë tjetër e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke kaluar përmes një territori tjetër jashtë këtij territori, pa ndonjë ndryshim në statusin e tyre doganor.

2. Lëvizja e përmendur në pikën 1 bëhet sipas njërës prej mënyrave të mëposhtme:

a) nën procedurën e transitit të brendshëm kombëtar, me kusht që një mundësi e tillë të jetë e parashikuar në një marrëveshje ndërkombëtare;

b) në përputhje me Konventën TIR;

c) në përputhje me Konventën e ATA/Konventën e Stambollit, kur kryhet një lëvizje transiti;

ç) kur mbulohet nga formati 302, i parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, në lidhje me statusin e forcave të tyre, të nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951;

d) sipas sistemit postar, në përputhje me aktet e Bashkimit Postar Universal, kur mallrat janë transportuar nga/ose për zotëruesit e të drejtave dhe detyrimeve, sipas akteve të tilla.

Neni 205
Pritësi i autorizuar për qëllime të Konventës TIR

Autoritetet doganore, kundrejt një aplikimi, mund të autorizojnë një person, i quajtur "pritës i autorizuar", që të presë mallra që lëvizin në përputhje me Konventën TIR në një vend të autorizuar, në mënyrë që regjimi të mbyllet në përputhje me shkronjën "d", të nenit 1, të Konventës TIR.

Neni 206
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rastet kur mallrat shqiptare vendosen nën regjimin e transitit të jashtëm, në përputhje me pikën 2, të nenit 203;

b) kushtet për dhënien e autorizimit, sipas përcaktimeve të nenit 205;

c) rregullat procedurale për zbatimin e shkronjave "b" deri në "d", të pikës 3, të nenit 203, dhe shkronjave "b" deri në "d", të pikës 2, të nenit 204, në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke marrë në konsideratë nevojat.

SEKSIONI 2
TRANSITI KOMBËTAR

Neni 207
Detyrimet e mbajtësit të regjimit të transitit kombëtar dhe të transportuesit e të marrësit të mallrave që lëvizin sipas regjimit të transitit kombëtar

1. Mbajtësi i regjimit të transitit kombëtar është përgjegjës për të gjitha veprimet e mëposhtme:

a) paraqitjen e mallrave të paprekura dhe të informacionit të kërkuar në zyrën doganore të destinacionit brenda afatit kohor të përcaktuar dhe në përputhje me masat e ndërmarra nga autoritetet doganore për të siguruar identifikimin e tyre;

b) respektimin e dispozitave doganore për regjimin;

c) përveçse kur është parashikuar ndryshe në legjislacionin doganor, depozitimin e një garancie për të siguruar pagesën e shumës së detyrimit të importit apo eksportit, që i korrespondon çdo borxhi doganor apo pagesave të tjera, që mund të lindin, sipas dispozitave përkatëse në fuqi për mallrat.

2. Detyrimi i mbajtësit të regjimit përmbushet dhe regjimi i transitit mbyllet kur mallrat, që i janë nënshtruar regjimit, dhe informacioni i kërkuar janë të disponueshëm në zyrën doganore të destinacionit, në përputhje me legjislacionin doganor.

3. Transportuesi ose marrësi i mallrave, i cili pranon mallrat, duke e ditur që ato po lëvizin sipas një regjimi të transitit kombëtar, është gjithashtu përgjegjës për paraqitjen e mallrave të paprekura në zyrën doganore të destinacionit, brenda afateve kohore të përcaktuara dhe në përputhje me masat e ndërmarra nga autoritetet doganore për të siguruar identifikimin e tyre.

4. Në bazë të një aplikimi, autoritetet doganore mund të autorizojnë një prej thjeshtimeve të mëposhtme, në lidhje me vendosjen e mallrave në regjimin e transitit kombëtar ose në lidhje me mbylljen e këtij regjimi:

a) statusin e dërguesit të autorizuar, i cili i lejon mbajtësit të autorizimit të vendosë mallrat nën regjimin e transitit kombëtar pa i paraqitur ato në doganë;

b) statusin e pritësit të autorizuar, i cili i lejon mbajtësit të autorizimit të marrë/të presë mallra që lëvizin nën regjimin e transitit kombëtar në një vend të autorizuar, me qëllim mbylljen e regjimit në përputhje me pikën 2, të nenit 207;

c) përdorimin e plumbçeve të veçanta, kur kërkohet pumbosje, me qëllim që të sigurohet identifikimi i mallrave të vendosura nën regjimin e transitit kombëtar;

ç) përdorimin e një deklarate me të dhëna të reduktuara për vendosjen e mallrave nën regjimin e transitit kombëtar;

d) përdorimin e një dokumenti transporti elektronik si deklaratë doganore për vendosjen e mallrave nën regjimin e transitit kombëtar, me kusht që ai të përmbajë të dhënat e deklaratës doganore dhe të dhënat të jenë të disponueshme për autoritetet doganore në nisje dhe destinacion, me qëllim mbikëqyrjen doganore të mallrave dhe mbylljen e regjimit.

Neni 208
Mallrat që kalojnë përmes territorit të një vendi ose territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë nën një regjim transiti kombëtar të jashtëm

1. Regjimi i transitit kombëtar të jashtëm zbatohet për mallrat që kalojnë përmes një territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, nëse është plotësuar një nga kushtet e mëposhtme:

a) kur është parashikuar në një marrëveshje ndërkombëtare;

b) transportimi përmes atij vendi ose territori kryhet i mbuluar nga një dokument i vetëm transporti, i hartuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Në rastin e përmendur në shkronjën “b”, të pikës 1, procedura e regjimit të transitit kombëtar të jashtëm pezullohet, për sa kohë mallrat gjenden jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 209
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) kushtet për dhënien e autorizimit të përmendur në pikën 4, të nenit 207;

b) rregullat procedurale për vënien e mallrave nën regjimin e transitit kombëtar dhe mbylljen e këtij regjimi;

c) rregullat procedurale për thjeshtimet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 207;

ç) rregullat procedurale për mbikëqyrjen e mallrave që kalojnë përmes territorit të një vendi ose territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, nën regjimin e transitit kombëtar të jashtëm, sipas përcaktimeve të nenit 208.

KREU III
MAGAZINIMI

SEKSIONI 1
DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 210
Fusha e zbatimit

1. Nën një regjim magazinimi, mallrat joshqiptare mund të magazinohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, pa iu nënshtruar:

a) detyrimeve të importit;

b) pagesave të tjera të parashikuara në dispozitat e tjera përkatëse në fuqi;

c) masave të politikës tregtare, për aq sa ato nuk ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në/ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Mallrat shqiptare mund të vendosen nën regjimin e magazinimit doganor ose të zonës së lirë, në përputhje me legjislacionin shqiptar, që rregullon fusha të veçanta, ose për qëllim të përfitimit nga një vendim për dhënien e rimbursimit ose të faljes së detyrimit të importit.

3. Kur ekziston një nevojë ekonomike dhe nuk cenohet mbikëqyrja doganore, autoritetet doganore mund të autorizojnë magazinimin e mallrave shqiptare në një ambient magazinimi për magazinim doganor. Këto mallra konsiderohen sikur të mos jenë vendosur nën regjimin e magazinimit doganor.

Neni 211
Kohëzgjatja e një regjimi magazinimi

1. Mallrat mund të qëndrojnë nën një regjim magazinimi për një afat kohor të pakufizuar.

2. Në raste të veçanta, autoritetet doganore mund të vendosin një afat kohor, brenda të cilit duhet të mbyllet regjimi i magazinimit, në veçanti, kur lloji dhe natyra e mallrave, në rast magazinimesh të gjata në kohë, mund të shkaktojnë rrezik për shëndetin e njerëzve, bimëve ose për mjedisin.

Neni 212
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat procedurale për vendosjen e mallrave nën regjimin e magazinimit doganor ose të zonës së lirë, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 210.

SEKSIONI 2
MAGAZINIMI DOGANOR

Neni 213
Magazinimi në magazina doganore

1. Nën regjimin e magazinimit doganor, mallrat joshqiptare mund të magazinohen në ambiente ose vende të tjera të autorizuara nga autoritetet doganore për këtë

regjim dhe janë objekt i mbikëqyrjes doganore ("magazinat doganore").

2. Magazinat doganore mund të jenë të disponueshme për përdorim nga çdo person për magazinimin doganor të mallrave ("magazinat doganore publike") ose për magazinimin e mallrave nga mbajtësi i një autorizimi për magazinim doganor ("magazina doganore private"). Magazina doganore private konsiderohen edhe "dyqane të çliruara nga detyrimet" (duty free shops) që autorizohen vetëm në aeroportet për fluturime ndërkombëtare.

3. Mallrat e vendosura nën regjimin e magazinimit doganor mund të zhvendosen përkohësisht nga magazina doganore. Me përjashtim të rasteve të forcave madhore, kjo zhvendosje autorizohet paraprakisht nga autoritetet doganore.

Neni 214
Përpunimi

1. Kur ekziston një nevojë ekonomike dhe kur nuk cenohet mbikëqyrja doganore, autoritetet doganore mund të autorizojnë që përpunimi i mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv ose nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) të kryhet në një magazinë doganore, duke plotësuar kushtet e parashikuara për këto regjime.

2. Mallrat e përmendura në pikën 1 nuk konsiderohen sikur janë nën regjimin e magazinimit doganor.

Neni 215
Përgjegjësitë e mbajtësit të autorizimit ose të regjimit

1. Mbajtësi i autorizimit dhe mbajtësi i regjimit janë përgjegjës:

a) për të siguruar që mallrat nën regjimin e magazinimit doganor të mos nxirren/të dalin nga mbikëqyrja doganore;

b) për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga magazinimi i mallrave të mbuluara nga regjimi i magazinimit doganor.

2. Duke anashkaluar pikën 1, kur autorizimi ka të bëjë me një magazinë doganore publike, në autorizim mund të parashikohet që përgjegjësitë e përcaktuara në shkronjën "a" ose "b", të pikës 1, t'i kalojnë ekskluzivisht mbajtësit të regjimit.

3. Mbajtësi i regjimit është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga vendosja e mallrave nën regjimin e magazinimit doganor.

SEKSIONI 3
ZONAT E LIRA

Neni 216
Përcaktimi i zonave të lira

1. Këshilli i Ministrave mund të përcaktojë pjesë të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë si zona të lira.

Për çdo zonë të lirë Këshilli i Ministrave përcakton planvendosjen dhe pikat e hyrjes e të daljes.

2. Zonat e lira duhet të jenë të rrethuara.

Perimetri dhe pikat e hyrjes e të daljes së zonës së lirë i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore.

3. Personat, mallrat dhe mjetet e transportit që hyjnë ose dalin nga zonat e lira janë objekt i kontrolleve doganore.

Neni 217
Ndërtesat dhe aktivitetet në zonat e lira

1. Ndërtimi i çdo ndërtese në një zonë të lirë kërkon paraprakisht miratimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

2. Zonat e lira i nënshtrohen legjislacionit doganor dhe në to lejohet të kryhet çdo aktivitet industrial, tregtar ose shërbimi. Për kryerjen e aktiviteteve të tilla duhet të njoftohet paraprakisht Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të vendosë ndalime ose kufizime për aktivitetet e përmendura në pikën 2, duke pasur në konsideratë natyrën e mallrave në fjalë ose kërkesat e mbikëqyrjes doganore apo kërkesat e sigurisë e të mbrojtjes.

4. Autoritetet doganore nuk lejojnë që personat, të cilët nuk garantojnë respektimin e dispozitave doganore, të kryejnë aktivitet në një zonë të lirë.

Neni 218
Paraqitja e mallrave dhe vendosja e tyre nën regjim

1. Mallrat e futura në një zonë të lirë paraqiten në doganë dhe për to kryhen formalitetet doganore, të parashikuara në një nga rastet e mëposhtme:

a) kur ato janë futur në zonën e lirë direkt nga jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) kur ato ishin vendosur nën një regjim doganor, i cili ka përfunduar ose është mbyllur me vendosjen e mallrave nën regjimin e zonës së lirë;

c) kur ato janë të vendosura nën regjimin e zonës së lirë për të përfituar nga një vendim që autorizon rimbursimin ose faljen e detyrimit të importit;

ç) kur akte të tjera ligjore, të ndryshme nga legjislacioni doganor, parashikojnë formalitete të tilla.

2. Mallrat e futura në një zonë të lirë, në rrethana të tjera nga ato të mbuluara nga pika 1, nuk paraqiten në doganë.

3. Pa cenuar nenin 219, mallrat e futura në një zonë të lirë konsiderohen të vendosura nën regjimin e zonës së lirë:

a) në momentin e hyrjes së tyre në një zonë të lirë, me përjashtim të rasteve kur ato janë vendosur tashmë nën një regjim tjetër doganor; ose

b) në momentin kur mbyllet një regjim transiti, me përjashtim të rasteve kur ato vendosen menjëherë nën një regjim doganor vijues.

Neni 219
Mallrat shqiptare në zonat e lira

1. Mallrat shqiptare mund të hyjnë, të magazinohen, të lëvizin, të përdoren, të përpunohen ose të konsumohen në një zonë të lirë. Në raste të tilla mallrat nuk konsiderohen sikur janë nën regjimin e zonës së lirë.

2. Me aplikim të personit të interesuar, autoritetet doganore përcaktojnë statusin doganor, si mallra shqiptare për mallrat e mëposhtme:

a) mallrat shqiptare, të cilat hyjnë në një zonë të lirë;

b) mallrat shqiptare, të cilat kanë kaluar operacione përpunimi brenda një zone të lirë;

c) mallrat e çliruara për qarkullim të lirë brenda një zone të lirë.

Neni 220
Mallrat joshqiptare në zonat e lira

1. Mallrat joshqiptare, ndërsa qëndrojnë në një zonë të lirë, mund të çlirohen për qarkullim të lirë ose të vendosen nën regjimin e përpunimit aktiv, lejimit të përkohshëm ose të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use), sipas kushteve të përcaktuara për këto regjime.

Në raste të tilla mallrat nuk konsiderohen sikur janë nën regjimin e zonës së lirë.

2. Pa cenuar dispozitat që zbatohen për furnizimet ose për magazinimin e furnizimeve dhe kur regjimi në fjalë e parashikon kështu, pika 1, e këtij neni, nuk përjashton përdorimin ose konsumimin e mallrave, për të cilat çlirimi për qarkullim të lirë ose lejimi i përkohshëm nuk sjell aplikimin e detyrimit të importit ose masave të politikës bujqësore ose tregtare.

Në rastin e një përdorimi apo konsumi të tillë të mallrave nuk kërkohet deklaratë doganore për çlirim për qarkullim të lirë ose lejim të përkohshëm.

Megjithatë, deklarata doganore kërkohet nëse mallrat janë objekt i kuotave tarifore ose tavaneve tarifore.

Neni 221
Dalja e mallrave nga një zonë e lirë

Pa cenuar legjislacionin e fushave të tjera të ndryshme nga fusha doganore, mallrat në një zonë të lirë mund të eksportohen ose të rieksportohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë ose të hyjnë në një pjesë tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Për mallrat që hyjnë në pjesë të tjera të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë zbatohen nenet 125 deri në 139.

Neni 222
Statusi doganor

Kur mallrat e dala nga një zonë e lirë hyjnë në një pjesë tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose vendosen nën një regjim doganor, ato konsiderohen si mallra joshqiptare, përveçse kur provohet statusi i tyre doganor si mallra shqiptare.

Megjithatë, për qëllim të aplikimit të detyrimit të eksportit dhe licencave të eksportit ose të masave të kontrollit të eksportit, të përcaktuara në politikat bujqësore ose tregtare, mallra të tilla do të konsiderohen si mallra shqiptare, përveçse kur përcaktohet që ato nuk kanë statusin doganor të mallrave shqiptare.

KREU IV
PËRDORIMI I VEÇANTË

SEKSIONI 1
LEJIMI I PËRKOHSHËM

Neni 223
Fusha e zbatimit

1. Nën regjimin e lejimit të përkohshëm mallrat joshqiptare, të destinuara për rieksport, mund të jenë objekt i përdorimit të veçantë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimi i importit dhe pa iu nënshtruar:

a) pagesave të tjera, të parashikuara sipas dispozitave përkatëse në fuqi;

b) masave të politikës tregtare, për aq sa ato nuk ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në/ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Regjimi i lejimit të përkohshëm përdoret vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) mallrat nuk janë të destinuara të pësojnë asnjë ndryshim, përveç zhvlerësimit normal për shkak të përdorimit të tyre;

b) është e mundur të sigurohet që mallrat e vendosura nën regjim mund të identifikohen, me përjashtim të rasteve kur, duke pasur parasysh natyrën e mallrave ose destinacionin e përdorimit, mungesa e masave identifikuese nuk mund të shkaktojë një përdorim abuziv të regjimit ose, në rastin e përmendur në nenin 201, është e mundur të verifikohet përputhshmëria me kushtet e përcaktuara për mallrat ekuivalente;

c) mbajtësi i regjimit është i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, përveçse kur është e parashikuar ndryshe;

ç) kur plotësohen kërkesat për përjashtim të plotë ose të pjesshëm të detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor.

Neni 224
Afati kohor gjatë të cilit mallrat mund të qëndrojnë nën regjimin e lejimit të përkohshëm

1. Autoritetet doganore përcaktojnë afatin kohor, brenda të cilit mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm duhet të rieksportohen ose t'i nënshtrohen një regjimi doganor pasardhës. Ky afat duhet të jetë i mjaftueshëm për arritjen e objektivit të përdorimit të autorizuar.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe, afati kohor maksimal, gjatë të cilit mallrat mund të qëndrojnë nën regjimin e lejimit të përkohshëm për të njëjtin qëllim dhe nën përgjegjësinë e të njëjtit mbajtës të autorizimit, është 24 muaj, madje edhe kur regjimi ishte mbyllur duke i vendosur mallrat nën një regjim tjetër të posaçëm dhe më tej duke i vendosur ato përsëri nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

3. Kur, në rrethana të veçanta, përdorimi i autorizuar nuk mund të arrihet brenda afatit kohor të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, autoritetet doganore mund të japin një zgjatje të afatit kohor për një kohëzgjatje të arsyeshme, kundrejt një aplikimi të justifikuar nga ana e mbajtësit të autorizimit.

4. I tërë afati kohor, gjatë të cilit mallrat mund të qëndrojnë nën regjimin e lejimit të përkohshëm, nuk kalon 10 vjet, përveçse në rast të një situate të paparashikuar.

Neni 225
Shuma e detyrimit të importit në rastin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimi i importit

1. Shuma e detyrimit të importit, në lidhje me mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimi i importit, vendoset në masën 3 për qind të shumës së detyrimit të importit, që do të ishte e pagueshme për këto mallra sikur ato të kenë qenë çliruar për qarkullim të lirë në datën, në të cilën ato u vendosën nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

Kjo shumë është e pagueshme për çdo muaj ose pjesë të muajit, gjatë të cilit mallrat janë vendosur nën regjimin e lejimit të përkohshëm, me përjashtim të pjesshëm nga detyrimi i importit.

2. Shuma e detyrimit të importit nuk duhet të kalojë shumën që duhej paguar në qoftë se mallrat në fjalë do të ishin çliruar për qarkullim të lirë në datën, në të cilën ato ishin vendosur nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

Neni 226
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) përdorimi i veçantë, i përcaktuar në pikën 1, të nenit 223;

b) kërkesat e përcaktuara në shkronjën "ç", të pikës 2, të nenit 223.

SEKSIONI 2
PËRDORIMI I VEÇANTË PËRFUNDIMTAR (END-USE)

Neni 227
Regjimi i përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use)

1. Nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use), mallrat mund të çlirohen për qarkullim të lirë me përjashtim nga detyrimi ose me një reduktim të nivelit të detyrimit, për shkak të përdorimit të tyre të veçantë.

2. Kur mallrat janë në një stad përpunimi, që ekonomikisht mund të lejojë vetëm përdorimin e veçantë përfundimtar (end-use) të parashikuar, autoritetet doganore vendosin në autorizim kushtet, nën të cilat mallrat konsiderohen se janë përdorur për qëllimet e parashikuara për zbatimin e përjashtimit ose reduktimit të nivelit të detyrimit.

3. Kur mallrat janë të përshtatshme për përdorim të përsëritur dhe autoritetet doganore, me qëllim shmangien e abuzimeve, e konsiderojnë të arsyeshme, mbikëqyrja doganore vazhdon për një afat që nuk kalon dy vjet pas datës së përdorimit të tyre të parë për qëllimet e parashikuara për zbatimin e përjashtimit nga detyrimi apo reduktimit të nivelit të detyrimit.

4. Mbikëqyrja doganore për regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) përfundon në rastet e mëposhtme:

a) kur mallrat janë përdorur për qëllimet e përcaktuara për aplikimin e përjashtimit ose reduktimit të nivelit të detyrimit;

b) kur mallrat kanë dalë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, janë shkatërruar ose braktisur në favor të shtetit;

c) kur mallrat janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara për aplikimin e përjashtimit ose të reduktimit të nivelit detyrimit dhe për to është paguar detyrimi i importit.

5. Kur kërkohet një koeficient shfrytëzimi, për regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) zbatohet neni 228.

6. Mbetjet dhe hedhurinat që rezultojnë nga punimi ose përpunimi i mallrave, sipas përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use), të parashikuar, dhe humbjet natyrale konsiderohen si mallra që i përkasin këtij përdorimi të veçantë përfundimtar (end-use).

7. Mbetjet dhe hedhurinat që rezultojnë nga shkatërrimi i mallrave të vendosura në regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) konsiderohen si mallra të vendosura nën regjimin e magazinimit doganor.

KREU V
PËRPUNIMI

SEKSIONI 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 228
Koeficienti i shfrytëzimit

Përveçse kur një koeficient shfrytëzimi është i specifikuar në legjislacionin shqiptar që rregullon fusha specifike, autoritetet doganore vendosin ose koeficientin e shfrytëzimit, ose koeficientin mesatar të shfrytëzimit të operacionit të përpunimit apo, kur është rasti, metodën e përcaktimit të këtij koeficienti.

Koeficienti i shfrytëzimit ose koeficienti mesatar i shfrytëzimit përcaktohet duke u mbështetur në rrethanat aktuale, në të cilat operacionet e përpunimit janë kryer ose do të kryhen. Ky koeficient mund të rregullohet, kur është e përshtatshme, në përputhje me nenin 32.

Autoritetet doganore për mallrat që janë nën regjimin e përpunimit aktiv, përdorin si kriter referues parësor, sasinë e produktit final të porositur, siç rezulton nga dokumentacioni doganor. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përcakton me udhëzim trajtimin e produkteve kompensuese.

SEKSIONI 2
PËRPUNIMI AKTIV

Neni 229
Fusha e zbatimit

1. Pa cenuar nenin 201, mallrat joshqiptare mund të përdoren në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nën regjimin e përpunimit aktiv, në një apo më shumë operacione përpunimi, pa iu nënshtruar:

a) detyrimit të importit;

b) pagesave të tjera, sipas parashikimeve në dispozitat përkatëse në fuqi;

c) masave të politikës tregtare, për aq sa ato nuk ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Regjimi i përpunimit aktiv mund të përdoret në raste të ndryshme nga riparimi dhe shkatërrimi, vetëm kur, pa cenuar përdorimin e aksesorëve të prodhimit, mallrat e vendosura nën regjim mund të identifikohen në produktet e përpunuara.

Në rastin e përmendur në nenin 201, regjimi lejohet të përdoret atëherë kur mund të verifikohet përputhja me kushtet e përcaktuara për mallrat ekuivalente.

3. Në shtesë të pikave 1 dhe 2, regjimi i përpunimit aktiv mund të përdoret edhe për mallrat e mëposhtme:

a) mallrat e destinuara për t'iu nënshtruar operacioneve që garantojnë përputhjen e tyre me kërkesat teknike për çlirimin e tyre për qarkullim të lirë;

b) mallrat, të cilat duhet t'u nënshtrohen formave të zakonshme të trajtimit, në përputhje me nenin 199.

Neni 230
Afati kohor i mbylljes

1. Autoritetet doganore përcaktojnë afatin kohor, brenda të cilit duhet të mbyllet regjimi i përpunimit aktiv, në përputhje me nenin 196.

Ky afat kohor fillon nga data, në të cilën mallrat joshqiptare janë vendosur nën regjim, duke marrë në konsideratë edhe kohën e nevojshme për të kryer operacionet e përpunimit dhe të mbylljes së regjimit.

2. Autoritetet doganore, përkundrejt një aplikimi të justifikuar nga mbajtësi i autorizimit, mund të autorizojnë një shtyrje të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 1, për një kohëzgjatje të arsyeshme.

Në autorizim mund të specifikohet që një afat kohor, i cili fillon gjatë një muaji kalendarik, tremujori ose gjashtëmujori, përfundon respektivisht në ditën e fundit të muajit kalendarik, tremujorit ose gjashtëmujorit pasardhës.

3. Në raste të eksportimit paraprak, në përputhje me shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 201, në autorizim specifikohet afati kohor, brenda të cilit mallrat joshqiptare deklarohen për regjimin e përpunimit aktiv, duke marrë në konsideratë kohën e nevojshme për blerjen/prokurimin dhe transportin drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Afati kohor i përcaktuar në paragrafin e mësipërm vendoset në muaj dhe nuk duhet të kalojë gjashtë muaj. Ai fillon nga data e pranimit të deklaratës së eksportit, në lidhje me produktet e përpunuara, të përftuara nga mallrat ekuivalente korresponduese.

4. Me kërkesë nga mbajtësi i autorizimit, afati prej gjashtë muajsh, i përcaktuar në pikën 3, mund të zgjatet edhe pas skadimit të tij, me kusht që afati total të mos kalojë 12 muaj.

Neni 231
Rieksportimi i përkohshëm për përpunim të mëtejshëm

Në bazë të një aplikimi, autoritetet doganore mund të autorizojnë që disa ose të gjitha mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv apo produktet e përpunuara të rieksportohen përkohësisht, për qëllim të përpunimit të mëtejshëm jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara për regjimin e përpunimit pasiv.

SEKSIONI 3
PËRPUNIMI PASIV

Neni 232
Fusha e zbatimit

1. Nën regjimin e përpunimit pasiv mallrat shqiptare mund të eksportohen përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë për t'iu nënshtruar operacioneve të përpunimit. Produktet e përpunuara që rezultojnë nga këto mallra mund të çlirohen për qarkullim të lirë me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimi i importit kundrejt aplikimit nga mbajtësi i autorizimit ose nga çdo person tjetër i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që ky person të ketë marrë miratimin e mbajtësit të autorizimit dhe kushtet e autorizimit të jenë përmbushur.

2. Përpunimi pasiv nuk lejohet për mallrat shqiptare të mëposhtme:

a) mallrat, eksporti i të cilave çon në rimbursim ose falje të detyrimit të importit;

b) mallrat, të cilat, para eksportimit, ishin çliruar për qarkullim të lirë me një përjashtim ose reduktim të nivelit të detyrimit për shkak të përdorimit të tyre të veçantë përfundimtar (end-use) dhe nëse qëllimet e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) nuk janë përmbushur, përveçse kur këto mallra duhet t'u nënshtrohen operacioneve të riparimit;

c) mallra, eksporti i të cilave çon në dhënien e rimbursimeve të eksportit;

ç) mallrat, për të cilat, për shkak të eksportimit të tyre, në kuadër të politikës bujqësore, është dhënë një avantazh financiar i ndryshëm nga rimbursimi i parashikuar në shkronjën "c", të kësaj pike.

3. Autoritetet doganore përcaktojnë afatin kohor, brenda të cilit mallrat e eksportuara përkohësisht duhet të riimportohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në formën e produkteve të përpunuara dhe të çlirohen për qarkullim të lirë, në mënyrë që të mundësohet përfitimi nga përjashtimi i plotë ose i pjesshëm nga detyrimi i importit. Në bazë të një aplikimi të justifikuar nga mbajtësi i autorizimit, autoritetet doganore mund ta shtyjnë këtë afat kohor për një kohëzgjatje të arsyeshme.

Neni 233
Mallrat e riparuara falas

1. Mallrat mund të përfitojnë një përjashtim të plotë nga detyrimi i importit kur u provohet autoriteteve doganore që mallrat janë riparuar falas ose në bazë të një detyrimi kontraktual a ligjor që rrjedh nga garancia, ose për shkak të ekzistencës së një defekti material apo prodhimi.

2. Pika 1 nuk zbatohet kur defekti material ose i prodhimit është konstatuar që në momentin e çlirimit të parë për qarkullim të lirë të mallrave në fjalë.

Neni 234
Sistemi i shkëmbimit standard

1. Nën sistemin e shkëmbimit standard, një produkt i importuar ("produkti zëvendësues") mund të zëvendësojë një produkt të përpunuar, në përputhje me pikat 2 deri në 5, të këtij neni.

2. Autoritetet doganore, përkundrejt një aplikimi, autorizojnë përdorimin e sistemit të shkëmbimit standard kur operacioni i përpunimit konsiston në riparimin e mallrave shqiptare defektoze, të ndryshme nga ato që janë objekt i masave të politikës bujqësore ose i regjimeve specifike të zbatueshme për mallra të caktuara, të përftuara nga përpunimi i prodhimeve bujqësore.

3. Produktet zëvendësuese kanë të njëjtin kod tetëshifror të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, të njëjtën cilësi tregtare dhe të njëjtat karakteristika teknike, si mallrat defektoze, nëse këto të fundit do t'i ishin nënshtruar riparimit.

4. Kur mallrat defektoze janë përdorur përpara eksportit, produktet zëvendësuese duhet gjithashtu të jenë të përdorura.

Megjithatë, autoritetet doganore nuk kërkojnë zbatimin e paragrafit të mësipërm nëse produkti zëvendësues është dhënë falas, për shkak të një detyrimi kontraktor a ligjor, në lidhje me garancinë ose për shkak të ekzistencës së një defekti material ose prodhimi.

5. Dispozitat, të cilat zbatohen për produktet e përpunuara, zbatohen edhe për produktet zëvendësuese.

Neni 235
Importimi paraprak i produkteve zëvendësuese

1. Me aplikim të personit të interesuar, Autoritetet doganore autorizojnë importimin e produkteve zëvendësuese përpara eksportimit të mallrave defektoze, sipas kushteve të përcaktuara prej tyre. Në këtë rast depozitohet një garanci që mbulon shumën e detyrimit.

2. Mallrat defektoze eksportohen brenda një afati prej 2 muajsh nga data, në të cilën autoritetet doganore pranojnë deklaratën për çlirimin për qarkullim të lirë të produkteve zëvendësuese.

3. Me kërkesë të arsyetuar të mbajtësit të autorizimit, autoritetet doganore mund të shtyjnë deri në një vit afatin e përcaktuar në pikën 2, në varësi të kushteve dhe rrethanave kur mallrat defektoze nuk mund të eksportohen brenda afatit të parashikuar.

TITULLI VIII
DALJA E MALLRAVE NGA TERRITORI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KREU I
FORMALITETET PARA DALJES SË MALLRAVE

Neni 236
Depozitimi i një deklarate paranisjeje

1. Mallrat, që do të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, duhet të shoqërohen nga një deklaratë e paranisjes, e cila duhet të depozitohet në zyrën doganore kompetente, brenda një afati kohor të caktuar, përpara se mallrat të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Detyrimi i përcaktuar në pikën 1 nuk zbatohet:

a) për mjetet e transportit dhe mallrat e transportuara me to, të cilat vetëm përshkojnë ujërat territoriale ose hapësirën ajrore të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë pa ndaluar në këtë territor; ose

b) në raste të tjera të veçanta, të justifikuara nga lloji i mallrave ose i trafikut ose nga detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje ndërkombëtare.

3. Deklarata e paranisjes merr një nga format e mëposhtme:

a) atë të një deklarate doganore, kur mallrat që do të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë janë vendosur nën një regjim doganor, për të cilin kërkohet një deklaratë e tillë;

b) atë të një deklarate rieksporti, në përputhje me nenin 242;

c) atë të deklaratës përmbledhëse të daljes, në përputhje me nenin 243.

4. Deklarata e paranisjes duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për kryerjen e analizës së riskut për qëllime të sigurisë dhe mbrojtjes.

Neni 237
Analiza e riskut

Zyra doganore, në të cilën depozitohet deklarata e paranisjes, e përcaktuar në nenin 236, siguron që, brenda një afati kohor dhe bazuar në deklaratën e paranisjes, të kryhet një analizë risku, kryesisht për qëllime të sigurisë dhe të mbrojtjes dhe merr masat e nevojshme në varësi të rezultateve të kësaj analize risku.

Neni 238
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) afatet kohore, sipas pikës 1, të nenit 236, brenda të cilave duhet të depozitohet deklarata e paranisjes, përpara se mallrat të dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke marrë në konsideratë llojin e trafikut;

b) rastet kur nuk kërkohet depozitimi i deklaratës së paranisjes, në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 236;

c) afati kohor i përcaktuar në nenin 237, brenda të cilit duhet të kryhet analiza e riskut, duke marrë në konsideratë afatin kohor të përcaktuar në pikën 1, të nenit 236.

KREU II
FORMALITETET NË DALJE TË MALLRAVE

Neni 239
Mbikëqyrja doganore dhe formalitetet në dalje

1. Mallrat, që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore dhe mund të jenë objekt i kontrolleve doganore. Kur e gjejnë me vend, autoritetet doganore mund të përcaktojnë itinerarin që duhet të përshkojnë mallrat që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë si dhe afatet kohore për t’u respektuar.

2. Mallrat, që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, paraqiten në zyrën doganore kompetente nga njëri prej personave të mëposhtëm:

a) personi, i cili nxjerr mallrat nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

b) personi, në emër ose për llogari të të cilit vepron personi që nxjerr mallrat nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

c) personi, i cili merr përgjegjësinë për transportin e mallrave, përpara daljes së tyre nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

3. Mallrat, që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas rastit, janë objekt i:

a) rimbursimit ose i faljes së detyrimit të importit;

b) pagesës së subvencioneve për eksportin;

c) mbledhjes/vjeljes së detyrimit të eksportit;

ç) formaliteteve të kërkuara, sipas dispozitave në fuqi, përsa u përket pagesave të tjera;

d) zbatimit të ndalimeve dhe kufizimeve për arsye të mbrojtjes së moralit shoqëror, rendit publik ose sigurisë publike, mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve apo bimëve, mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes së pasurive kombëtare me vlerë artistike, historike apo arkeologjike dhe mbrojtjes së pronësisë industriale ose tregtare. Këto ndalime dhe kufizime përfshijnë edhe kontrollin e prekursorëve kimikë, të mallrave që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale dhe shumat në të holla që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, si edhe zbatimin e masave mbrojtëse dhe menaxhuese për peshkimin dhe masat e politikës tregtare.

4. Çlirimi për dalje jepet nga autoritetet doganore me kusht që mallrat në fjalë të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë në të njëjtat kushte si në momentin kur:

a) ishte pranuar deklarata doganore ose deklarata doganore e rieksportit; ose

b) ishte depozituar deklarata përmbledhëse e daljes.

Neni 240
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat procedurale për daljen e mallrave, sipas përcaktimeve të nenit 239.

KREU III
EKSPORTI DHE RIEKSPORTI

Neni 241
Eksporti i mallrave shqiptare

1. Mallrat shqiptare, që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, vendosen nën regjimin e eksportit.

2. Pika 1 nuk zbatohet për mallrat e mëposhtme shqiptare:

a) mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit pasiv;

b) mallrat që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pasi kanë qenë të vendosura nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use);

c) mallrat e lëvruara si furnizime të avionit ose anijes, me përjashtim nga TVSH-ja ose detyrimi i akcizës, pavarësisht nga destinacioni i avionit apo anijes, për të cilat kërkohet të provohet që një furnizim i tillë është kryer;

ç) mallrat e vendosura nën regjimin e transitit të brendshëm;

d) mallra që dalin përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 144.

3. Formalitetet e lidhura me deklaratën doganore të eksportit, të parashikuara në legjislacionin doganor, zbatohen në rastet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2.

Neni 242
Rieksporti i mallrave joshqiptare

1. Mallrat joshqiptare, që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, janë objekt i një deklarate rieksporti, e cila depozitohet në zyrën doganore kompetente.

2. Për deklaratën e rieksportit zbatohen nenet 146 deri në 176.

3. Pika 1 nuk zbatohet për mallrat e mëposhtme:

a) mallrat e vendosura nën regjimin e transitit të jashtëm, të cilat vetëm kalojnë përmes territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) mallrat e transborduara brenda një zone të lirë ose të rieksportuara direkt nga një zonë e lirë;

c) mallrat e vendosura nën një regjim magazinimi të përkohshëm, të cilat janë rieksportuar direkt nga një ambient i magazinimit të përkohshëm.

KREU IV
DEKLARATA PËRMBLEDHËSE E DALJES

Neni 243
Depozitimi i një deklarate përmbledhëse të daljes

1. Kur mallrat dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe nuk është depozituar një deklaratë doganore ose një deklaratë doganore rieksporti, si deklaratë e paranisjes, atëherë depozitohet një deklaratë përmbledhëse e daljes në zyrën doganore kompetente.

Autoritetet doganore mund të lejojnë që deklarata përmbledhëse e daljes të depozitohet në një zyrë tjetër doganore, me kusht që kjo e fundit t’i komunikojë ose t’i bëjë të mundur elektronikisht menjëherë të dhënat e nevojshme zyrës doganore të daljes.

2. Deklarata përmbledhëse e daljes depozitohet nga transportuesi.

Pavarësisht nga detyrimet e transportuesit, deklarata përmbledhëse e daljes mund të depozitohet në vend të tij nga një prej personave të mëposhtëm:

a) eksportuesi ose dërguesi apo një person tjetër, në emër a për llogari të të cilit vepron transportuesi;

b) çdo person, i cili është në gjendje të paraqesë mallrat në fjalë ose të bëjë që ato të paraqiten në zyrën doganore të daljes.

3. Autoritetet doganore mund të pranojnë që dokumentet tregtare, portuale ose sistemet informatike të transportit të përdoren si një deklaratë përmbledhëse e daljes, me kusht që të përmbajnë të dhënat e nevojshme për një deklaratë të tillë dhe këto të dhëna të jenë të vlefshme/të disponueshme brenda një afati kohor të përcaktuar, përpara se mallrat të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

4. Autoritetet doganore mund të pranojnë, në vend të depozitimit të një deklarate përmbledhëse të daljes, depozitimin e një njoftimi dhe akses në të dhënat e një deklarate përmbledhëse të daljes në sistemin kompjuterik të operatorit ekonomik.

Neni 244
Ndryshimi dhe anulimi i deklaratës përmbledhëse të daljes

1. Deklaruesi, përmes një aplikimi, mund të lejohet të ndryshojë një ose më shumë të dhëna të deklaratës përmbledhëse të daljes pasi ajo të jetë depozituar.

Asnjë ndryshim nuk është i mundur pasi autoritetet doganore:

a) kanë informuar personin që depozitoi deklaratën përmbledhëse të daljes që ato kanë për qëllim të verifikojnë mallrat;

b) kanë arritur në përfundimin se një ose më shumë të dhëna të deklaratës përmbledhëse të daljes janë të pasakta ose të paplota;

c) tashmë kanë lejuar çlirimin e mallrave për dalje.

2. Kur mallrat, për të cilat është depozituar një deklaratë përmbledhëse e daljes, nuk kanë dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, autoritetet doganore anulojnë këtë deklaratë në një nga rastet e mëposhtme:

a) me aplikim nga deklaruesi;

b) brenda 150 ditëve pas depozitimit të deklaratës.

Neni 245
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat procedurale për:

a) depozitimin e një deklarate përmbledhëse të daljes, sipas përcaktimeve të nenit 243;

b) ndryshimin e deklaratës përmbledhëse të daljes, në përputhje me pikën 1, të nenit 244;

c) anulimin e deklaratës përmbledhëse të daljes, në përputhje me pikën 2, të nenit 244.

KREU V
NJOFTIMI I RIEKSPORTIT

Neni 246
Depozitimi i një njoftimi rieksporti

1. Kur mallrat joshqiptare, të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 3, të nenit 242, kanë dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe nuk kërkohet depozitimi i një deklarate përmbledhëse të daljes për këto mallra, atëherë depozitohet një njoftim rieksporti.

2. Njoftimi i rieksportit depozitohet në zyrën doganore të daljes së mallrave nga personi përgjegjës për paraqitjen e mallrave në dalje, në përputhje me pikën 2, të nenit 239.

3. Njoftimi i rieksportit përmban të dhënat e nevojshme për mbylljen e regjimit të zonës së lirë ose të magazinimit të përkohshëm.

Autoritetet doganore mund të pranojnë që dokumentet tregtare, portuale ose sistemet informatike të transportit të përdoren si depozitim i një njoftimi rieksporti, me kusht që ato të përmbajnë të dhënat e nevojshme për një njoftim të tillë dhe këto të dhëna të jenë të vlefshme/të disponueshme përpara se mallrat të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

4. Autoritetet doganore mund të pranojnë, në vend të depozitimit të njoftimit të rieksportit, depozitimin e një njoftimi dhe akses në të dhënat e një njoftimi rieksporti në sistemin kompjuterik të operatorit ekonomik.

Neni 247
Ndryshimi dhe anulimi i njoftimit të rieksportit

1. Deklaruesi, nëpërmjet një aplikimi, mund të lejohet të ndryshojë një ose më shumë të dhëna të njoftimit të rieksportit pasi e ka depozituar atë.

Asnjë ndryshim nuk mund të bëhet pasi autoritetet doganore:

a) kanë njoftuar personin që depozitoi njoftimin e rieksportit që ato kanë për qëllim të verifikojnë mallrat;

b) kanë arritur në përfundimin që një ose më shumë të dhëna të njoftimit të rieksportit janë të pasakta ose të paplota;

c) tashmë kanë lejuar çlirimin e mallrave për dalje.

2. Kur mallrat, për të cilat është depozituar një njoftim rieksporti, nuk kanë dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, autoritetet doganore anulojnë këtë njoftim në një nga rastet e mëposhtme:

a) me aplikim nga deklaruesi;

b) brenda 150 ditëve pas depozitimit të njoftimit.

Neni 248
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat procedurale për:

a) depozitimin e njoftimit të rieksportit, sipas përcaktimeve të nenit 246;

b) ndryshimin e njoftimit të rieksportit, në përputhje me pikën 1, të nenit 247;

c) anulimin e njoftimit të rieksportit, në përputhje me pikën 2, të nenit 247.

KREU VI
PËRJASHTIME NGA DETYRIMI I EKSPORTIT

Neni 249
Përjashtime nga detyrimi i eksportit për mallra shqiptare të eksportuara përkohësisht

Pa cenuar nenin 232, mallrat shqiptare që eksportohen përkohësisht jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë përjashtohen nga detyrimet e eksportit, me kusht që të riimportohen.

TITULLI IX
SHKELJET NË FUSHËN DOGANORE,
SANKSIONET DHE ANKIMI

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 250
Klasifikimi i shkeljeve

1. Shkelje doganore janë:

a) kundërvajtjet administrative;

b) kontrabanda.

2. Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ.

3. Kontrabandë janë veprat penale të sanksionuara në Kodin Penal që cenojnë marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave ekonomikë të saj, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenet 266 dhe 267 të këtij Kodi.

4. Pagesa e gjobës që zbatohet për shkeljen doganore, në asnjë rast, nuk është shkak për të përjashtuar shkelësin nga pagimi i detyrimeve të importit ose eksportit që duhen paguar për mallrat, objekt i shkeljes.

5. Vendosja e sanksioneve, sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk e ndalon administratën doganore të paraqesë kallëzim penal për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal.

6. Sanksionet e vendosura në bazë të legjislacionit doganor zbatohen, pavarësisht nga aplikimi i sanksioneve të parashikuara në ligje të tjera.

7. Për qëllime të këtij titulli, në detyrime importi dhe eksporti përfshihen detyrimet doganore, detyrimet e akcizës, të TVSH-së dhe detyrimet e taksat e tjera që zbatohen në import ose eksport.

KREU II
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

SEKSIONI 1
LLOJET E KUNDËRVAJTJEVE

Neni 251
Kundërvajtjet me përgjegjësi objektive

1. Për qëllime të këtij neni, me kundërvajtje me përgjegjësi objektive kuptohen kundërvajtjet, për të cilat nuk kërkohet të provohet elementi faj, duke pasur parasysh karakterin objektiv të detyrimeve të përfshira dhe faktin që personat, të cilët kanë përgjegjësinë që t'i respektojnë nuk mund të justifikohen me padijeninë për ekzistencën e tyre, si dhe karakterin e tyre detyrues.

2. Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje me përgjegjësi objektive:

a) mosrespektimi nga personi, që depoziton deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes dhe deklaratën e rieksportit ose njoftimin e rieksportit, i detyrimit për të siguruar saktësinë dhe plotësimin e informacioneve të dhëna në deklaratë, njoftim apo aplikim, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 23;

b) mosrespektimi nga personi, që depoziton deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes dhe deklaratën e rieksportit ose njoftimin e rieksportit, i detyrimit për të siguruar vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti shoqërues, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 2 të nenit 23;

c) mosrespektimi nga personi i detyrimit për të depozituar një deklaratë përmbledhëse të hyrjes, sipas përcaktimeve të nenit 119, një njoftim për mbërritjen e një anijeje detare apo avioni, sipas përcaktimeve të nenit 124, një deklaratë të magazinimit të përkohshëm, në përputhje me nenin 135, një deklaratë doganore, në përputhje me nenin 146, një njoftimi për aktivitetet në zonat e lira në përputhje me pikën 2, të nenit 217, një deklaratë të paranisjes, në përputhje me nenin 236, një deklaratë rieksporti, në përputhje me nenin 242, një deklaratë përmbledhëse të daljes, në përputhje me nenin 243 ose një njoftim rieksporti, në përputhje me nenin 246;

ç) mosrespektimi nga një operator ekonomik i detyrimit për ruajtjen e dokumenteve e të informacioneve për përmbushjen e formaliteteve doganore me çdo mjet të pranueshëm që mundëson aksesin, për afatin kohor të parashikuar nga legjislacioni doganor në përputhje me nenin 52;

d) heqja nga mbikëqyrja doganore e mallrave të sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e autoriteteve doganore dhe që bie në kundërshtim me paragrafin e parë dhe të dytë të pikës 1, të nenit 125;

dh) heqja e mallrave nga mbikëqyrja doganore, në kundërshtim me paragrafin e katërt, të pikës 1, të nenit 125, të pikës 3, të nenit 146, dhe nenit 215;

e) mosrespektimi nga një person, që fut mallrat në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, i detyrimit që lidhet me transportin e mallrave drejt vendit të përcaktuar, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 126, ose mosinformimi i autoriteteve doganore, kur këto detyrime nuk mund të përmbushen, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të nenit 128;

ë) mosrespektimi nga deklaruesi për magazinimin e përkohshëm apo për një regjim doganor i detyrimit për depozitimin e dokumentacionit të nevojshëm pranë autoriteteve doganore kur kërkohet nga legjislacioni doganor ose, kur është i nevojshëm, për kontrollet doganore, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 135, dhe pikës 2, të nenit 150;

f) mosrespektimi nga operatori ekonomik përgjegjës për mallrat joshqiptare, të cilat janë nën regjimin e magazinimit të përkohshëm, i detyrimit për t'i vendosur këto mallra nën një regjim doganor ose për t'i rieksportuar ato brenda afateve kohore, të përcaktuara në nenin 139;

g) mosrespektimi nga deklaruesi për një regjim doganor i detyrimit për të poseduar dhe për të vënë në dispozicion të autoriteteve doganore, në momentin e dorëzimit të deklaratës doganore apo deklaratës plotësuese, të dokumenteve shoqëruese për zbatimin e regjimit në fjalë, në përputhje me pikën 1, të nenit 150, dhe të paragrafit të dytë, të pikës 1, të nenit 153;

gj) mosrespektimi nga deklaruesi për një regjim doganor, në rastin e një deklarate të thjeshtuar, sipas përcaktimeve të nenit 152 ose të një hyrjeje në regjistrimet e deklaruesit, sipas përcaktimeve të nenit 165, i detyrimit për të depozituar deklaratën plotësuese në zyrën doganore kompetente dhe brenda afateve kohore, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 153;

h) heqja ose shkatërrimi i mjeteve të identifikimit, të vëna nga autoritetet doganore në mallrat, ambalazhet ose mjetet e transportit pa autorizimin paraprak të autoriteteve doganore, në përputhje me pikën 2, të nenit 173;

i) mosrespektimi nga mbajtësi i regjimit të përpunimit aktiv i detyrimit për mbylljen e regjimit doganor brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230;

j) mosrespektimi nga mbajtësi i regjimit të përpunimit pasiv i detyrimit për të eksportuar mallrat defektoze brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 235;

k) ndërtimi i një ndërtese në një zonë të lirë, pa autorizimin e autoriteteve doganore, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 217;

l) mospagesa e detyrimit të importit ose të eksportit nga personi përgjegjës për pagesën, brenda afatit të përcaktuar në përputhje me nenin 101.

Neni 252
Kundërvajtje të kryera në neglizhencë

Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë:

a) mosrespektimi nga operatori ekonomik përgjegjës për mallrat joshqiptare, të cilat janë nën regjimin e magazinimit të përkohshëm, i detyrimit për vendosjen e këtyre mallrave nën një regjim doganor ose rieksport brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 139;

b) mosrespektimi nga operatori ekonomik i detyrimit për të siguruar të gjithë asistencën e duhur për autoritetet doganore për kryerjen e formaliteteve doganore apo kontrollet, në përputhje me pikën 1, të nenit 23.

c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

ç) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, për të informuar autoritetet doganore pa vonesë për çdo faktor që lind pasi vendimi është marrë nga ato autoritete, i cili ndikon në vazhdimësinë ose përmbajtjen e tij, në përputhje me pikën 2, të nenit 28;

d) mosrespektimi nga operatori ekonomik i detyrimit për të paraqitur mallrat, të cilat janë futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, pranë autoriteteve doganore, në përputhje me nenin 130;

dh) mosrespektimi nga operatori ekonomik i detyrimit për të paraqitur në doganë mallrat e destinuara për të hyrë në një zonë të lirë, sipas përcaktimeve të nenit 218.

e) mosrespektimi nga operatori ekonomik i detyrimit për të paraqitur në zyrën doganore të daljes mallrat që do të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me pikën 2, të nenit 239;

ë) shkarkimi ose transbordimi i mallrave nga mjeti i transportit që i mban ato pa autorizim të dhënë nga autoritetet doganore ose në vende të pacaktuara ose të pamiratuara nga këto autoritete, në përputhje me nenin 131;

f) magazinimi i mallrave në ambientet e magazinimit të përkohshëm ose magazinave doganore pa autorizimin e autoriteteve doganore, në përputhje me nenet 137 dhe 138;

g) mosrespektimi nga mbajtësi i autorizimit apo mbajtësi i një regjimi i detyrimeve që rrjedhin nga magazinimi i mallrave që mbulohen nga regjimi i magazinimit doganor, në përputhje me shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 215.

Neni 253
Kundërvajtje të kryera me dashje

Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera me dashje:

a) përdorimi nga një operator ekonomik i deklaratave të rreme ose i çfarëdolloj mjeti tjetër të parregullt, me qëllim përfitimin e një autorizimi nga autoritetet doganore:

i) për t’u bërë një operator ekonomik i autorizuar, në përputhje me nenin 40;

ii) për të përdorur një deklaratë të thjeshtuar, në përputhje me nenin 152;

iii) për të përdorur lehtësitë e tjera doganore, sipas përcaktimeve të neneve 161, 163, 165, 167;

iv) për të vendosur mallrat nën regjime të posaçme, në përputhje me nenin 192;

b) mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

c) mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit

doganor, i detyrimit për të informuar autoritetet doganore pa vonesë për çdo faktor që lind pasi vendimi është marrë nga ato autoritete e që ndikon në vazhdimësinë ose përmbajtjen e tij, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 28.

ç) përpunimi i mallrave në një magazinë doganore pa autorizim të dhënë nga autoritetet doganore, në përputhje me nenin 214.

Neni 254
Nxitja, ndihma, bashkëfajësia dhe tentativa

1. Bashkëpunimi me anë të nxitjes, ndihmës apo çdo forme tjetër për një veprim ose mosveprim, sipas përcaktimeve të nenit 253, është kundërvajtje.

2. Tentativa për të kryer një veprim ose mosveprim, sipas shkronjës "a", të nenit 253, është kundërvajtje.

Neni 255
Gabime të autoriteteve doganore

Veprimet ose mosveprimet e parashikuara në nenet 251 deri në 254 nuk përbëjnë kundërvajtje kur ato ndodhin si pasojë e një gabimi nga ana e autoriteteve doganore.

SEKSIONI 2
SANKSIONET PËR KUNDËRVAJTJET

Neni 256
Sanksionet për kundërvajtjet me përgjegjësi objektive

1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet doganore, të përcaktuara në nenin 251, duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm:

a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 1-fish të detyrimit të munguar;

b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", zbatohet sanksion në masën 20 000 lekë deri në 50 000 lekë.

2. Me shprehjen "diferenca në pagesën e detyrimeve", sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, kuptohen diferencat e llogaritura të detyrimeve që duhen paguar për mallrat sikur të vendosen në qarkullim të lirë, pavarësisht nëse, sipas llojit të regjimit, detyrimet paguhen menjëherë apo janë të pezulluara.

Neni 257
Sanksionet për kundërvajtjet e kryera në neglizhencë

1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm:

a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar;

b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", zbatohet sanksion në masën 50 000 lekë deri në 500 000 lekë.

2. Me shprehjen "diferenca në pagesën e detyrimeve", sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, kuptohen diferencat e llogaritura të detyrimeve që duhen paguar për mallrat sikur të vendosen në qarkullim të lirë, pavarësisht nëse, sipas llojit të regjimit, detyrimet paguhen menjëherë apo janë të pezulluara.

Neni 258
Sanksionet për kundërvajtjet e kryera me dashje, në bashkëpunim dhe në tentativë

1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm:

a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar;

b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", zbatohet sanksion në masën 1 000 000 lekë.

2. Me shprehjen "diferenca në pagesën e detyrimeve", sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, kuptohen diferencat e llogaritura të detyrimeve që duhen paguar për mallrat sikur të vendosen në qarkullim të lirë, pavarësisht nëse, sipas llojit të regjimit, detyrimet paguhen menjëherë apo janë të pezulluara.

Neni 259
Sanksione për raste të tjera kundërvajtjesh

1. Për kundërvajtje të tjera nga ato të përcaktuara në mënyrë specifike në nenet 251 deri në 254 zbatohen sanksionet e mëposhtme:

a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 1-fish të detyrimit të munguar;

b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat sipas përcaktimeve të shkronjës "a", zbatohet sanksion në masën 20 000 lekë deri në 50 000 lekë.

2. Me shprehjen "diferenca në pagesën e detyrimeve", sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, kuptohen diferencat e llogaritura të detyrimeve që duhen paguar për mallrat sikur të vendosen në qarkullim të lirë, pavarësisht nëse, sipas llojit të regjimit, detyrimet paguhen menjëherë apo janë të pezulluara.

Neni 260
Kundërvajtjet e kryera në të njëjtën kohë

Kur i njëjti person ka kryer disa kundërvajtje në të njëjtën kohë, çdo kundërvajtje sanksionohet veçmas.

Neni 261
Sanksionet për kontrollet pas çlirimit të mallrave

Sanksionet e përcaktuara në nenet 256 deri në 259 zbatohen edhe në rastet e kontrolleve pas çlirimit të mallrave (a posteriori).

SEKSIONI 3
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 262
Caktimi i llojit dhe masës së sanksioneve për kundërvajtjet administrative

Autoritetet doganore kompetente në caktimin e llojit dhe masës së sanksioneve për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 251 deri në 254 duhet të marrin parasysh të gjitha rrethanat, duke përfshirë, sipas rastit:

a) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e kundërvajtjes;

b) faktin nëse personi përgjegjës për shkeljen është operator ekonomik i autorizuar;

c) shumën e shmangur të detyrimit të importit ose eksportit;

ç) faktin nëse mallrat e përfshira janë objekt i ndalimeve ose kufizimeve të përcaktuara në paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 125, dhe në shkronjën "d", të pikës 3, të nenit 239, ose paraqesin rrezik ndaj sigurisë publike;

d) nivelin e bashkëpunimit të personit përgjegjës për shkeljen me autoritetin kompetent;

dh) shkeljet e mëparshme nga ana e personit përgjegjës për shkeljen.

Neni 263
Parashkrimi

1. Afati i parashkrimit për procedurat për një kundërvajtje, të përcaktuar në nenet 251 deri në 254, është katër vjet dhe fillon të numërohet nga dita, në të cilën është kryer kundërvajtja.

2. Në rastin e kundërvajtjeve në vazhdim apo të përsëritura, afati i parashkrimit fillon në ditën, në të cilën pushon veprimi ose mosveprimi që përbën kundërvajtjen.

3. Në rastet e një hetimi ose procesi gjyqësor, në lidhje me të njëjtën kundërvajtje doganore, afati i parashkrimit ndërpritet me çdo akt të autoritetit kompetent, i cili i njoftohet personit në fjalë. Afati i parashkrimit rifillon të numërohet nga dita kur ka përfunduar hetimi ose procesi gjyqësor duke përfshirë në këtë numërim edhe afatin e konsumuar të parashkrimit deri në ditën kur është bërë pezullimi i tij.

4. Nuk fillon ose vazhdon asnjë procedim, në lidhje me një kundërvajtje të përcaktuar në nenet 251 deri në 254, pas mbarimit të një periudhe prej 8 vjetësh nga dita e përmendur në pikën 1 ose 2.

5. Afati i parashkrimit për zbatimin e një vendimi që vendos një sanksion është tre vjet. Kjo periudhë fillon në ditën, në të cilën ky vendim merr formë të prerë.

6. Me vendim të Këshillit të Ministrave mund të përcaktohen rastet kur pezullohen afatet kohore të përcaktuara në pikat 1, 4 dhe 5.

Neni 264
Pezullimi i procedurës

1. Procedimet administrative, të lidhura me një kundërvajtje, sipas përcaktimeve të neneve 251 deri në 254, pezullohen kur ka filluar një procedim penal kundër të njëjtit person në lidhje me të njëjtat fakte.

2. Procedimet administrative të pezulluara, të lidhura me një kundërvajtje të përcaktuar në nenet 251 deri në 254, nuk vazhdojnë më kur procedimi penal i përcaktuar në pikën 1 ka pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës. Në raste të tjera, procedimet administrative të pezulluara për një kundërvajtje të përcaktuar në nenet 251 deri në 254 mund të rifillojnë.

Neni 265
Sekuestrimi dhe kompensimi i dëmeve

1. Autoritetet doganore mund të sekuestrojnë përkohësisht mallrat, mjetet e transportit dhe çdo pajisje tjetër të përdorur në kryerjen e kundërvajtjeve të përcaktuara në nenet 251 deri në 254, derisa të depozitohet një garanci ose të paguhet shuma e sanksioneve dhe detyrimeve përkatëse.

2. Asnjë e drejtë kompensimi për dëmin e shkaktuar nga zhvlerësimi që rrjedh nga sekuestrimi i mallrave që janë objekt i kundërvajtjes nuk mund të ngrihet kundër autoriteteve doganore ose shtetit shqiptar.

KREU III
KONTRABANDA

Neni 266
Raste të kontrabandës

Konsiderohet kontrabandë:

1. Vënia në dispozicion të autoriteteve doganore të informacionit apo dokumenteve të rreme, të kërkuara

nga këto autoritete, në përputhje me nenet 23 ose 150;

2. Futja apo nxjerrja e mallrave në ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pa i paraqitur ato tek autoritetet doganore, sipas përcaktimeve të neneve 130, 218 ose pikës 2, të nenit 239;

3. Mosrespektimi nga mbajtësi i regjimit të transitit kombëtar i detyrimit për paraqitjen e mallrave të paprekura në zyrat doganore të destinacionit dhe brenda afatit kohor të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 207;

4. Marrja ose mbajtja e mallrave të përfshira në një nga shkeljet doganore të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni;

5. Hedhja në konsum e mallrave të vendosura në qarkullim të lirë pasi janë importuar me pezullim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet doganore, për shkak të destinacionit përfundimtar ose të përdorimit të tyre të veçantë përfundimtar (end-use), kur autoritetet doganore vërtetojnë se destinacioni i tyre përfundimtar ose përdorimi i tyre i veçantë përfundimtar (end-use) është i ndryshëm nga ai që është përcaktuar për të përfituar përjashtimin nga detyrimet doganore;

6. Eksportimi, importimi ose mbajtja e mallrave të ndaluara ose të kufizuara, me përjashtim të rasteve kur për këto mallra është lëshuar një autorizim me shkrim nga autoritetet kompetente;

7. Heqja ose falsifikimi në çfarëdo mënyre i numrit të identifikimit të mjetit të transportit;

8. Blerja, shitja, ruajtja dhe nëndorësia e mallrave nga individë, të cilët kanë dijeni ose objektivisht duhej të ishin në dijeni se këto mallra janë futur kontrabandë;

9. Importimi, eksportimi ose shitja e sendeve me vlera kulturore kombëtare, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në këtë fushë;

10. Thyerja e vulës doganore, zëvendësimi ose ndërrimi i shenjave të tjera të sigurisë, të vendosura mbi mjetin e transportit ose mbi mallrat;

11. Deklarimi i rremë i llojit, vlerës dhe origjinës së mallrave, kur këto shkelje janë kryer me anë të faturave, certifikatave ose çdo lloji tjetër dokumenti të rremë, të pasaktë, të paplotë ose të paaplikueshëm.

Neni 267

Raste të veçanta të kontrabandës

Përveç rasteve të përcaktuara në nenin 266, përbën gjithashtu kontrabandë:

1. Shkarkimi ose ruajtja e mallrave në hapësirën e ndërmjetme mes kufirit tokësor dhe zyrës doganore më të afërt.

2. Mbajtja e mallrave të fshehura në trup, në bagazh, në pako ose në artikuj të tjerë të mbartur ose në çfarëdo mjet transporti për t'iu shmangur kontrollit dhe/ose mbikëqyrjes doganore.

Largimi i mallrave nga zonat doganore pa paguar detyrimet që duhen paguar ose pa garantuar pagesën, me përjashtim të rasteve të përjashtimit nga detyrimi për dhënien e garancive, siç parashikohet në këtë Kod.

4. Paraqitja e një deklaratë të rreme ose kryerja e çdo veprimi që ka për qëllim dhe/ose pasojë përftimin pjesor a tërësor të një rimbursimi apo reduktimi nga tarifat doganore, taksat, tatimet, akciza ose të një avantazhi të çfarëdoshëm që ka të bëjë më importin ose eksportin e mallrave.

5. Mbajtja në afërsi të vijës doganore e mallrave, për të cilat nuk mund të dëshmojë prejardhjen e rregullt.

6. Transportimi i mallrave pa manifest ose mungesa ose refuzimi i paraqitjes së manifestit dhe dokumentet përkatëse.

7. Ngarkimi, shkarkimi ose transbordimi i mallrave, udhëtarëve dhe bagazheve të tyre pa lejen e autoriteteve doganore.

8. Futja e mallrave nga kapiteni i mjetit lundrues nëpërmjet liqeneve kufitare, pa i paraqitur ato në njërën prej zyrave doganore më të afërta.

9. Gjatë lëvizjes së mallrave në rrugë detare kryerja nga kapiteni i mjetit lundrues i veprimeve dhe/ose mosveprimeve si më poshtë:

a) hedhja e spirancës ose ndalimi në afërsi të portit pa lejen e autoriteteve doganore;

b) qëndrimi në vende ku nuk ka zyrë doganore, shkarkimi ose transbordimi i këtyre mallrave në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe aktet nënligjore të tij;

c) mungesa në bordin e mjetit detar i mallrave që, në bazë të manifestit dhe dokumenteve të tjera doganore, duhet të gjendeshin aty në çastin e nisjes;

ç) transportimi i mallrave nga një zyrë doganore në një tjetër pa dokumentet përkatëse të transitit.

10. Gjatë lëvizjes së mallrave në rrugë ajrore kryerja nga Kapiteni i mjetit ajror i veprimeve dhe/ose mosveprimeve si më poshtë:

a) mungesa në bordin e mjetit ajror të mallrave që në bazë të manifestit dhe dokumenteve të tjera doganore, duhet të gjendeshin aty në çastin e nisjes;

b) largimi ose lejimi i largimit të mallrave nga vendi i uljes së mjetit ajror, pa autorizimin e autoriteteve doganore;

c) ulja jashtë një aeroporti të autorizuar dhe moslajmërimi menjëherë i autoriteteve doganore më të afërta ose strukturave të policisë për këtë ulje. Në këtë rast, konsiderohet objekt kontrabandë edhe mjeti ajror.

Neni 268

Sanksionet administrative për kontrabandën

Autoritetet doganore vendosin sekuestro të përkohshme për mallrat që janë objekt i kontrabandës, përfshirë edhe mallrat që nuk tatohen.

Autoritetet doganore vendosin sanksione administrative për rastet e kontrabandës në masën trefish të shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që janë objekt kontrabande, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në Kodin Penal;

3. Çdo shkelës përgjigjet personalisht dhe solidarisht për pagesën e sanksionit të mësipërm, në varësi të shkallës së pjesëmarrjes. Në këtë rast, secili prej tyre është i detyruar të përmbushë tërësisht detyrimet dhe autoritetet doganore mund të kërkojnë pagesën ose të padisin njërën ose/dhe të gjitha palët.

4. Kur i njëjti shkelës kryen njëherazi më shumë se një shkelje, të parashikuar në këtë kre, për çdo shkelje vendosen sanksione specifike.

Neni 269
Përsëritja dhe tentativa

1. Në rastet e përsëritjes së kontrabandës (recidivism), sanksioni administrativ është dyfishi i sanksionit të përcaktuar në nenin 268. Ky sanksion nuk zbatohet nëse kanë kaluar 5 vjet nga data e pagesës së plotë të detyrimeve dhe të sanksionit të parë.

2. Kontrabanda e mbetur në tentativë dënohet njësoj, sipas përcaktimeve të nenit 268.

Neni 270
Procedimi penal

Personi ndaj të cilit zbatohet sanksioni administrativ për kontrabandën, procedohet penalisht në përputhje me dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Neni 271
Objektet e kontrabandës, sekuestrimi dhe kompensimi i dëmeve

1. "Objekte të kontrabandës" janë mallrat që kanë shërbyer për realizimin e kontrabandës, produktet e tyre, mjetet e transportit dhe objektet tjera, të përdorura për t'i lëvizur ose për t'i fshehur ato.

2. Objektet e kontrabandës, të parashikuara në pikën 1, sekuestrohen:

a) kur veprimi i kontrabandës është në kryerje e sipër. Veprimi i kontrabandës është në kryerje e sipër kur mallrat nuk janë magazinuar përfundimisht në një shtëpi, në një dyqan, në një magazinë ose në çfarëdo vendi tjetër që ka zgjedhur personi përgjegjës ose bashkëpunëtorët e tij;

Kontrabanda është në kryerje e sipër edhe kur personi përgjegjës është kapur në afërsi të vendit ku është kryer kontrabanda, duke pasur në zotërim çdo lloj prove kompromettuese ose është ndaluar në vijim të një informacioni të dhënë nga persona të tjerë;

b) kur veprimi i kontrabandës ka përfunduar. Në këtë rast objektet e kontrabandës janë vendosur përfundimisht në vendin e zgjedhur nga personi përgjegjës ose bashkëpunëtorët e tij.

3. Objektet e kontrabandës konfiskohen me vendim të gjykatës, në përputhje me përcaktimet e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

4. Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestros për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar me miratimin e organit procedues, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

5. Në rast se janë sekuestruar mallra që prishen dhe kur ekzistojnë prova njoftohen menjëherë organet proceduese penale, për vendin dhe mënyrën e ruajtjes, të cilat disponojnë me vendim brenda 48 orëve nga momenti i marrjes së dosjes, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

6. Në rastin kur gjykata vendos konfiskimin e mjeteve të transportit, autoritetet doganore mund të kërkojnë që këto mjete t'u jepen autoriteteve doganore për t'i përdorur gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.

7. Asnjë e drejtë kompensimi për dëmin e shkaktuar nga zhvlerësimi, që rrjedh nga sekuestrimi i mallrave që janë objekt i kontrabandës, nuk mund të ngrihet kundër autoriteteve doganore ose shtetit shqiptar.

Neni 272
Zgjidhja administrative e kontrabandës

1. Shkelësi mund t'u kërkojë autoriteteve doganore zgjidhjen në rrugë administrative të kontrabandës në rast se plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) ndjekja penale nuk ka filluar ende;

b) shuma e detyrimeve doganore që duhet paguar për mallrat e përfshira në kontrabandë është më e vogël se 5 milionë lekë;

c) personi përgjegjës paguan menjëherë shumën e detyrimeve doganore dhe gjobën e zbatuar;

ç) personi i akuzuar deklaron se heq dorë nga e drejta e ankimit të parashikuar në nenin 282.

2. Sekuestrimi që zbatohet mbi mallrat, objekt kontrabande, dhe ndalimi i shkelësit, kurdo që bëhet, anulohet menjëherë sapo autoritetet doganore verifikojnë nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e përshkruara në pikën 1, të këtij neni.

3. Ky nen nuk zbatohet kur:

a) kontrabanda kryhet nga një punonjës i doganës, punonjës shtetëror, agjent doganor ose nga çdo person tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet me atë doganore;

b) shkelësi ka në zotërim objekte të kontrabandës, si pasojë e një vepre penale tjetër;

c) mallrat, objekt kontrabande, janë mallra të ndaluara ose të kufizuara ose janë objekte me vlerë kulturore kombëtare;

ç) shkelësi është përsëritës. Për qëllime të kësaj shkronje, shkelësi nuk konsiderohet përsëritës nëse kanë kaluar 5 vjet nga data e pagesës së plotë të detyrimeve dhe sanksionit të parë.

KREU IV
VERIFIKIMI I SHKELJEVE DOGANORE

Neni 273
Procedura e verifikimit

1. Shkeljet doganore verifikohen dhe dënohen, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionin në fuqi.

2. Për qëllime të këtij kreu, "autoritete doganore kompetente" do të thotë autoritetet doganore që ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontrolle në zonën ku është kryer dhe verifikuar shkelja apo në zonën ku ajo është kompetente në një territor të caktuar.

3. Për të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore, nga ana e strukturave doganore që kanë konstatuar shkeljen mbahet një procesverbal me shkrim, i cili duhet të nënshkruhet nga punonjësit doganorë që kryejnë verifikimin e kontrollin, si dhe shkelësi, kur shkelja është evidentuar në prani të tij.

4. Në rastet kur shkelja nuk është konstatuar në prani të shkelësit, procesverbali i nënshkruar nga punonjësit doganorë të strukturave kontrolluese, që ushtruan verifikimin dhe kontrollin, i njoftohet shkelësit nga kjo strukturë brenda 5 ditëve kalendarike. Në procesverbal përcaktohet edhe e drejta e shkelësit për të paraqitur pretendimet e tij me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike nga e nesërmja e marrjes së njoftimit, pranë strukturës përkatëse.

5. Strukturat kontrolluese, pas shqyrtimit të pretendimeve, u dërgojnë autoriteteve doganore kompetente procesverbalin përfundimtar së bashku me pretendimet e shkelësit.

Neni 274
Forma e procesverbalit të verifikimit e të sekuestrimit

1. Procesverbali i verifikimit duhet të përmbajë:

a) vendin, datën dhe kohën kur verifikohet shkelja;

b) emrat e personave që nënshkruajnë dhe autoritetin/strukturën që përfaqësojnë;

c) të dhëna identifikuese të shkelësit/shkelësve;

ç) llojin e shkeljes së kryer;

d) mënyrën me të cilën është kryer shkelja;

dh) identifikimin e mjetit/mjeteve të transportit;

e) treguesit që lidhen me sasinë, llojin, vlerën dhe origjinën e mallrave që janë objekt i shkeljes;

ë) shumën e detyrimeve të importit ose eksportit që duhen paguar;

f) nenet e shkelura, nenet, në bazë të të cilave përcaktohen sanksionet, si dhe sanksionet e parashikuara për çdo shkelje;

g) nënshkrimin e punonjësve të doganës të strukturave kontrolluese dhe, kur është i pranishëm, nënshkrimin e shkelësit. Kur shkelësi nuk pranon të nënshkruajë, në procesverbal shënohet se atij i është lexuar kërkesa për të nënshkruar dhe se i është dorëzuar një kopje.

2. Procesverbali i sekuestrimit duhet të përmbajë:

a) vendin, datën dhe kohën kur kryhet sekuestroja;

b) emrat e personave që nënshkruajnë dhe autoritetin/strukturën që përfaqësojnë;

c) të dhëna identifikuese të shkelësit/shkelësve;

ç) referencat e procesverbalit të verifikimit dhe/ose të ndonjë akti tjetër që lidhet me sekuestrimin;

d) përshkrimin e objekteve të sekuestruara dhe sasinë e tyre;

dh) shenjat, plumbçet, vulat e vendosura mbi objektet e sekuestruara;

e) emrin dhe cilësinë e personit, të cilit i është lënë në ruajtje objekti;

ë) nënshkrimin e punonjësve të strukturave kontrolluese të doganës dhe, kur është i pranishëm, nënshkrimin e shkelësit. Kur shkelësi nuk pranon të nënshkruajë, në procesverbal shënohet se atij i është lexuar kërkesa për të nënshkruar dhe se i është dorëzuar një kopje.

Neni 275
Marrja e dëshmive/deklarimeve

1. Autoritetet doganore mund të marrin në pyetje shkelësin dhe/apo dëshmitarët. Për këtë qëllim autoritetet doganore duhet t'u bëjnë atyre një njoftim, në të cilin përcaktohen data dhe ora, në të cilën duhet të paraqiten personalisht ose duhet të depozitojnë një dëshmi/deklarim me shkrim. Afati kohor për t'u paraqitur për këtë qëllim nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë. Në rastet e flagrancës, marrja në pyetje e shkelësve dhe dëshmitarëve bëhet menjëherë. Konsiderohen, gjithashtu, dëshmitarë të gjithë ata persona që mund të jenë bashkëpunëtorë në shkelje, si dhe vetë punonjësi ose nëpunësi i doganës që ka verifikuar shkeljen dhe ka nënshkruar procesverbalin.

2. Në rastet kur shkelësi dhe dëshmitarët marrin pjesë personalisht në marrjen në pyetje, dy punonjës të autorizuar të doganës drejtojnë seancën e marrjes në pyetje dhe përgatitin raportin përkatës.

3. Dëshmitë/deklarimet duhet të nënshkruhen nga shkelësi e nga dëshmitarët, kur janë të pranishëm, dhe nga të dy punonjësit e doganës që kanë drejtuar seancën e marrjes në pyetje.

4. Kur një ose me shumë shkelës apo dëshmitarë janë shtetas të huaj, marrja në pyetje bëhet në prani të një përkthyesi, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 276
Marrja e vendimit dhe njoftimi

1. Autoritetet doganore kompetente, për shkeljen e konstatuar, përgatitin dosjen e plotë, në lidhje me shkeljen, dhe marrin vendimin përkatës.

2. Vendimi i autoriteteve doganore kompetente për pagimin e detyrimeve të importit ose eksportit dhe/ose të sanksioneve përkatëse, të përcaktuara në këtë Kod, merret në rastet e flagrancës/urgjencës, brenda 24 orëve nga momenti i mbajtjes të procesverbalit të verifikimit të shkeljes dhe i njoftohet shkelësit brenda 24 orëve nga marrja e vendimit.

3. Në raste të tjera, vendimi i autoriteteve doganore kompetente merret:

a) kur procesverbali për verifikimin e shkeljes është mbajtur nga vetë autoriteti doganor kompetent, maksimumi brenda 60 ditëve kalendarike nga data kur shkelësit i përfundon afati për paraqitjen e pretendimeve për procesverbalin, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 273, dhe i njoftohet me shkrim shkelësit, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit,

b) kur procesverbali për verifikimin e shkeljes është mbajtur nga strukturat e tjera kontrolluese, maksimumi brenda 60 ditëve kalendarike nga data kur autoriteti doganor kompetent ka marrë dijeni për procesverbalin, sipas përcaktimeve të pikës 5, të nenit 273, dhe i njoftohet me shkrim shkelësit brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit.

4. Kur autoriteti doganor kompetent vlerëson se nuk duhet marrë vendim për një procesverbal, u komunikon strukturave doganore, që kanë hartuar procesverbalin e verifikimit të shkeljes, arsyet e mosmarrjes së vendimit.

Neni 277
Kalimi i dosjes tek organet e procedimit penal

1. Kur shkelja doganore përbën kontrabandë, kallëzimi penal bashkë me dosjen përkatëse, të përmendur në pikën 1, të nenit 276, të këtij Kodi, u transferohet organeve kompetente të procedimit penal, brenda 72 orëve nga çasti i verifikimit të shkeljes. Materialit kallëzues i bashkëlidhet edhe vendimi për aplikimin e sanksioneve administrative.

2. Në rastet kur zbatohet neni 272, dosjes së sipërpërmendur i bashkëngjitet vendimi i autoriteteve për zgjidhjen administrative të çështjes, e cila i dërgohet menjëherë organit të prokurorisë.

Neni 278
E drejta e arrestimit dhe e ndalimit

1. Organet e Policisë Gjyqësore, të parashikuara në nenin 7, të këtij Kodi, kanë të drejtë të arrestojnë dhe të ndalojnë, sipas neneve 251 dhe 253 të Kodit të Procedurës Penale, personat/shkelësit që kryejnë kontrabandë.

2. Kur personi lirohet, në përputhje me pikën 2, të nenit 272, dosja përkatëse së bashku me vendimin për zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative u dërgohen organeve të procedimit penal.

Neni 279
Mbledhja e informacionit

1. Punonjësit e doganës mund të autorizohen nga kryetari i degës doganore kompetente ose nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave për të mbledhur informacione ose për të zbuluar prova për shkeljet e këtij Kodi dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Informacioni mund të merret ose të kërkohet në vendet ku kryhen veprimtari prodhuese, shërbimi dhe tregtare, si dhe kudo ku ruhen shkresa, dokumente dhe regjistrime të tjera për mallrat që janë objekt i shkeljeve doganore. Mbledhja e informacionit për kontrabandën, kur ka filluar procedimi penal, bëhet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

3. Në përputhje me dispozitat e titulli IX dhe legjislacionin në fuqi, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave mblidhen, administrohen dhe mbahen në formën e një regjistri të gjitha të dhënat për shkeljet doganore. Ky regjistër është konfidencial dhe në të kanë të drejtë të regjistrojnë të dhëna apo t'i përdorin ato vetëm punonjësit doganorë të autorizuar për këtë qëllim nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Neni 280
Vjelja e detyrueshme e borxhit

1. Kur shuma e detyrimeve të importit ose eksportit që duhen paguar nuk është shlyer brenda afateve të përcaktuara në këtë Kod:

a) autoritetet doganore përdorin të gjitha mjetet ligjore për të siguruar pagesën e shumës së borxhit;

b) përveç shumës së detyrimeve të importit ose eksportit ngarkohen edhe kamatëvonesat.

2. Autoritetet doganore, kur lind një borxh, me qëllim që të sigurojnë pagimin e këtij borxhi, mund të marrin masat e mëposhtme:

a) sekuestrimin e vlerave monetare, të kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumenteve, me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit ose garantuesit/garantuesve;

b) sekuestrimin e mallrave, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, që i përkasin debitorit ose garantuesit /gantuesve, i cili/të cilët ka/kanë detyrime kundrejt debitorit.

3. Autoritetet doganore, përveç ushtrimit të kompetencave të tyre, sipas këtij Kodi, mund t'u kërkojnë autoriteteve kompetente edhe marrjen e masave të tjera specifike, si pezullimi i veprimtarive ekonomike të debitorit ose të veprimtarive të tjera prodhuese, për ushtrimin e të cilave debitori është regjistruar pranë këtyre autoriteteve.

4. Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit bëhen tituj ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit.

5. Ekzekutimi i titujve ekzekutivë të nxjerrë nga administrata doganore, të mbështetur me urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga autoritetet gjyqësore kompetente, bëhet menjëherë në bazë të dispozitave të parashikuara nga nenet 511 e në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile. Ekzekutimi mund të bëhet edhe nga strukturat e mbledhjes me forcë të detyrimit pranë administratës doganore.

6. Pas aplikimit të masave të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të këtij neni, autoritetet doganore procedojnë me konfiskimin, në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative.

7. Mallrat e konfiskuara shkatërrohen ose administrohen sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V
ANKIMI

Neni 281
E drejta e ankimit

1. Çdo person ka të drejtë të ankohet kundër çdo vendimi të marrë nga autoritetet doganore, në lidhje me një borxh dhe/ose vendosjen e sanksioneve në lidhje me zbatimin e këtij Kodi.

2. E drejta e ankimit mund të ushtrohet fillimisht pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave e, më pas, përpara autoriteteve gjyqësore, sipas dispozitave në fuqi.

Neni 282
Ankimi ndaj vendimit të autoriteteve doganore në lidhje me një borxh dhe/ose me një sanksion

1. Kundër vendimit të autoriteteve doganore kompetente, shkelësi mund t'i paraqesë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave një kërkesë ankimore të arsyetuar, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

2. Për të paraqitur ankesën, ankimuesi duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit ose eksportit, sipas përkufizimeve të këtij titulli, si dhe të garantojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e sanksioneve të aplikuara për shkeljen, objekt konflikti.

3. Ankimuesi duhet të bashkëshoqërojë ankimin me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e tij.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës ankimore dhe ky vendim u njoftohet menjëherë ankimuesit dhe autoriteteve doganore kompetente. Nëse brenda kësaj periudhe nuk merret një vendim, ankimuesi mund t'u drejtohet autoriteteve gjyqësore, në përputhje me përcaktimin e pikës 6, të këtij neni.

5. Nëse ankesa nuk pranohet, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave bën kalimin e menjëhershëm të shumës së garancisë në llogarinë e saj. Nëse kërkesa pranohet, autoritetet doganore duhet t'i kthejnë ankimuesit shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit ose eksportit, si dhe të lirojnë garancinë.

6. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, ankimuesi mund të ankohet pranë autoriteteve gjyqësore brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të mospranimit të ankesës, ose brenda 45 ditëve nga mbarimi i afatit të shqyrtimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni.

7. Në rast se autoritetet gjyqësore pranojnë ankesën, autoritetet doganore duhet t'i kthejnë ankimuesit shumën e paguar. Kthimi i kësaj shume mund të bëhet vetëm pasi vendimi i autoriteteve gjyqësore kompetente merr formë të prerë.

8. Në rast se ankimuesi nuk plotëson kushtet kumulative, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, ankimimi konsiderohet sikur nuk është bërë.

9. Në rast se ankimuesi nuk ankimon ose konsiderohet se nuk ka ankimuar, sipas përcaktimeve të pikës 8, autoritetet doganore marrin të gjitha masat për të proceduar me vjeljen e shumës së borxhit të sanksioneve përkatëse, në bazë të procedurave të përcaktuara në këtë Kod për vjeljen e detyrueshme të borxhit.

Neni 283
Pezullimi i zbatimit të vendimit

Ankimi ndaj vendimit të autoriteteve doganore kompetente për vendosjen e sanksioneve nuk shkakton pezullimin e zbatimit të vendimit në konflikt.

TITULLI X
ADMINISTRIMI I TË ARDHURAVE DHE SHPËRBLIMEVE

Neni 284
Administrimi i të ardhurave

1. Përveç të ardhurave të përmendura në nenin 285, të këtij Kodi, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave i lihen edhe 2 për qind të të ardhurave vjetore të doganave, për t'i përdorur për investime, përmirësimin e kushteve të punës e të jetesës së personelit të administratës doganore, si dhe për shpërblimin e tij.

2. Personelit të administratës doganore, duke pasur parasysh veçantinë e punës që kryen, si dhe vështirësitë që përballon gjatë ushtrimit të detyrës, i jepet një shpërblim stimulues, i bazuar në kriteret e mëposhtme:

a) shërbimin e kryer në zyrat doganore të kufirit tokësor, ujor dhe ajror;

b) shërbimet me rrezik të veçantë për personin;

c) konstatimin e shkeljeve të Kodit Doganor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

ç) efikasitetin në punë.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, në bazë të kritereve të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, bën shpërndarjen e këtij shpërblimi midis personelit të administratës doganore.

4. Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, miraton udhëzimin për rregullat e dhënies së shpërblimeve për administratën doganore.

Neni 285
Shpërndarja e të ardhurave nga sanksionet dhe sekuestrimet

Të ardhurat që burojnë nga zbatimi i sanksioneve dhe i shitjes së objekteve të kontrabandës të konfiskuara shpërndahen si më poshtë:

a) 50 për qind buxhetit të shtetit;

b) 50 për qind që mbetet ndahet në bazë të përqindjes së caktuar me udhëzim të ministrit i Financave për:

i) investime e shpenzime për përmirësimin e kushteve të punës së personelit;

ii) shpërblime për personelin doganor që ka marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në shqyrtimin e shkeljes doganore;

iii) shpërblime për informatorët që kanë bërë të mundur zbulimin e shkeljeve.

TITULLI XI
SISTEMET INFORMATIKE DHE DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

KREU I
ZHVILLIMI I SISTEMEVE INFORMATIKE

Neni 286
Masat transitore

Mjetet për shkëmbimin dhe mbajtjen e informacionit, të tjera nga ato të teknikave informatike të përpunimit të të dhënave, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 17, mund të përdoren për një periudhë transitore, deri më 31 dhjetor 2021, gjatë së cilës sistemet informatike, të cilat janë të nevojshme për aplikimin e dispozitave të këtij Kodi, nuk janë ende operacionale.

Neni 287
Aktet nënligjore

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat për shkëmbimin dhe ruajtjen e të dhënave në situatën e referuar në nenin 286.

KREU II
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 288
Akte nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 289
Shfuqizime

1. Ligji nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër, që bie ndesh me këtë Kod, shfuqizohen nga data e përcaktuar në pikën 3, të nenit 291.

2. Nenet 9, 10, 11, 13, 14, 16, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, shfuqizohen nga data e hyrjes në fuqi të neneve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 291.

3. Nenet 93, 98, 99, 104 dhe 199, pikat 1, 2 e 3, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, shfuqizohen nga data e hyrjes në fuqi të neneve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 291.

Neni 290
Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 291
Fillimi i zbatimit

1. Nenet 21, 22, 40, 41, 47, 90, pikat 3 e 4, 91, 119, pika 7, 149, 150, 152, 153, pikat 1, 2 e 3, 161, 163, 165, 167, 169, 175, 176 dhe 184, të këtij Kodi, fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2015.

2. Nenet 2, 7, 8, 9, 10, 12, 13, 14, 15, 16, 18, 26, 29, 35, 39, 42, 51, 58, 62, 64, 71, 83, 94, 100, 108, 115, 118, 123, 129, 133, 141, 145, 148, 151, 154, 160, 162, 164, 166, 168, 174, 177, 181, 188, 190, 193, 196, 200, 202, 206, 209, 212, 226, 238, 240, 245, 248, 263, pika 6, 287 dhe 288 hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

3. Nene të tjera nga ato të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, hyjnë në fuqi më 1 qershor 2017.

Neni 292
Dispozita kalimtare

1. Deri në shfuqizimin e plotë të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 161 i këtij Kodi konsiderohet si ndryshim i nenit 104, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Deri në shfuqizimin e plotë të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 169, 175 dhe 176, të këtij Kodi, konsiderohen si ndryshim i neneve 93, 98 dhe 99, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Deri në shfuqizimin e plotë të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", shkronja "b", e pikës 2, të nenit 267, ndryshohet si më poshtë:

"b) në rastin e diferencës në sasi, pagesën e një gjobe që shkon nga gjysma deri në të gjithë shumën e detyrimit të munguar.".

Miratuar në datën 31.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8688, datë 22.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 80 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006